

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



# Mbrojtja

Viti i 91-të i botimit  
2023 / Nr. 4



**Forcat e  
Armatosura,  
mbrojtje,  
arsimim,  
mision...**

**DREJTOR I QKMBMMFA**  
**ARBEN SKËNDERAJ**

**Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktore**  
**ANJEZA MUSOLLARI**

**GRAPHIC DESIGNER**  
**AFËRDITA HYSAJ**

**REDAKTORE / KORREKTORE**  
**SUELA HODA**

**BASHKËPUNËTORË**  
**KOLONEL HYSNI GJERGJI**  
**PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ**  
**N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ**

© Ministria e Mbrojtjes

*Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitim, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.*

*Botues:  
Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes*

*Adresa:  
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"*

*Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:  
<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/revista-mbrojtja>*



## Mbrojtja

- Ministri Peleshi: Synojmë ta kthejmë këtë akademi në një 'laborator' të formimit të gjeneratës së re, të liderit të ardhshëm në nivel kombëtar ..... 4
- Ministri Peleshi: Politika e jashtme e Shqipërisë, e orientuar drejt fqinjësisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor..... 6
- Ministri Peleshi: Sllovenia, partnere dhe mbështetëse e Shqipërisë në rrugën e integritimit në Bashkimin Europian ..... 8
- Samiti i NATO-s, Peleshi: Shqipëria e angazhuar për të shtuar shpenzimet për mbrojtjen ... 11
- Ministri Peleshi nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë .....12
- Prezantohen rezultatet e monitorimit të satelitëve "Albania 1" dhe "Albania 2" .....14
- SHSHPFA, gjeneral brigade Kingji merr pjesë në konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm (BCHOD-s).....16
- Presidenti Bajram Begaj dekreton dhënien e gradës madhore "gjeneralmajor" për SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji .....18
- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitë zyrtare në SHBA .....20
- Gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar të stërvitjes "Saber Guardian 23" .....22
- Studentët e AFA-së, vizitë në Akademinë Ushtarake 'West Point' .....28
- Gjeneral brigade Bilbil Bitri pritit atashëun ushtarak të SHBA-së, kapiten i rangut I David Millner .....29
- QAPU zhvilloi ceremoninë e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve .....30
- Përfundoi faza e parë e kursit për ekspertët shqiptarë të Mbrojtjes Civile .....31
- Forca Ajrore së shpejti do të këtë në përdorim mjete ajrore pa pilot .....32
- Robotët "vrasës", teknologjia "smart" dhe e drejta ndërkombëtare.....42
- Fusha kibernetike dhe hapësinore: Ndikimi në zhvillimin e operacioneve të mbrojtjes .....45
- "Arsimimi Ushtarak Shqiptar - 65 vjet Akademia e Forcave të Armatosura" .....48
- Kremtohet 55-vjetori i krijimit të Batalionit të Xhenios .....50
- Arsyet, domosdoshmëria e krijimit dhe karakteri gjithshqiptar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, në vitet e para të shtetit shqiptar .....52
- ASNI, 92 vite shërbim 'inteligjent' i Forcave të Armatosura ..... 58
- Krijimi i bazës së Kuçovës, aseti i Forcave të Armatosura në rrugën e shndërrimit të saj në bazë të NATO-s .....60
- QPR, "struktura port ku hyn gjaku i ri" në FA .....64
- Nuk është e lehtë të plakësh me dinjitet .....68
- PËRGATITJA E OFICERIT SHQIPTAR - LIDERIT ME KARAKTER..... 70
- Gjeneral brigade Xhebexhia: Suksesi për çdo detyrë kërkon që të afrosh zemrën, mendjen dhe vullnetin në çdo kohë .....74
- Asllan Zemani: Kujtesa historike është palca e një kombi .....77
- Gratë luftëtare, dinjiteti dhe vlera e historisë ndër shekuj .....88
- Mos harroni Srebrenicën ..... 94
- 24 vite nën qiellin e lirë të Kosovës martire .....96
- Lufta e Parë Botërore, masakra më e përgjakshme në histori .....98

## 7

**Ministri Peleshi: Rikonfirmojmë mbështetjen politike dhe logjistike ndaj popullit ukrainas**

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji morën...

## 42

**Robotët "vrasës", teknologjia "smart" dhe e drejta ndërkombëtare**

# 04

**Ministri Peleshi: Synojmë ta kthejmë këtë akademi në një 'laborator' të formimit të gjeneratës së re, të liderit të ardhshëm në nivel kombëtar**

# 14

**Prezantohen rezultatet e monitorimit të satelitëve "Albania 1" dhe "Albania 2"**

Në aktivitetin, ku morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, drejtues të institucioneve të ndryshme dhe ekspertë, u prezantuan produktet e para të shërbimit satelitor...



**Diplomohen kursantët e KKSHP dhe KLO**

Pranë ambienteve të auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua ceremonia e Diplomimit të oficerëve në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursin e Lartë të Oficerit, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji...


Faqe 26



**Gjeneral brigade Xhebexhia: Suksesi për çdo detyrë kërkon që të afrosh zemrën, mendjen dhe vullnetin në çdo kohë**

Forca Tokësore u krijua më 29 gusht të vitit 2000, duke përfshirë në radhët e saj njësi dhe reparte me traditë me një veprimtari të pasur shumë-vjeçare, të përhapura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë...

Faqe 74





# Ministri Peleshi: *Synojmë ta kthejmë këtë akademi në një 'laborator' të formimit të gjeneratës së re, të liderit të ardhshëm në nivel kombëtar*

**N**ë amfiteatrin pranë kodrave të Liqenit Artificial, u organizua ceremonia e diplomimit të 80 studentëve të Akademisë së Forcave të Armatosura, në të cilin morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, zëvendësministri i Arsimit, gjeneralë, drejtorë e familjarë.

“Sfidat me të cilat përballen FA-të, vendi dhe gjithë Aleanca, janë në evoluim të përhershëm, sikurse duhet të jetë edhe arsimimi ushtarak, mënyra se si do të përballohen sfidat. Këto sfida na rrisin ndjeshmërinë dhe përgjegjshmërinë për misionin dhe rolin e FA-së, përfaqesin në adresimin e problemeve me të cilat përballemi, si dhe kërkesat e detyrat që duhet të përmbushë arsimimi ushtarak. Edukimi dhe trajnimi duhet të jetë komplementar e që shfrytëzon gjithë mundësitë që ofrojnë institucionet e ndryshme të FA-së dhe vetë forcat. Përveç institucioneve të arsimit institucional, të cilat duhet të rrisin fleksibilitetin, përmirësojnë metodologjinë dhe përditësojnë programet edhe qendrat stërvitore të forcave dhe vetë njësitë e repartet, duhet të përmbushin rolin që u takon për transmetimin e vlerave profesionale dhe ruajtjen e zhvillimin e specialiteteve për të cilat ka nevojë FA”, - kështu do ta hapte

fjalën e rastit komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri në ditën e diplomimit të 80 oficerëve të rinj, mes të cilëve 52 studentë të brezit të parë të degës “Shkenca Ushtarake”, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave të Armatosura.

“Klasa e vitit 2023 ju jeni gati të përballeni me sfidat që ju presin. Ju jeni gati të merrni përgjegjësi, Ju jeni gati për të drejtuar. Ju jeni edukuar për të jetuar me nder. Ju keni aftësitë të arrini majat. Paçi bekimin e Zotit në udhëtimin tuaj, në të ardhmen si oficerë!”, - do e mbyllte urimin e tij gjeneral brigade Bilbil Bitri.

Një rrugëtim sfidues, dinjitoz, mision për të qenë aty ku e kërkon kombi, detyra.

Ndërsa ministri Peleshi, në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi rrugëtimin e këtyre të rinjve që zgjedhën edukimin ushtarak, një sfidë jo e lehtë, siç u shpreh ai, por një zgjedhje e mbështetur tek vlerat, patriotizmi dhe kombi.

“Shërbimi në Forcat e Armatosura është më shumë sesa një mision, ai është mishërimi i detyrës së vështirë, sakrificës por në të njëjtën kohë është sfida e të qenit i pari aty ku e kërkon kombi e detyra”, - theksoi në fjalën e tij ministri Peleshi.

Gjithashtu ministri Peleshi vlerësoi edhe punën që bëhet në



Akademinë e FA-së për formimin e të rinjve që zgjedhin të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura: “Synojmë ta kthejmë këtë akademi në një ‘laborator’ të formimit të gjeneratës së re të oficerit të ri, liderit të ardhshëm më të mirë në nivel kombëtar”, - deklaroi ministri Peleshi. Për vitin akademik 2023 - 2024 në këtë Akademi do të çelen programet bachelor në: “Marrëdhënie Ndërkombëtare në fushën e Mbrojtjes” dhe “Shkenca Komunikimi në fushën e Mbrojtjes”, programe, të cilat, sipas ministrit, mbështeten në komponentët e lidërshiptit, karakterit, ekselencës akademike e përgatitjes së lartë fizike, model i huazuar nga eksperiencia 240 vjeçare amerikane, falë partneritetit me akademinë ushtarake të SHBA-së “West Point”.

Më tej, gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi tha se: “... si vend anëtar i NATO-s, këta oficerë do të mësojnë të drejtojnë ekipe efektive plotësisht të afta të mbështesin operacionet e përbashkëta dhe shumëkombëshe, në mesin e një ndryshimi teknologjik dhe organizativ të



shpejtë e të vazhdueshëm”.

Ministri i Mbrojtjes njoftoi se kanë nisur bashkëpunimet me Qendrën e Ekselencës Kibernetike në Estoni, ndërsa ka filluar në zbatim të ideve inovative në funksion të përmirësimit të

kapaciteteve dhe standardeve, si dhe kushteve të punës e jetesës së djemve dhe vajzave të punës në uniformë: “Sfidave që paraqet koha, por edhe falë profesionit tuaj të veçantë, qeveria shqiptare ka vendosur t’u përgjigjet nëpërmjet një vëmendjeje të shtuar, duke ofruar një paketë mbështetjeje komplekse që përfshin modernizimin, rritjen e pagave, trajtim financiar për vështirësitë si dhe mbështetje me strehim për oficerët që shërbejnë larg qendrave të tyre të banimit”, - theksoi ministri Peleshi.

Në fund, ai ftoi të rinjtë e të rejtat që të ndjekin rrugën e këtyre oficerëve të sapo diplomuar, t’u bashkohen Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes në fjalën e tij theksoi se kanë nisur bashkëpunimet me Qendrën e Ekselencës Kibernetike në Estoni, ndërkohë

ka filluar edhe procesi për anëtarësimin e Qendrës së Ekselencës në Finlandë për kërcënimet hibride.

Duke folur për ngritjen e qendrës së Inovacionit teknologjik, pjesë e FA-së, ministri Peleshi tha se ajo do të shërbejë dhe vënien oficerëve të sapo diplomuar, t’u bashkohen Forcave të Armatosura, për t’i shërbyer një realiteti të ri, më të mirë pajisur, më të mirë trajnuar dhe më të mirë arsimuar. Pjesë e oficerëve të rinj që sapo morën këtë titull janë edhe 52 studentët e brezit të parë të degës “Shkenca Ushtarake”, ndërsa 28 janë të “Kursit të Oficerit të Ri. Mes tyre titullin “oficer” e morën edhe 21 vajza.



## MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI, VIZITË ZYRTARE NË BRITANINË E MADHE

# Ministri Peleshi: Politika e jashtme e Shqipërisë, e orientuar drejt fqinjësisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor

**M**inistri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Britaninë e Madhe. Ministri Peleshi u prit në një takim nga sekretari Shtetit për Mbrojtjen Ben Wallace. Në këtë takim z. Peleshi shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Ministria e Mbrojtjes së Britanisë ka dhënë për Forcat e Armatosura shqiptare. Nga ana e tij, sekretari Wallace shprehu gatishmërinë për intensifikimin e këtij bashkëpunimi në kuadër të Aleancës, por dhe në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe rajonal.

Po ashtu ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u prit nga ministrja e Shtetit baronesha Goldie DL. Të dy ministrat nënshkruan Deklaratën e Përbashkët mbi Rritjen e Bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes, dokumenti i cili synon përforcimin e bashkëpunimit aktual, identifikimin e fushave të reja të bashkëpunimit për të përballuar sfidat si dhe për t'iu përshtatur risive të reja që sjell koha dhe mjedisi gjithnjë e më shumë konkurrues dhe kompleks. Si dy vende anëtare të NATO-s, ministrat rikonfirmuan vendosmërinë e tyre për të vijuar kontributin në sigurinë ndërkombëtare, duke përfshirë mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën, si dhe rritjen e angazhimit për sigurinë e Ballkanit Perëndimor dhe krahut jugor të NATO-s.

Një tjetër takim, ministrit Peleshi iu rezervua nga kreu dhe disa anëtarë të grupit parlamentar shumë-partiak për Shqipërinë, ku diskutuan mbi zhvillimet e fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjatë këtij takimi ministri Peleshi theksoi se politika e jashtme e Shqipërisë është gjithmonë e më shumë e orientuar drejt fqinjësisë së mirë, sigurisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor. Ministri Peleshi u prit në një takim të veçantë nga i dërguari i posaçëm i kryeministrit britanik për Ballkanin Perëndimor sir



Stuart Peach, një mik i hershëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje me interes për zhvillimin, sigurinë, stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, rolin e Shqipërisë në rajon, ku një vëmendje të veçantë iu kushtua çështjes së Kosovës.

Në Britaninë e Madhe, një vend të rëndësishëm ministri Peleshi i dha dhe vizitës në JHubDefence, qendër e inovacionit të Komandës Strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, "Aty ku ndërlihet teknologjia dhe talenti i klasit botëror me përdoruesit në të gjithë sistemin e mbrojtjes. Një shembull për Qendrën e re të Inovacionit që do të hapet së shpejti edhe në Shqipëri", - u shpreh ministri Peleshi.





# Ministri Peleshi: Rikonfirmojmë mbështetjen politike dhe logjistike ndaj popullit ukrainas

**M**inistri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji morën pjesë virtualisht në takimin e 12-të të Grupit të Kontaktit për Ukrainën. Mes të tjerash, nga ana e tij ministri Peleshi rikonfirmoi mbështetjen politike të Shqipërisë, krahas aleatëve perëndimorë, vijimin e ndihmave logjistike si kontribut i nevojshëm për popullin ukrainas në mbrojtje të integritetit territorial dhe paqes.



# Ministri Peleshi: Sllovenia, partnere dhe mbështetëse e Shqipërisë në rrugën e integrimit në Bashkimin European

**M**inistri i Mbrojtjes Niko Peleshi vizitoi Slloveninë, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Sllovenisë, Marjan Sarec.

Në bisedën mes dy ministrave u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira dhe bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Sllovenisë, jo vetëm në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Ministri Peleshi theksoi se: “Sllovenia është një partnere e Shqipërisë dhe një mbështetëse e vendit tonë në rrugën e gjatë të integrimit në Bashkimin European”.

Në konferencën e përbashkët për mediat, z. Peleshi tha se e njohu homologun e tij Sarec mbi zhvillimet e fundit politike në Shqipëri, mbi reformat e realizuara si dhe angazhimin maksimal të qeverisë shqiptare drejt përbushjes së objektivit madhor atë të anëtarësimit në Bashkimin European.

Duke vënë theksin tek roli i Shqipërisë në favor të fqinjësisë së mirë, prosperitetit dhe promovimit të vlerave demokratike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ministri Peleshi tha se kërkoi nga homologu slloven të vijonte mbështetjen në përfshirjen e Kosovës në nisma rajonale, në të cilat ajo mund të japë kontributin e saj dhe të jetë një vlerë e shtuar për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal.

Ministri i Mbrojtjes e njohu ministrin Sarec edhe me reformat dhe vëmendjen e veçantë të qeverisë shqiptare për reformimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë këtu investime në fushën e Mbrojtjes kibernetike, në industrinë ushtarake si dhe përmirësimin e ndjeshëm të trajtimit financiar të ushtarakëve. “Një vëmendje të veçantë po i kushtohet reformave në fushën e edukimit dhe trajnimit të personelit të Forcave të Armatosura, për të cilat personalisht besoj fort se një investim i tillë sot do të sjellë një të ardhme më të ndritur dhe cilësore për ushtrinë shqiptare”, -



u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Ministrat e Shqipërisë dhe Sllovenisë shkëmbyem ide dhe ranë dakord të intensifikojnë bashkëpunimin në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes si dhe angazhuan stafet respektivë në hartimin dhe implementimin konkret të këtyre ideve.

## Ministri Peleshi: Së bashku me aleatët jemi të vendosur në mbështetje të paqes dhe sigurisë në rajon

**M**inistri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në takimimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën. Grupi i Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën (UDCG), është një iniciativë e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve, që mbledh së bashku aleatë dhe partnerë nga e gjithë bota, për të diskutuar mbi bashkëpunimin dhe sfidat e sigurisë që duhen përballuar si pasojë e agresionit rus në Ukrainë.

Ministri Peleshi gjithmonë ka shprehur mbështetjen e tij dhe të qeverisë shqiptare ndaj popullit ukrainas. Edhe në këtë takim ai do të mbante qëndrimin e tij ndaj agresionit rus në Ukrainë: “Sërish së bashku me aleatët tanë, në Grupin e Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën, nën drejtimin e Sekretarit të Mbrojtjes Lloyd J. Austin III, për të rikonfirmuar mbështetjen



diplomatike, politike, ushtarake, ekonomike dhe sociale për Ukrainën. Të vendosur në mbështetje të paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë”, - tha Peleshi.





# Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi pret Kreun e Zyrës së Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara

**M**inistri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji pritën në një takim Kreun e Zyrës së Gardës Kombëtare të SHBA-së, gjeneral Daniel R. Hokanson.

Gjatë takimit u diskutua mbi mjedisin aktual të sigurisë dhe sfidat në kufirin lindor të Aleancës, situata në rajon dhe ajo në Ukrainë, siguria kibernetike, angazhimet e vendit tonë në kuadër të NATO-s si dhe me fokus të veçantë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes me SHBA-të.

Nga të dyja palët u shpreh shqetësimi për konfliktin në Ukrainë, ndërsa u theksua rëndësia e vijimit të mbështetjes nga aleatët. Vëmendje të veçantë mori edhe situata aktuale në veriun e Kosovës, si dhe ndikimi i mundshëm në stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ministri Peleshi theksoi rëndësinë e prezencës së trupave të NATO-s në lindje, Letoni dhe Bullgari, dhe njëkohësisht në KFOR, Kosovë.

Ministri i Mbrojtjes theksoi gjatë bisedës rolin dhe angazhimet e vendit tonë për garantimin e paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë. Ai u ndal në sfidat për zhvillimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në përballje me situatën aktuale të sigurisë.

Ministri Peleshi vlerësoi rolin e Zyrës së Gardës Kombëtare të SHBA-së. Ai shprehu njëherësh mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakushtëzuar që SHBA ka dhënë për vendin tonë, duke nxjerrë në dukje në mënyrë të veçantë

bashkëpunimin e shkëlqyer në fushën e mbrojtjes me Gardën Kombëtare të New Jersey-it dhe mbështetjen e dhënë prej tyre për zhvillimin e kapaciteteve të FARSH.

Gjenerali Hokanson shprehu mirënjohjen e tij për rolin e Shqipërisë në NATO, duke e vlerësuar Shqipërinë si një vend partner dhe aleat tepër i besueshëm. Gjenerali Hokanson deklaroi se mbështetja e SHBA-ve do të jetë e vazhdueshme për përmirësimin e kapaciteteve në përballje me sfidat e kohës.



# Ministri Peleshi pret shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Rumanisë

**M**inistri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi priti në një takim shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Rumanisë, gjeneral Daniel Petrescu, i cili shoqërohej nga ambasadori i Rumanisë në vendin tonë, z. Octavian Serban dhe atasheu ushtarak, kolonel Valerica Piroasca.

Në këtë takim u vlerësua bashkëpunimi mes dy vendeve në fushën e Mbrojtjes. Diskutimi u përqendrua veçanërisht në zhvillimet dhe angazhimet e të dy vendeve në mjedisin aktual të sigurisë, përpjekjet e përbashkëta për mbështetjen e Aleancës ndaj Ukrainës. Mes ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi dhe delegacionit të Rumanisë u diskutua mbi identifikimin e fushave të reja për bashkëpunim të përbashkët në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë, si dhe përpjekjet e pandalshme të vendeve për kufizimin e influencave keqdashëse në rajonet respektivë.





# Samiti i NATO-s, Peleshi: Shqipëria e angazhuar për të shtuar shpenzimet për mbrojtjen

**K**ryeministri Rama i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ministrja e Punëve të Jashtme Olta Xhaçka dhe kreu i SHISH, Vlora Hyseni, mori pjesë në Samitin e NATO-s, i cili mbledhi liderët e të gjitha vendeve që janë anëtare të Aleancës Transatlantike.

Kryeministri Rama i është bashkuar punimeve të Samitit të NATO-s me kërkesë nga senatorët dhe fokusi i bisedës ishte shqetësimi për situatën në Veriun e Kosovës.

Kryeministri Rama për mediat nga Vilnius, Lituani, do shprehë: “Me delegacionin e Senatorëve Amerikanë në Samitin e NATO-s, në një takim të kërkuar prej tyre nisur nga shqetësimi për situatën në Veriun e Kosovës dhe qasjen jo konstruktive të palëve, e cila ka çuar në një përshkallëzim të rrezikshëm që duhet ndaluar një orë e më parë, për t’u kthyer në tryezën e Dialogut, duke finalizuar Marrëveshjen e Normalizimit”.

Kreu i qeverisë shqiptare zhvilloi një seri takimesh dypalëshe me drejtues të lartë të shteteve anëtare të NATO-s.

“Ky takim i ka gjetur aleatët e NATO-s më të fortë e më të vendosur për të mbrojtur lirinë dhe sigurinë e popujve”, - do të shprehë kryeministri Rama. Në qendër të diskutimeve ishte dhe situata në Ukrainë si dhe kërkesa e këtij shteti për t’u bërë pjesë e aleancës ushtarake.



Nga ana e tij ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, u shpreh se: “Shqipëria është e angazhuar dhe vullnetplotë për të shtuar shpenzimet për mbrojtjen. Me aleatët e partnerët tanë, të unifikuar në qëndrimin për të vijuar mbështetjen ndaj Ukrainës, për ta ndihmuar në rrugën e saj drejt NATO-s. Vendime kyçe në një moment kritik për sigurinë tonë. Shqipëria e angazhuar dhe vullnetplotë për të shtuar shpenzimet për mbrojtjen!”



# Ministri Peleshi nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë

Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi zhvilloi një vizitë zyrtare në Izrael.

Z. Peleshi u prit me një ceremoni zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes të Izraelit nga homologu i tij, zoti Yoav Gallant.

Ministrat e Mbrojtjes nënshkruan Memorandumin e ri të Mirëkuptimit në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, marrëveshje e nivelit të lartë që krijon një bazë solide ligjore për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, mbrojtjes, teknologjisë ushtarake, trajnimeve dhe shkëmbimit të informacionit.

Zgjerimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit, që është kornizuar në çdo dispozitë të marrëveshjes së re do të reflektojë marrëdhëniet e shkëlqyera historike dhe diplomatike si dhe vlerësimin reciprok që



populli hebre dhe ai shqiptar kanë për njëri-tjetrin. Bëhet fjalë për një draft të negociuar prej disa muajsh nga stafet respektivë me qëllimin dhe dëshirën e mirë për të nisur, një epokë të re bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë. Dy ministrat biseduan në lidhje me zhvillimet më të reja në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Lindjen e Mesme si dhe në Ukrainë.

Zoti Peleshi rikonfirmoi vullnetin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të qeverisë shqiptare për intensifikimin e bashkëpunimit me Izraelin në fushën e Mbrojtjes në mënyrë të veçantë në sigurinë kibernetike, industrinë e mbrojtjes dhe shkëmbimin e informacionit.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se qëndrimi i Shqipërisë për Lindjen e Mesme vijon të jetë ai për një rajon në paqe dhe në stabilitet, me një dialog të qëndrueshëm ndërmjet faktorëve, por theksoi se nuk ka asnjë tolerancë për aktet terroriste kundër shtetit të Izraelit dhe popullit të tij, pasi terrori dhe dhuna kundër një populli nuk mund të tolerohet dhe të justifikohet. Vëmendje të veçantë gjatë diskutimeve mori situata në Ballkanin Perëndimor. Zoti Peleshi vlerësoi mbështetjen që Izraeli i jep Republikës së Kosovës, njohjen e pavarësisë së saj dhe ftoi Zotin Gallant për një lobim më të fuqishëm për shtimin e njohjeve ndërmjet vendeve që janë ende skeptike. Vizita e ministrit të Mbrojtjes në Izrael vijoi me z. Yuli Edeistein, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe Mbrojtjen, i cili



rikonfirmoi vullnetin e plotë për të avancuar marrëdhëniet mes dy vendeve. Izraeli është një aleat dhe partner i rëndësishëm në mbrojtje dhe siguri si dhe një anëtar aktiv i Dialogut Mesdhetar të NATO-s. Një pjesë e rëndësishme e takimeve të ministrit Peleshi ishte dhe ai me z. Gaby Port-

noy (Big Gen ret.), Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Kombëtare Kibernetike të Izraelit, i cili u shpreh se ishin të interesuar të intensifikonin bashkëpunimin për sigurinë kibernetike, përmes sistemit të të dhënave, ngritjen e kapaciteteve kombëtare si dhe në fushën e mbrojtjes.



# Prezantohen rezultatet e monitorimit të satelitëve “Albania 1” dhe “Albania 2”

**N**ë aktivitetin, ku morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, drejtues të institucioneve të ndryshme dhe ekspertë, u prezantuan produktet e para të shërbimit satelitor.

Zëvendëskryeministria Belinda Balluku tha se Shqipëria ka arritur të monitorojë përmes dy satelitëve të lëshuar në hapësirë, “Albania 1” dhe “Albania 2”,

47% të territorit.

“Me një gamë të gjerë përdorimi, nga parandalimi i zjarreve të përmytjet, duke vijuar te bujqësia dhe ndërtimi pa leje, Shqipëria përmes satelitëve të hedhur në hapësirë, “Albania 1” dhe “Albania 2”, - sipas zëvendëskryeministres Belinda Balluku, - bëhet pjesë e ekonomisë së re të hapësirës, duke zhvilluar përfshirjen e saj në komunitetin hapësinor, mes shfry-

tëzimit të fuqisë së imazheve satelitore me rezolucion të lartë, të cilat mundësojnë realizimin e ambicieve tona si vend anëtar i NATO-s”.

Kryeministri Edi Rama u shpreh se falë shërbimit satelitor kemi një bazë fantastike të leximit të territorit sipas nevojave të dikastereve, gjë që e bën të pamundur korrupsionin në shumë fusha: “Deri më 21 qershor janë mbledhur të dhëna nga





16.324 km<sup>2</sup> të Republikës së Shqipërisë. Për shkak se moti e vështirësoi shumë punën e atyre që janë përfshirë në këtë proces, kompania ofruese e shërbimit shtoi edhe 8 satelitë të tjerë pa asnjë pagesë ekstra për të na furnizuar me më shumë imazhe në ato periudha kohe”, - tha Kryeministri.

Duke folur për përmbytjet, kryeministri Edi Rama tha se: “Harta satelitore e bën të pamundur që një përmbytje prej 3 km<sup>2</sup> të kthehet në një përmbytje prej 15 km<sup>2</sup> duke shtuar aty viktimë të ujit, e prona të dëmtuara për të rritur faturën në kurriz të shtetit, duke rritur dhe normën e korrupsionit. Kjo sepse janë imazhet dhe identifikimi i dëmeve, që deri dje bëhej me grupe në këmbë në terren mund ta bëjmë tani vetëm me një imazh”. Kryeministri Edi Rama ftoi punonjësit e teknologjisë së informacionit – IT, që të punojnë për shtetin shqiptar, duke premtuar paga më të mira e konkurruese se në sektorin privat, krahasuar edhe me rajonin.

Gjatë aktivitetit, u prezantuan dhe dy shembuj konkretë ku Agjencia e Mbrojtjes

**“Harta satelitore e bën të pamundur që një përmbytje prej 3 km<sup>2</sup> të kthehet në një përmbytje prej 15 km<sup>2</sup> duke shtuar aty viktimë të ujit, e prona të dëmtuara për të rritur faturën në kurriz të shtetit, duke rritur dhe normën e korrupsionit. Kjo sepse janë imazhet dhe identifikimi i dëmeve, që deri dje bëhej me grupe në këmbë në terren mund ta bëjmë tani vetëm me një imazh”.**

Civile ka përfituar informacion të vlefshëm përmes satelitëve, siç është rasti i zjarrit në ishullin e Sazanit, ngjarje e ndodhur në qershor 2022, ndërsa rasti i dytë ka të bëjë me përmbytjet në qarkun e Shkodrës, në fshatin Muriqan. Sipas përfaqësueses së Agjencisë së Mbrojtjes Civile, Gentiana Maçi ky monitorim ndihmon në parandalim dhe në ndërhyrje sa më efektive.

Një ekip ekspertësh nga të gjitha institucionet kanë nisur prej kohësh trajnimin pranë “Satellogic” për përdorimin e teknologjisë të avancuar për përpunimin dhe analizimin e imazheve satelitore.

Ekipi i trajnuar i ASIG po ndërton raste dhe shembuj që do të jenë në ndihmë të institucioneve publike për të analizuar dhe marrë vendime në kohë sa më të shkurtër.

# SHSHPFA, gjeneral brigade Kingji merr pjesë në konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm (BCHOD-s)

**S**hefi i Shtabi të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm (BCHOD-s) e mbajtur në Sofje. Në këtë konferencë u diskutua mbi gjetjen e rrugëve të reja të bashkëpunimit ushtarak, ruajtjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rajonit. Në muajin nëntor, Shqipëria do të mirëpresë zhvillimin e stërvitjes së përbashkët “Strong Balkan-23”, si një mundësi e shkëlqyer që do të rrisë dhe forcojë ndërveprimin ushtarak të vendeve pjesëmarrëse anëtare të nismës së BCHOD-s.







## SHSHPFJA, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Takimin e 189-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë në Takimin e 189-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në Bruksel, Belgjikë.

Shefat e Mbrojtjes u mblodhën në këtë takim për të diskutuar mbi sfidat dhe prioritetet kryesore të Aleancës përpara Samitit të Vilniusit.

Gjatë këtij takimi ata vlerësuan progresin në zhvillimin e Planeve Rajonale dhe Modelin e ri të Forcave të NATO-s, i nevojshëm për të pasur më shumë trupa në gatishmëri të lartë, në përgjigje ndaj çdo situatë dhe nevojë.

Shefat e Mbrojtjes diskutuan gjithashtu edhe rreth zhvillimit të Planeve Rajonale të Mbrojtjes, kërkesat për forca ushtarake për strukturën e Aleancës si dhe rishikimin e komandim - kontrollit.

Ky takim i rëndësishëm i paraprin zhvillimit të Samitit të Vilniusit, që do të mbahet në muajin korrik, ku mbështetja politike duhet të shkojë paralelisht me objektivat strategjike ushtarake, në epokën e re të mbrojtjes kolektive dhe vlerave demokratike që po cenohen për mbi 15 muaj, që pas agresionit rus në Ukrainë.





# Presidenti Bajram Begaj dekreton dhënien e gradës madhore “gjeneralmajor” për SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji

**P**residenti i Republikës së Shqipërisë sh. t. z. Bajram Begaj, në mbështetje të nenit 92, shkronja “d”, e nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të pikës 3, shkronja “b”, të nenit 9 të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Kryeminis-

trit, ka dekretuar dhënien e gradës madhore “gjeneralmajor” për shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji.

Me këtë rast ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi uroi gjeneralmajor Kingjin: “Një vlerësim i merituar për përkushtimin dhe kontributin e pakursyer”.



## Gjeneralmajor Arben Kingji, në ceremoninë e përcjelljes së ekipit të Policisë Ushtarake në misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguese në Sinai, Egjipt

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në ceremoninë e përcjelljes së ekipit të Policisë Ushtarake në misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguese në Sinai, Egjipt.

Në ceremoni ishin të pranishëm gjithashtu edhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Policisë Ushtarake, kolonel Shkëlqim Çela, drejtorë drejtorish në MM dhe SHP, etj. Në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni, gjeneralmajor Kingji u shpreh ndër të tjera se: “Angazhimet në misionet e ndryshme jashtë vendit aktualisht vazhdojnë të ngelen një nga detyrat tona më të rëndësishme. Me nisjen e këtij ekipi të Policisë Ushtarake në misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguese në Sinai, Egjipt, Policia Ushtarake dhe Forcat tona të Armatosura zgjerojnë gjeografinë e angazhimeve dhe kontributeve tona në botë...”.

Më tej, gjatë përshëndetjes së tij SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji pasi vlerësoi faktin që FARSH merr pjesë për herë të parë në një mision me rëndësi kritike dhe në një angazhim të suksesshëm të SHBA-së për stabilitetin rajonal në Lindjen e Mesme që prej 40 vitesh, u shpreh besimplotë që ekipi i Policisë Ushtarake do të tregojë përgjegjshmëri dhe profesionalizëm, si në të gjitha misionet që FARSH-të janë angazhuar. “Në kushtet kur ky është edhe efektiviteti ynë i parë që angazhohet në këtë mision në një rajon vazhdimisht të nxehtë dhe delikat, sikurse është Lindja e Mesme, emri,



profili dhe gjurmët që do të lini ju, do të jenë baza dhe avantazhet e grupeve pasardhëse që do të shërbejnë atje. Unë kam besim të plotë tek përgjegjshmëria, përkushtimi dhe ambicia juaj, se si gjithmonë dhe si të gjithë efektivët tanë të angazhuar kudo në misionet jashtë vendit, do ta kryeni këtë shërbim me faqe të bardhë, do të na nderoni dhe do të jeni shembull për ekipin e radhës...”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Arben Kingji. Misioni i Sinait është një forcë civilo-ushtarake e përbërë nga 13 shtete nën lidershipin amerikan dhe është me rëndësi kritike dhe një angazhim i suksesshëm i SHBA-së për stabilitetin rajonal në Lindjen e Mesme që prej 40 vitesh dhe mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të sigurisë të Traktatit të Paqes Egjiptiano-Izraelit të vitit 1979.

# Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitë zyrtare në SHBA

**S**htetet e Bashkuara të Amerikës, në muajin korrik 1993, krijuan Programin e Partneritetit Shtetëror (SPP) që bashkon 100 vende të botës me Gardën Kombëtare, në ndihmë të rritjes së sigurisë rajonale dhe interesave të influencës gjeopolitike, një partneritet që kalon kufijtë ushtarakë të bashkëpunimit, duke u fokusuar gjithashtu në fusha të tjera si: reagimi ndaj emergjencave civile, edukimi, zhvillimi ekonomik, në sektorët e tjerë civilë, përkujdesi shëndetësor, qeverisja e mirë etj.

Programi i Partneritetit Shtetëror prodhon marrëdhënie të shkëlqyera e të qëndrueshme që përmirësojnë ndërveprueshmërinë, rrisin aksesin dhe gatishmërinë e forcave të SHBA-ve dhe vendeve partnere për të përballuar sfidat e reja. “Ky program i përgjigjet Strategjisë së Mbrojtjes së SHBA-së, ku aleancat dhe partneritetet me përfitim reciprok janë një forcë e qëndrueshme dhe kritike për vitet në vijim”, - sikundër është shprehur gjeneral Hokanson, shefi i Byrosë së Gardave Kombëtare, i cili njëkohësisht menaxhon dhe administron ecurinë e Programit të Partneritetit Shtetëror.

Shqipëria është pjesë e këtij programi bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, që nga viti 2001. Në këto 22 vite bashkëpunimi bilateral dhe miqësie, vlen të theksohet se Shqipëria dhe Nju Xhersi kanë një nga programet më aktive të bashkëpunimit, veçanërisht vitet e fundit, ku më shumë se 1000 efektivë të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit dhe efektivë të Forcave të Armatosura të RSH, kanë zhvilluar trajnime dhe stërvitje të përbashkëta me fokus zhvillimin e kapaciteteve dhe procesit të mirëmbajtjes logjistike, aftësimin e trupës së nënofficerëve dhe oficerëve, përmirësimin e procedurave standarde ushtarake mjekësore, mbrojtjen kundër armëve të dëmtimit në masë, përdorimin e teknikës së re të armatimit, zhvillimit të kapaciteteve kundër mjeteve shpërthyes, minave etj.

Pjesëmarrja jonë në stërvitjet shumëkombëshe “Defender Europe - 21” dhe “Defender Europe - 23” ishte një mundësi e shkëlqyer e vendit dhe Forcave të Armatosura, të testojnë nivelet e gatishmërisë dhe aftësive në realizimin e skenarëve të ndryshëm ushtarakë. Përmbyllja me sukses e të dy stërvitjeve, i hapi rrugë mundësisë së zhvillimit të stërvitjeve të tjera të radhës “Defender Europe 2024 dhe 2025”.

Një mbështetje e jashtëzakonshme është dhënë në konso-



lidimin e Grup - Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, në trajnim, standardizim rregulloresh dhe procedurash, realizim stërvitjesh të përbashkëta në të gjitha nivelet, brenda dhe jashtë vendit (në Fort Drum, New York) si dhe asistenca me grupe këshillimi gjatë procesit të certifikimit sipas sistemit të NATO, CREVAL si njësi “Combat Ready”, në shtator 2022.

Ecuria e suksesshme e partneritetit me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit (GKNJ) është reflektim i marrëdhënieve të shkëlqyera me aleatin tonë strategjik dhe mik të shqiptarëve. Instalimi i ekipeve të shumta trajnuese amerikane në Shqipëri si: Task Force Balkans e Forcave Speciale, Brigada e Asistencës së Forcave të Sigurisë, asistenca e këshilltarëve për personelin, planifikimin dhe donacionet e ndryshme, kanë bërë të mundur që Forcat e Armatosura të jenë në rrugën e duhur të zhvillimit dhe modernizimit të saj në teknike, pajisje, armatim, në procedura dhe doktrina në përputhje me standardet përëndimore ushtarake, në fushën e mbrojtjes



të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji. Përgjatë konferencës 2 - ditore panelet e drejtuara nga të ftuar nderi: gjeneral Mark Milley, shefi i Shtabëve të Ushtrisë Amerikane, gjeneral Daniel R. Hokanson, shefi i Byrosë së Gardave Kombëtare dhe përfaqësues të tjerë të lartë nga Departamenti Amerikan i Mbrojtjes, diskutuan tema mbi: kërcënimet ndaj sigurisë globale, bashkëpunimin ushtarak dhe sigurinë kibernetike.

“Qëllimi i vërtetë i këtyre programeve është ndërtimi i lidhjeve të forta e të qëndrueshme njerëzore dhe më pas ushtarake, ku oficerët e rinj të sotëm përgjatë viteve do të promovohen në poste të rëndësishme ushtarake dhe civile, dhe do të kenë një këndvështrim mirëkuptues dhe me respekt kundrejt Shteteve të Bashkuara”, - deklaroi gjeneral Daniel R. Hokanson.

kibernetike, trajnimin e pilotëve, në procesin e transformimit të sistemit arsimor ushtarak në trajnimin e stafeve, përmirësimin e kurrikulave dhe zhvillimin e rregulloreve, duke u bazuar në standardet e sistemit të akademisë “West Point”. Të gjitha këto bashkëpunime kanë qenë faktor i promovimit të miqësisë dhe lidhjeve të ngushta mes dy ushtrive tona.

“SHBA është aleati ynë më i rëndësishëm dhe i jemi mirënjohës për bashkëpunimin dhe marrëdhënien e shkëlqyer, që ekziston mes dy vendeve tona. Mbështetja që na kanë dhënë ndër vite, ka përmirësuar kapacitetet operacionale dhe ndërvepruese të Forcave tona të Armatosura. Duke ndjekur historitë e mëparshme shumë - dimensionale të suksesit, ky bashkëpunim do të jetë gjithnjë e në rritje në vitet në vijim”, - deklaroi gjeneralmajor Arben Kingji, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjatë takimit me gjeneral Daniel R. Hokanson, shefin e Byrosë së Gardave Kombëtare, përgjatë vizitës në Shqipëri.

Nisja e një sërë projektesh të rëndësishme të modernizimit me SHBA-të, duke u bazuar në ndryshimet e fundit në strukturën e Forcave të Armatosura, krahas bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, mbështetja me ndihma dhe ekipe këshilluese nëpërmjet programeve të ndryshme të Departamentit Amerikan kanë bërë të mundur që Forcat e Armatosura të rrisin kapacitetet operacionale, me qëllim që të jenë të ndërveprueshme me vendet anëtare në NATO, dhe të gatshme t'i përgjigjen në çdo kohë, sfidave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Në datat 17 - 18 korrik 2023, shënohet 30 - vjetori i krijimit të Programit të Partneritetit Shtetëror, ku zyrtarë të lartë politikë dhe ushtarakë nga 100 vende të botës u mbledhën në Maryland, SHBA, në konferencën që u organizua për këtë event. Përfaqësuesi i Shqipërisë ishte shefi i Shtabit

Shqipëria është anëtare e iniciativave të ndryshme rajonale si: Adriatik 5 (A5), Balkan CHOD-s, DECI, SEDM, RACVIAC, BMTF, vendi ynë është i angazhuar plotësisht në promovimin e paqes në rajon, si dhe është i palëkundur në rrugën drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Është mbështetëse e dialogut Kosovë-Serbi, si një ndër hapat parësorë për ruajtjen e qëndrueshmërisë së sigurisë në rajon dhe vlerëson rolin dhe përpjekjet e SHBA-së dhe BE-së për këtë qëllim. Falë ftesës së SHBA-së, vendi ynë për herë të parë merr pjesë me efektivë të saj në misionin e “Forcës Shumëkombëshe dhe e Vëzhguesve” në Sinai, Egjipt, ku pritet që në vitet në vijim të zgjerohet harta gjeografike e kontributeve tona në misione ndërkombëtare. Krijimi, ruajtja dhe intensifikimi i marrëdhënieve efektive të zgjatura në kohë është një ndër prioritetet e bashkëpunimit ushtarak me Shtetet e Bashkuara.



# GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU

## MORI PJESE NË DITËN E VIZITORËVE TË SHQUAR TË STËRVITJES “SABER GUARDIAN 23”

Zëvendëshefi  
i Shtabit të  
Përgjithshëm të  
FA-së shqiptare,  
gjeneralmajor  
Manushaqe Shehu  
mori pjesë në Ditën  
e Vizitorëve të  
Shquar të stërvitjes  
“Saber Guardian”,  
zhvilluar në  
Rumani në kuadër  
të stërvitjes së  
madhe “Defender  
Europe 23”.

Në këtë stërvitje, Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan me një togë të Policisë ushtarake, e atashuar pranë Kompanisë së Policisë Ushtarake Amerikane.

Gjatë pritjes në Ditën e Vizitorëve të shquar, zhvilluar në rajonin stërvitor Bordusani (Ialomita), gjeneralmajor Shehu e shoqëruar dhe nga atasheu ushtarak i Shqipërisë

në Rumani, kolonel Leonard Çoku, u takua me ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Rumanisë z. Angel Tîlvar dhe shefin e Shtabit të Mbrojtjes, gjeneral Daniel Petrescu, të cilët i falënderoi për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, si dhe për pjesëmarrjen e togës së Policisë Ushtarake, si pjesë e kësaj stërvitjeje. Gjithashtu gjenerale Shehu takoi edhe drejtues të tjerë të lartë, përfaqësues



të vendeve pjesëmarrëse në stërvitje. Gjeneralmajor Shehu pati një takim të veçantë edhe me përfaqësuesit e Forcave të Armatosura, efektivin e Policisë Ushtarake, të cilët i falënderoi për disiplinën, korrektësinë, profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar në këtë stërvitje.

Stërvitja “Saber Guardian”, pjesë e “Defender Europe 23”, u zhvillua në Poligonin Smârdan, Bordushani në Qarkun Galati, ku morën pjesë rreth 10 000 trupa nga 13 vende aleate dhe partnere, Shqipëria, Bullgaria, Italia, Franca, Greqia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Polonia, Portugalia dhe Holanda. Moldavia u përfaqësua nga një detashment ushtarësh të Brigadës së Këmbësorisë së Mekanizuar.

“Saber Guardian” ishte stërvitja më e madhe ushtarake e planifikuar në Rumani këtë vit, dhe është Ushtrimi i tretë dhe i fundit i lidhur me “Defender Europe 23”, pjesë e angazhimit dinamik të parandalimit të NATO-s në 2023. Të udhëhequr nga Ushtria e SHBA-së në Evropë dhe një divizion shumëkombësh rumun, aktivitetet e “Saber Guardian” përfshinë përdorimin e pajisjeve të paracaktuara, një marshim taktik rrugor, kalime lumore, manovra për t’iu përgjigjur kërcënimeve të simuluar kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore dhe operacionet e evakuimit mjekësor.

Në territorin e Rumanisë, stërvitja “Saber Guardian” zgjati nga data 27 maj deri më 9 qershor dhe u drejtua nga Komanda e Forcave të Përbashkëta, duke përfaqësuar aktivitetin më të madh dhe më kompleks stërvitor shumëkombësh këtë vit në territorin e Rumanisë.

Stërvitja shumëkombëshe “Saber Guardian 23” vazhdon serinë dyvjeçare në kuadër të “Defender Europe 23” dhe synimi kryesor është të rrisë ndërveprueshmërinë në një gamë të gjerë misionesh për forcat nga NATO dhe shtetet partnere. Aktivitetet stërvitore përfshijnë veprime taktike në tokë, forcimin e rrjedhave ujore, ushtrime taktike me dhe pa gjuajtje luftarake me teknikën e të gjitha kategorive të forcave, parashutat, si dhe aktivitetet e evakuimit dhe trajtimit të të plagosurve.

Sekuencat kryesore të stërvitjes u zhvilluan në Qendrën Kombëtare të Stërvitjes për Betejat “Getica” në Cincu (Brasov), në qendrat sekondare të stërvitjes luftarake në Smârdan

(Galati) dhe Babadag (Tulcea), në qitje tokë-ajër, poligon i Shkollës së Trajnimit të Mbrojtjes Kundërajrore “Gjeneral Ion Bungescu” (Capu Midia) dhe në bazën e 57-të ajrore “Mihail Kogalniceanu” (Constanta). Në të njëjtën kohë, ngjarjet praktike të “Saber Guardian 23” u zhvilluan në rajonin e trajnimit në Slobozia dhe Bordusani (Ialomita), Varsatura (Braila) dhe Frecatei (Tulcea). Shtetet pjesëmarrëse me personel dhe pajisje luftarake në “Saber Guardian 23” ishin: Shqipëria, Bullgaria, Franca, Greqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Polonia, Portugalia, Moldavia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Holanda dhe Rumania. Duke filluar nga ky vit, në kuadër të “Saber Guardian 23” u prezantua një komponent trajnimi në fushën e mbrojtjes kibernetike “CYBER”, në të cilin marrin pjesë specialistë nga Rumania, SHBA-të dhe Mali i Zi.

“Saber Guardian 23”, një kulm i formimit profesional, ishte e integruar në kompleksin e ushtrimeve “Defender



23” dhe përfshiu fazat e planifikimit dhe organizimit, të nisura përpara atyre të ekzekutimit operacional, që u zhvilluan aktualisht. Stërvitjes i ka paraprirë, gjatë muajit maj, faza e fluksit të personelit dhe pajisjeve në rrugët e komunikimit rrugor, detar dhe ajror nga vendet, drejt zonave të stërvitjes dhe u pasua nga faza e përqendrimit të forcave në qershor.

Komanda e Forcave të Bashkuara “Gjeneral Ioan - Emanoil Florescu” ushtroi komandën dhe kontrollin mbi strukturat pjesëmarrëse në “Saber Guardian 23”.



# Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: EOD, aset dhe kapacitet operacional me vlera të veçanta për FARSH

**N**ë mjediset e batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit XIII EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (Enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s, si pjesë e grup-batalionit kanadez të dislokuar në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, drejtorë drejtorish të Shtabit të Përgjithshëm, familjarë, etj.

Në përshëndetjen e saj drejtuar trupave, gjeneralmajore Shehu u shpreh ndër të tjera: “Struktura EOD është bërë një aset dhe kapacitet operacional i sprovuar në shumë angazhime brenda dhe jashtë vendit me vlera të veçanta për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë, e cila është e aftë të kryejë detyra shumë të vështira. Kam bindjen që personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës së ngarkuar dhe do të mbajë lart e me krenari flamurin tonë kombëtar në Letoni...”.

Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin XIII EOD, nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo dhe u përmbyll me një foto të përbashkët.





# Gjeneralmajor Shehu mori pjesë në ceremoninë e certifikimit të KTHOSH

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në ceremoninë e certifikimit të kursantëve të Kursit Themelor të Shtabit (KTHOSH), raundi II. Në ceremoni morën pjesë edhe komandantë forcash dhe të një-sive autonome të FA-së, drejtorë drejtorish të Shtabit të Përgjithshëm, atashu i Republikës së Kosovës i akredituar në Shqipëri, kolonel Enver Hoti, stafi akademik dhe mbështetës si dhe pedagogë dhe kursantë.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu në përshëndetjen e saj drejtuar të pranishmëve në ceremoni, pasi falënderoi kursantët për përfundimin me sukses të kursit, vuri theksin në mjedisin e sigurisë në të cilin jetojmë sot, i cili kërkon ndryshim të shpejtë të vendimmarrjeve, dhe rëndësinë e plotësisimit të kurrikulës mësimore me informacionet më të fundit që koha kërkon.

Ceremonia u përmbyll me dhënien e certifikatave kursantëve të Kursit të Themelor të Oficerit të Shtabit dhe me një foto të përbashkët.





# Diplomohen kursantët e KKSHP dhe KLO

Pranë ambienteve të auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua ceremonia e Diplomimit të oficerëve në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursin e Lartë të Oficerit, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, Ambasadori i Republikës së Kosovës z. Durmishi, Atasheu Ushtarak i Republikës së Kosovës kolonel Hoti, komandantë forcash dhe të njëjve autonome të FA-së, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm, pedagogë, staf mbështetës etj.

Në fjalën e mirëseardhjes, zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi vlerësoi angazhimin dhe seriozitetin e treguar, si nga ana e kursantëve, stafit akademik dhe personelit mbështetës, duke treguar vlera dhe arritur rezultate të larta në përfundim të vitit akademik. Ai falënderoi Shtabin e Përgjithshëm të FA-së për mbështetjen konstante në zhvillimin normal të aktiviteteve ekstrakurrikulare

brenda dhe jashtë vendit.

Në emër të kursantëve përshëndetën nënkolonel Dritor Papa, përfaqësues nga Forcat e Armatosura dhe nënkolonel Brahim Kokollari përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës, të cilët uruan kolegët për përfundimin me sukses të kursit. Nënkolonel Papa në fjalën e tij falënderuese në emër të kursantëve u shpreh se, gjatë këtij kursi iu kushtua një vëmendje e veçantë stërvitjeve komando-shtabi, ku kursantët aftësohen në role apo funksione të ndryshme në Shtab, në zbatim të skenarëve të përgatitur me kujdes nga stafi pedagogjik i Kolegjit. “Në ndryshim nga vitet e tjera, këtë vit disa prej kursantëve patën mundësi që njohuritë e marra gjatë procesit mësimor t’i vënë në zbatim në funksione të ndryshme në Shtabin e Task-Force SFAB, në kuadrin e stërvitjes “Defender Europe 23”, duke kontribuar në përbushjen me sukses të misionit të kësaj task-force. Falë punës së palodhur të stafit pedagogjik dhe mbështetjes



së këtij kolegji, sot ndihemi më të aftë për të përballuar sfidat e sigurisë dhe në pjesëmarrjen në operacione si brenda dhe jashtë vendit”.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji, në fjalën e tij përshëndetëse, iu uroi suksese në karrierën e tyre kursantëve dhe njëkohësisht, duke falënderuar stafin pedagogjik për punën e përkushtimit e jashtëzakonshëm gjatë procesit të zhvillimit të këtyre dy kurseve të shumë të

rëndësishme, KKSHP dhe KLO, u shpreh se: “Konstatoj me kënaqësi se i gjithë stafi drejtues dhe pedagogjik kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në procesin e konsolidimit të mëtejshëm të kolegjit, duke ofruar cilësi, standarde dhe seriozitet në mësimdhënie. Gjeneralmajor Kingji vlerësoi përkushtimin dhe performancën e kursantëve të KLO-së dhe KKSHP-së, në përfundimin me sukses të studimeve. Në përfundim të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Kingji falënderoi veçanërisht kursantët e FSK-së, dhe u uroi suksese në detyrat e reja.

Programet e këtyre dy kurseve siguruan dhënien e njohurive të nevojshme për planëzimin dhe drejtimin e operacioneve luftarake në një mjedis operacional kompleks dhe të paqartë që lidhet me sigurinë kombëtare, aftësimin për të marrë vendime të drejta dhe për të dhënë këshilla të sakta në rastet kur shqyrtohet përdorimi i forcës ushtarake.

Në këtë ceremoni u diplomuan 43 kursantë të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) dhe 18 të Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) me pjesëmarrje nga strukturat e Forcave të Armatosura të RSH dhe nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Ceremonia u mbyll me foto të përbashkët dhe shpërndarjen e diplomave.



# Studentët e programit Bachelor, pjesë e “Summer Campus 2023”

Studentët e programit Bachelor të vitit II, morën pjesë në programin “Summer Campus 2023”, program i cili u zhvillua në Qendrën e Trajnimit Pepestiste, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Në aktivitetet morën pjesë studentët nga 13 vende partnere dhe anëtare të NATO-s të tilla si: Bosnje-Hercegovina, Mbretëria e Bashkuar, Kosova, Hungaria, Mali i Zi, Bullgaria, Letonia, Kroacia, Sllovenia, Sllovakia, Polonia, Rumania. Për dy javë me radhë studentët: Rama, Gruda, Zhollanji, Goxhaj me në krye pedagogen përgjegjëse toger Nekaj morën pjesë në disiplina të ndryshme, dhe përfaqësuan me ditjet AFA-në, duke treguar nivel të lartë të përgatitjes fizike, disiplinës dhe paraqitjes.



## Studentët e AFA-së, vizitë në Akademinë Ushtarake ‘West Point’

Në kuadër të programit të shkëmbimit të studentëve ndërmjet Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Akademisë ushtarake ‘West Point’, studentët e vitit II Bachelor, Gentila Boçari dhe Rigers Veizi, në programin Shkenca Ushtarake, zhvilluan një vizitë në Akademinë Ushtarake ‘West Point’, SHBA.

Ky është një program që përfshin një numër të madh shtetesh për SHBA-të ndërsa për Akademinë e Forcave të Armatosura ky program aplikohet me Akademinë e ‘West Point-it’, Akademinë Ushtarake në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut.

Qëllimi i vizitës ishte për të parë nga afër mënyrën e organizimit dhe funksionimit të jetës studentore gjatë procesit akademik dhe pas përfundimit të tij. Gjatë vizitës së tyre, studentët shqiptarë u pritën nga dy studentë të vitit të katërt të kësaj akademie, të cilët në muajin shkurt kaluan 10 ditë në Akademinë e Forcave të Armatosura. Ditët e vizitës u shoqëruan me pjesëmarrje në procesin akademik si dhe vizita në vende të njohura dhe historike në afërsi të Akademisë. Studentët e vlerësuan pozitivisht vizitën si



një përvojë të pa harrueshme dhe sollën nga andej rekomandime të vlefshme, të cilat do të merren në konsideratë nga ana e drejtuesve të AFA-së për të arritur qëllimin tonë për ta përfunduar akademinë tonë sa më shumë me atë të ‘West Point-it’.



## Gjeneral brigade Bilbil Bitri priti atashen ushtarak të SHBA-së, kapiten i rangut I David Millner

**K**omandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), gjeneral brigade Bilbil Bitri zhvilloi një takim me atashen ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kapiten i rangut I David Millner, në kuadër të bashkëpunimit ushtarak dypalësh dhe përfundimit të mandatit të atashut ushtarak rezident në Tiranë.

Gjeneral Bitri vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm midis dy palëve për transformimin e AFA-së sipas modelit të Akademisë Ushtarake Amerikane “West Point”, ndërsa atashu ushtarak amerikan falënderoi gjeneral Bitrin për lidhshimin e treguar në këtë proces dhe arritjet që AFA ka bërë në këtë drejtim. Gjatë takimit u prezantua edhe atashu i ri ushtarak i SHBA-së, kapiten i rangut I Eric Cotè.

Gjeneral Bitri i uroi mirëseardhjen atashut të ri të SHBA-së dhe e siguroi atë për mbështetjen dhe vijimin e projekteve të bashkëpunimit ushtarak midis



Akademive të të dy vendeve, duke filluar me angazhimin konkret për hapjen e brezit të parë sipas modelit “West Point” në tetor të këtij viti.

# Kursi i Përgatitjes së Oficerit zhvillon stërvitjen verore “Enkelejte-23”



Në Bazën Detare të Pashalimanit u organizua stërvitja verore “Enkelejte-23”. Kursi i Përgatitjes së Oficerit përgatit specialistë të fushave të ndryshme për specialitete të veçantë dhe kursantët që ndjekin këtë kurs kanë përfunduar shkolla në degë të ndryshme, në institucione të arsimit të Lartë në vend dhe jo vetëm.

Qëllimi i stërvitjes verore ishte organizimi dhe zhvillimi i jetës dhe veprimtarisë në kushte fushore, në temperatura të larta dhe sa më të përafërta me ato të kryerjes së një detyre luftarake apo misioni. Për zhvillimin e stërvitjes verore u parashikuan tema të ndryshme



taktike, të cilat detyruan kursantet të planëzojnë, përgatiten dhe ekzekutojnë, duke menduar në mënyre kritike, në varësi të situatave të krijuara nga pedagogët.

## QAPU zhvilloi ceremoninë e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve

Në mjediset e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë, dhe batalionin e Parë dhe të Tretë të këmbësorisë, u zhvillua ceremonia e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve, të cilët përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në përfundim të këtij kursi u certifikuan 74 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura.





# Përfundoi faza e parë e kursit për ekspertët shqiptarë të Mbrojtjes Civile

Në kuadër të projektit “Krijimi i Qendrës Operative Kombëtare për Emergjencat Civile të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Shqiptare”, financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, për një shumë prej 1.2 milionë eurosh, u zhvillua kursi për Operatorët Shqiptarë të Mbrojtjes Civile, në bashkëpunim dhe koordinim me Departamentin e Mbrojtjes Civile të Kryesisë së Këshillit të Ministrave të Italisë dhe me Mbrojtjen Civile të Toskanës/ytetit metropolitan të Firences.

Trajnimit të realizuar përmes pesë moduleve teorike, në të cilat morën pjesë 24 operatorë të Sallës Operative të Emergjencave Civile dhe stafi i Bashkisë së Tiranës, iu shtua dhe një ushtrim praktik që synonte përsosjen e reagimit të Mbrojtjes Civile

Shqiptare pas ngjarjeve katastrofike, për menaxhimin e llojeve të ndryshme të emergjencave (përmytje, zjarre, tërmete, etj.). Pjesa e dytë e kursit do të zhvillohet në Itali, pranë Departamentit të Mbrojtjes Civile të Kryesisë Italiane të Këshillit të Ministrave dhe Mbrojtjes Civile të Toskanës/ytetit metropolitan të Firences.

Nisur nga shtimi i ngjarjeve katastrofike të viteve të fundit, programi përputhet plotësisht me një prioritet gjithnjë në rritje të qeverisë shqiptare, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor: emergjencat civile.

Kurset synojnë të përfshijnë, në mënyrë të strukturuar, të qëndrueshme dhe proaktive, njohuritë italiane të Mbrojtjes Civile, si një model ekselence i njohur ndërkombëtarisht.

# Forca Ajrore së shpejti do të këtë në përdorim mjete ajrore pa pilot

**N**ë komandën e Forcës Ajrore u realizua “Site Survey”, si pjesë e kontratës që qeveria shqiptare ka me kompaninë turke për furnizimin me sisteme mjete ajrore pa pilot “Bayraktar - TB2”.

Qëllimi i vizitës ishte studimi dhe vlerësimi i terrenit/infrastrukturës për instalimin e sistemeve për përdorimin e dronëve (UAV TB2). Ekipi përfaqësues i kompanisë turke u prit nga komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili shprehu mbështetjen maksimale për fillimin sa më parë të këtij projekti.

Takimet u zhvilluan në harkun kohor një-javor, pjesë e takimeve ishin përfaqësues të Shtabit të Forcës Ajrore, Drejtorisë së Modernizimit, Drejtorisë së Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm dhe Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.

Pajisja me këto mjete ajrore pa pilot që do të administrohen dhe përdoren nga Forca Ajrore, mund të gjejnë përdorim edhe në fushat e tjera të veprimit.



## Baza Ajrore Farkë zhvillon stërvitjen “Astral Knight”

**N**ë kuadër të stërvitjes “Defender 23”, Forca Ajrore mirëpriti efektivin dhe helikopterët e USAF si pjesëmarrës në stërvitjen “Astral Knight”. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte rritja e aftësive operacionale të Forcave Ajrore Shqiptare për të bashkëvepruar me forcat ajrore të vendeve aleate dhe jo vetëm për kryerjen e operacioneve ajrore komplekse si: monitorim/kontroll të hapësirës ajrore, planëzim dhe zhvillim të mbrojtjes ajrore në mënyrë aktive si dhe kryerja e operacioneve të evakuimit të personelit ushtarak, i cili ndodhet në zonat ku zhvilloheshin luftimet (Combat Search and Rescue), veçanërisht ekuipazheve fluturuese të dëmtuara/rrëzuara në zonën e luftimit. Ekuipazhet fluturuese të të dyja vendeve (USAF të dislokuar në Bazën Ajrore Farkë dhe Skuadronin Operacional të Helikopterëve “AS532AL Cougar” të BAF), zhvilluan fluturime kompaktësuese me fokus, rikonicionin e zonave ku u zhvi-



llua stërvitja. Zhvillimi i kësaj stërvitjeje kishte një rëndësi të veçantë për Forcat Ajrore shqiptare pasi u zhvillua ditën dhe natën, si në tokë ashtu edhe në det, e

cila tregoi edhe një herë objektivin tonë për përmbytjen sa më mirë të angazhimeve që Forcat e Armatosura Shqiptare kanë në kuadër të mbrojtjes kolektive.





## Forca Ajrore vijon modernizimin e flotës ajrore

Forca Ajrore, në bashkëpunim me “US Army Security Assistance Command” (USA SAC) dhe me Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak të SHBA-së (ODC), zhvilloi aktivitetin “Rishikimi i Menaxhimit të programit #2” (Program Management Review #2), në lidhje me vlerësimin dhe rishikimin e programit për modernizimin e flotës ajrore me helikopterë tip UH - 60A. Në takimin midis palëve u diskutua për projektin e helikopterëve UH-60 “Black Hawk”, ku Komandanti Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj mbajti fjalën e hapjes, ku adresoi çështjet që do të diskutoheshin me ekipin amerikan që menaxhon këtë projekt. Në këtë takim u diskutuan progresi i bërë deri më tani si dhe modalitetet e fundit para mbërritjes së mjeteve ajrore, në mënyrë që Forca Ajrore të vendosë helikopterët tip UH - 60 “Black Hawk” në operacionalitet dhe në gatishmëri të plotë luftarake.

Gjatë këtij aktiviteti u arrit koordinimi dhe adresimi i çështjeve për pritjen e helikopterëve UH - 60 nga pala shqiptare, mbështetjen logjistike, pjesët e këmbimit për mirëmbajtjen e këtyre mjeteve sipas konceptit “Paketë Mbështetëse Totale” (Total Support Approach Package), si dhe, trajnimin operacional për efektivin pilot dhe teknik të Forcës Ajrore.

## Forca Ajrore trajnon pilotët e Njësisë së Aviacionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në Bazës Ajrore Farkë, dy pilotë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, zhvilluan një program teorik dhe praktikë fluturuese me helikopterin AB-206. Qëllimi i aktivitetit ishte aftësimi teorik dhe zhvillimi i fluturimeve me helikopter AB-206, për ruajtjen e aftësive fluturuese të pilotëve të Njësisë së Aviacionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe rritjen e operacionalitetit të tyre.



## Helikopteri ‘Cougar’ vazhdon misionin...

Ekuipazhi i helikopterit ‘Cougar’ ka bërë të mundur shpëtimin e tre alpinistëve çek që kishin mbetur të bllokuar në Malin e Jezercës. Mbas marrjes së njoftimit, strukturat e bazës ajrore Farkë vendosën në dispozicion helikopterin për kërkimin dhe gjetjen e vendndodhjes së turistëve që kishin kërkuar ndihmë. Koha e reagimit ka qenë tepër e shpejtë, që nga marrja e sinjalit dhe deri në lokalizimin dhe transportimin e turistëve të bllokuar në lartësitë e Jezercës. Gjendja shëndetësore e tyre ishte shumë e mirë.

Forca Ajrore, me kapacitetet që disponon, ngelet e gatshme për t’iu përgjigjur në çdo kohë dhe në çdo vend kërkesave në mbështetje të autoriteteve civile.





## Shërbimi Hidrografik realizoi me sukses vendosjen e bovave në liqenin e Prespës

Shërbimi Hidrografik, pjesë e Forcës Detare realizoi me sukses operacionin për vendosjen e katër bovave në liqenin e Prespës së Madhe. Gjatë këtij operacioni të rëndësishëm janë marrë të gjitha masat e duhura për drejtimin dhe koordinimin e vendosjes së bovave lundruese në liqenin e Prespës.

Ky aktivitet kishte si qëllim parësor kontrollin e thellësive përgjatë vijave të kufirit në të dy liqenet, për të përcaktuar më pas vendosjen e bovave sinjalizuese, ndriçuese apo shenja, për dallimin e vijave kufitare me Greqinë.

Operacioni rezultoi të ishte i vështirë dhe delikat, por, po aq edhe i suksesshëm. Kjo falë profesionalizmit të treguar nga bashkëpunimi dhe me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe Migracionit, palën greke, Forcën Ajrore, Regjimentin e Helikopterëve, Farkë, IGJIU, Qendrën e Zhytjes së FD-së, dhe Prefekturën e Qarkut Korçë.

Operacioni u ndoq dhe nga përfaqësues të qeverisë vendore të qarkut Korçë, prefekti i qarkut Korçë, Nertil Jole, drejtori i Përgjithshëm i Policisë Kufitare dhe Migracionit në Policinë e Shtetit z. Artion Duka, kryekomisar Selman Lleshi dhe përfaqësuesit të qeverisë greke, përshëndetën operacionin e kryer dhe falënderuan punën e bërë nga Shërbimi Hidrografik i Forcës Detare.

## Operacion SAR nga efektivitë i anijes P-134 “Butrinti”, pjesë e misionit SNMG2 TU 01

Anija P-134 “Butrinti”, pjesë e misionit SNMG2 TU 01, ka qenë pjesë e një operacionin SAR në bashkëpunim me anijen e Rojës Bregdetare greke dhe Rojës Bregdetare turke, pasi një gomone me emigrantë ndodhej në vështirësi.

Si rezultat i veprimit të menjëhershëm dhe profesional të anijeve pjesëmarrëse në operacion, u bë i mundur shpëtimi i 55 emigrantëve, me origjinë kryesisht nga Jemeni dhe Eritrea, të cilët u imbarkuan në anijen e Rojës Bregdetare turke.

Anija P-134 “Butrinti”, me komandant kapiten i rangut III Altin Liçaj, vijon misionin në ujërat e detit Egje.



## Operacion SAR nga efektivitë i anijes P-04 “Semani”

Anijes së Rojës Bregdetare P-04 “Semani” iu dha situatë për një mjet që kishte pësuar avari. Pas marrjes së informacionit nga Qendra e Kërkim - Shpëtim-it, anija e Rojës Bregdetare “Semani” P-04 i dha ndihmë një mjeti tip skaf me emër “Almena”, e cila kishte pësuar defekt dhe ndodhej pranë kepit të Rodonit. Falë ndërhyrjes në kohë të efektivit të anijes P-04, mjeti arriti të shpëtohet dhe të rimorkiohet nga anija e Rojës Bregdetare. Skafi, me flamur shqiptar



me 12 persona, (8 fëmijë dhe 4 të rritur) në bord u shoqërua për në Portin e Durrësit. Operacioni SAR u krye me sukses dhe personat e shpëtuar ndodhen në gjendje të mirë shëndetësore. Numri Blu i emergjencës i QNOD-së në shërbim 24 orë është Nr. #125. Shpejtësia e dhënies së informacionit në kërkim të ndihmës ka rol të rëndësishëm në parandalimin e fatkeqësive. Forca Detare dhe Roja Bregdetare janë gjithnjë në gatishmëri për të siguruar sigurinë lundrimore dhe zbatimin e ligjshmërisë detare.

# Anija P - 132 "Oriku" merr pjesë në stërvitjen ndërkombëtare "ADRION CAX - LIVEX 2023"

Në Bazën Detare Pashaliman u realizua ceremonia e përcjelljes së anijes P - 132 "Oriku", e cila do të marrë pjesë në stërvitjen ndërkombëtare "ADRION CAX - LIVEX 2023", (Live Exercise - Computer Assisted Exercise), me destinacion në Itali.

Në ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, i cili mbasi u njoh nga komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj, me përgatitjen e efektivave dhe marrjen e masave për pjesëmarrjen e anijes në këtë stërvitje, falënderoi efektivat dhe i uroi suksese në realizimin e detyrës.

Stërvitja "ADRION CAX - LIVEX 2023" është një stërvitje që zhvillohet në kuadër të nismës ADRION (Adriatic Ionian Initiative), me pjesëmarrjen e forcave detare të vendeve anëtare të cilat janë: Shqipëria, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi dhe Sllovenia.

Qëllimi i stërvitjes është përmirësimi i ndërveprimit të marinave ADRION, në kryerjen e operacioneve detare si: operacionet e ndalimit detar, kërkim - shpëtim, manovrimi detar, komunikimi si dhe trajnimin e procedurave në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve shumëkombëshe për të forcuar sigurinë e përgjithshme në det.

Një pikë tjetër e rëndësishme e stërvitjes është trajnimi i ekuipazheve në përdorimin e procedurave standarde të funksionimit sipas manualeve të NATO-s.



## Në Qendrën Stërvitore Pashaliman përfundoi Kursi i Avancuar i Nënoficerit

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Avancuar të Nënoficerit. Gjatë kësaj periudhe kursantët kanë ndjekur programin teorik dhe praktikë mësimore. Nga kursantët është treguar disiplinë e lartë dhe korrektësi në zbatimin e rregulloreve bazë të Forcave të Armatosura. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin e kursit.



Në kuadër të Iniciativës Rajonale “ADRION”, në Taranto të Italisë, u zhvillua Stërvičia Rajonale “ADRION LIVEX/CAX - 2023”, me pjesëmarrjen e anijeve dhe efektivëve të Forcave Detare të Shqipërisë, Italisë, Greqisë, Kroacisë dhe Malit të Zi.

Qëllimi i stërviçjes ishte përmirësimi i ndërveprimit të Forcave Detare të vendeve pjesëmarrëse në Iniciativën Rajonale “ADRION”, në kryerjen e operacioneve të ndryshme detare si operacionet e ndalimit detar, kërkim - shpëtim, manovrimi detar, komunikimi si dhe trajnimin e procedurave në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve shumëkombëshe për të forcuar sigurinë e përgjithshme në det.

Një pikë tjetër e rëndësishme e stërviçjes ishte trajnimi i ekuipazheve në përdorimin e procedurave standarde të funksionimit sipas manualeve të NATO-s.

Gjatë zhvillimit të stërviçjes u zhvilluan skenarët stërviçorë “Kërkim - Shpëtim”, “Operacionet e Ndalimit Detar”, “Operacione të ndryshme detare” si dhe stërvičia përfundoi me qitje reale detare me artileritë e anijeve.

Gjatë stërviçjes një ekip i Brigadës “San Marco” u ul nga helikopteri në anijen “Oriku” për bordimin e saj, ndërkohë që anija vijonte lundrimin duke simuluar një situatë reale.

Stërvičia theksoi edhe njëherë rëndësinë mbi bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërmjet forcave detare të vendeve të rajonit që lagen nga deti Adriatik dhe Jon. Gjithashtu u nënvizua rëndësia e vijimit të iniciativës ADRION, për rritjen e sigurimit detar të rajonit, për forcimin dhe bashkëpunimin në kuadër të kryerjes së operacioneve të kërkim - shpëtimin në det. Në ditën e vizitorëve të shquar mori pjesë komandanti i Flotiljes Detare, Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj, i cili së bashku me të ftuarit e tjerë dhe komandantët e anijeve pjesëmarrëse në stërviçje u pritën nga komandanti i Divizionit të Dytë Detar, Taranto, kundëradmiral Giacinto Sciandra.

# Përfundon me sukses Stërvičia e Iniciativës Rajonale “ADRION”



## Zhvillohet stërvičia “GRUPEX-23”

Flotilja Detare, Pashaliman, zhvilloi në rajonin e Gjirit të Vlorës stërviçjen “GRUPEX-23” dhe qitjet bregdetare, me armatimin e grupit I dhe të II të anijeve patrulluese.

Kjo stërviçje kishte si qëllim vlerësimin dhe certifikimin e grupeve të anijeve patrulluese si njësi zbatuese, testimin e aftësive organizative dhe komanduese të komandantëve të grupeve, planëzimin e Shtabit të Flotiljes Detare, si dhe kryerjen e qitjeve bregdetare me armatimin e anijeve.

Në këtë stërviçje u përpunuan 10 skenarë stërviçor, ndër më kryesorët ishin: operacionet e Ndalimit Detar (MIO), operacionet e kërkim - shpëtim (SAR), mbrojtja e forcës në det (FIAC), lundrimi i përbashkët i njësive detare, operacionet e evakuimit jo - luftarak (NEO), si dhe realizimi i qitjeve bregdetare me armatimin e anijeve.

Qitjet u zhvilluan në distancë të ndryshme, sipas kalibrave që posedonte çdo anije.

Stërvičia u drejtua nga komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj, si dhe u vëzhgua nga afër nga Shtabi i Forcës Detare.



# Përfundon me sukses misioni i kontingjentit të parë në Novo Selo, Bullgari

Kontingjenti i parë, i përbërë nga 30 (tridhjetë) ushtarakë efektivë të Repartit Ushtarak nr. 1010 (batalioni i parë i këmbësisorë Vau i Dejës, Shkodër), ka përfunduar me sukses misionin si pjesë përbërëse e k2k e Grup Batalionit të NATO-s, në Operacionin e Prezencës dhe Vigjilencës së përforcuar (eAV), Novo Selo, Bullgari.

Efektivët e kontingjentit nën drejtimin e komandantit të misionit, kapiten Besnik Cenaj realizuan trajnimin sipas programeve të detajuara në përbërje të k2k e Grup Batalionit të NATO-s, në Operacionin e Prezencës dhe Vigjilencës së përforcuar (eAV), Novo Selo, Bullgari.

Dorëzimi i detyrës iu bë kontingjentit të dytë, i cili është i përbërë nga efektivë të batalionit të tretë të këmbësisorë Poshnjë, Berat.



# Forca Tokësore, pjesëmarrëse e "Arcade Ledger" në Paderborn, Gjermani

**E**fektivë të Batalionit të Dytë të Këmbësisorë përfunduan me sukses stërvitjen e koduar "Arcade Ledger", e cila u zhvillua në Paderborn, Gjermani.

Kjo stërvitje u zhvillua në kuadër të VJTF - 24. Në këtë stërvitje trupat shqiptare u trajnuan së bashku me trupat e vendeve të NATO-s dhe atyre partnere: Angli, Turqi, Poloni, Francë, Gjermani, Hungari, Australi, Kanada, Itali, Letoni, Gjermani, Spanjë, si një njësi e përbashkët nën komandën angleze.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte rritja e kapaciteteve operacionale të reparteve dhe nënreparteve VJTF (L). Kjo stërvitje



konsistoi në rritjen e aftësive luftarake të vendeve anëtare të NATO-s. Pjesëmarrja e trupave të Forcës Tokësore në stërvitjen "Arcade Ledger" vjen në vijim të disa stërvitjeve ndërkombëtare, që po zhvillohen



këtë vit nga Forca Tokësore, në kuadër të plan-kalendarit të stërvitjeve vjetore. Synimi i tyre është rritja e aftësive operacionale dhe ndërvepruese e këtyre forcave në një mjedis operacional ndërkombëtar.

# Përfundon me sukses stërvitja kompaktësuese “HAJMELI - 23”

Në rajonin stërvitor të Vaut të Dejës, Shkodër, ka përfunduar me sukses stërvitja kompaktësuese e koduar “HAJMELI - 23”.

Kjo stërvitje e rëndësishme pati si qëllim përmirësimin e aftësive taktike në operacionet mbrojtëse, ku përgjatë 72 orëve, efektivët e Batalionit I të Këmbësorisë kombinuan taktikat e luftimit mbrojtës, me ato të dhënies së ndihmës së parë dhe tërheqjes së të dëmtuarve nga fusha e luftimit.

Kjo stërvitje, ashtu si të tjera të kryera së fundmi, tregoi edhe njëherë se strukturat e FARSH-së kanë kapacitetet e duhura operationale për të ndërvepruar në çdo lloj skenari dhe angazhimi të mundshëm.



Efektivët e Batalionit KOMANDO zhvilluan kursin IV të “Luftimit në Qendrat e Banuara”.

Ky kurs ka si qëllim rritjen e aftësive operationale të efektivëve të rinj të këtij batalioni, si dhe kompaktësimin e veprimeve luftarake të tyre.

Kursi u zhvillua nën mbikëqyrjen e instruktorëve turq, të cilët janë të atashuar pranë batalionit Komando në rolin e këshilluesve ushtarakë.



Kompania e MADM-së përfundoi stërvitjen e përbashkët me Gardën Kombëtare të New Jersey-t dhe një togë MADM e Forcave të Sigurisë së Kosovës. Gjatë këtij trajnimi, efektivët e të tre shteteve praktikuan teknikat e ndryshme të zbulimit kimik, radiacionit dhe u njohën me mjetin special për marrjen e mostrave biologjike.

Trupat në trajnim u vizituan dhe nga Komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou.



# Forca Tokësore zhvilloi stërvitjen “Përkujdesja ndaj Viktimave të Luftës Taktike”

Ekipi këshillues i manovrës nga batalioni I i Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë (SFAB) së SHBA-së, i vendosur pranë batalionit të dytë të këmbësorisë në Forcën Tokësore, zhvilloi stërvitjen mbi “Përkujdesjen ndaj Viktimave të Luftës Taktike” me efektivë të kësaj njësie. Njëherazi, këshilltarë të batalionit të 6-të të SFAB iu bashkuan stafit të Brigadës Shumëkombëshe të Task Forcës së Jugut (e dislokuar në Zall Herr), në kuadër të përgatitjeve mbi stërvitjen ndërkombëtare “Immediate Response”, pjesë e paketës së “Defender Europe-23”, udhëhequr nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën, që u zhvillohet në periudhën maj - qershor 2023.



Përfundoi me sukses stërvitja “KFOR-23”  
në Hohenfels, Gjermani.



## Xhenierët e Batalionit të Xhenios, në ndihmë të komunitetit



Xhenierët e Batalionit të Xhenios mundësuan lidhjen me rrugë automobilistike të një lagjeje në fshatin Mamël, Bashkia Elbasan. Prej shumë vitesh banorët e lagjes Çarje të fshatit Mamël në bashkinë Elbasan, nuk kishin mundësi komunikimi me mjetet e tyre me pjesën tjetër të fshatit duke iu sjellë vështirësi në transportin e mallrave dhe njerëzve. Kërkesës së banorëve për një rrugë iu përgjigjën specialistët xhenierë, të cilët nga data 12 deri 19 qershor 2023 punuan për hapjen e rrugës së re dhe lidhjen e lagjes me pjesën tjetër të fshatit. 11 specialistë xhenierë me 2 mjete dhe 1 agregat bënë të mundur



hapjen e rrugës automobilistike, duke kryer prishje masivi shkëmbor me eksploziv rreth 595 m<sup>3</sup>, prishje mekanike me matrapik 8m<sup>3</sup> dhe duke hapur një rrugë prej 107 m. Kjo rrugë bën të mundur lidhjen e lagjes me fshatin si dhe krijon mundësi që mjetet e transportit të futen në lagje.

## Trupat xheniere të batalionit Xhenios, në shërbim të komunitetit për ndërtimin e urave në bashkitë Tropojë dhe Librazhd

Gjatë muajit maj 2023, në bashkitë e Tropojës dhe Librazhdit, forcat xheniere kanë ndërtuar tre ura tip "Bailey". Ndërtimi i tyre mundëson lidhjen e më shumë se 2 300 banorëve të këtyre zonave midis tyre. Me rreth 13 forca dhe 5 mjete ato kanë bërë të mundur ndërtimin e dy urave në bashkinë e Tropojës në fshatin Kuçanë dhe në grykën e Sylbicës mbi lumin e Tropojës.

Dy urat, secila me një gjatësi 15 metra dhe me seksion 2/1 të ndërtuara në fshatin Kuçanë dhe grykën e Sylbicës, do të shërbejnë për të lidhur rreth 1000 banorët e krahinës së Shipshanit, duke bërë të mundur lëvizjen e mjeteve dhe banorëve për në bjeshtë.



Ura e ndërtuar në fshatin Zall i Madh në Orenjë, ka një gjatësi prej 18 metrash me seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton. Për ndërtimin e kësaj ure punuan 10 forca dhe 4 mjete.

Kjo urë do të shërbejë për të lidhur fshatrat e Gurakuqit, Floqit, Rinasit, Orenjës dhe Zallit të Madh, duke bërë të mundur që rreth 1300 banorë të lëvizin lirshëm me mjetet e tyre në çdo kohë pa u kushtëzuar nga shirat e moti i keq.



## Toga e Tretë e Kompanisë së Parë Operacionale në Policinë Ushtarake përfundon stërvitjen ndërkombëtare “Saber Guardian - 23”, në Rumani

Toga e Policisë Ushtarake ishte e integruar në Kompaninë Shumëkombëshe “508-th MP COY”, e dislokuar në Slobozia, Rumani. Disa nga detyrat e efektivit të Policisë Ushtarake ishin ndërveprimi me trupat e tjerë ndërkombëtarë gjatë operacionit; parandalimi i akteve sabotuese, apo atyre kriminale në prapavijë; ngritja e pikave të kontrollit në interes të operacioneve të lëvizshmërisë; shoqërimi i MPW/C (të burgosurve të luftës dhe civilëve) si dhe lëvizja në zonën e operacionit nëpërmjet komunikimit të sigurt, duke treguar një nivel të lartë të përgatitjes përkrah ushtarakëve të NATO-s si pjesë të stërvitjes “Defender Europe - 23”.



## Specialistët EOD, pjesë e stërvitjes shumëkombëshe “Combined Resolve XVIII”, në Hohenfels, Gjermani

Nga data 24 prill - 16 maj 2023, një skuadër EOD e Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse merr pjesë në stërvitjen shumëkombëshe të koduar “Combined Resolve XVIII”, që po zhvillohet në bazën ushtarake të NATO-s në Hohenfels, Gjermani. Në këtë stërvitje skuadra EOD ka demonstruar aftësitë e përgatitjes së saj në disa skenarë të veprimit EOD si kontrolli i një pakoje të dyshuar IED dhe çaktivizimin e saj, duke përdorur aparat X-ray, robot etj.



Seksioni i Stërvitjes në Policinë Ushtarake mbylli me sukses Kursin e Avancuar të Nënoficerit, në specialitetin Polici Ushtarake, me një kohëzgjatje prej 8 javësh. Kursi kishte si mision marrjen e njohurive themelore mbi parimet dhe veprimtarinë për të zbatuar të gjitha detyrat në operacione që kryen Policia Ushtarake si nga ana individuale, por edhe në përbërje të skuadrës dhe togës.

# Robotët “vrasës”, teknologjia “smart” dhe e drejta ndërkombëtare



KOLONEL HYSNI GJERGJI




**Në kapitalizëm gjithçka paguhet dhe nëse ne nuk paguajmë për produktin, atëherë është e qartë se ne jemi vetë produkti. Kjo është industria e blerjes “falas” së vëmendjes. Kjo industri e re ka nevojë për njerëz të shpërqendruar, dhe të hapur ndaj reklamave që në median sociale janë shndërruar në epidemi.**

Titulli i filmit me metrazh të shkurtër “Slaughterbots” është klikuar më shumë se dy milionë e gjysmë herë nga publikimi i tij në nëntor 2017. Gjithçka duket vetëm ‘science fiction’, halucinacione të njerëzve të frikësuar. “Në asnjë rast, - mendon Thomas Küchenmeister, që angazhohet

për ndalimin e sistemeve të armëve autonome, - hapi deri aty është shumë i vogël”. Küchenmeister është kryetar i “Facing Finance”, një organizate gjermane, pjesëtare e fushatës ndërkombëtare “Stop Killer Robots”. Ai viziton panairë të armëve dhe bisedon me prodhuesit e tyre. Armë me një autonomi të caktuar ka edhe sot, për shembull raketat që kërkojnë në mënyrë të pavarur objektivat e mundshme dhe vendosin vetë, se cilin mund të shkatërrojnë. Kryesisht ato komandohen nga njerëzit, por për sulmin konkret nuk ka ushtarë që jep urdhrin, shpesh ai as nuk mund ta ndalë raketën.

Autonomia e armëve vrasëse mbart implikime dhe ndikime delikate në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Në qendër të debatit me “të mirat” dhe “të këqijat” e LAWS (Lethal Autonomous Weapons Systems), janë pasojat të cilat lidhen kryesisht me vendimmarrjen, nëse dhënia e të drejtës për të eliminuar automatikisht një objektiv, e përçmon jetën e njeriut. Një hap cilësor por i debatueshëm dhe delikat, në fushën e teknologjisë ushtarake, është sistemi luftarak vetë-veprues i asgjësimit të kundërshtarit me zjarr. Këto janë sistemet (LAWS), të njohura si “robotët vrasës”, si kategori e veçantë e sistemeve të armëve që përdorin grupe sensorësh dhe algoritme kompjuterike për të identifikuar, ndjekur dhe asgjësuar një objektiv, pa kontroll njerëzor të sistemit. Në varësi të ndërtimit të sistemit, LAWS mund të arrijë të zëvendësojë në mënyrë praktike luftëtarët, duke eliminuar nevojën



# SHOULD MACHINES MAKE LIFE-OR-DEATH DECISIONS?

War and law

për dislokime njerëzore në zona me rrezik dhe kushte të vështira për jetën e njeriut. “Bekimi” i LAWS qëndron gjithashtu edhe në faktin se ai ul ndjeshëm rrezikun për jetët e ushtarëve tanë, pa e ulur aftësitë luftarake, si dhe e shmang debatin politik për strategjitë afatgjata, pasi liderët heqin dorë nga lufta vetëm për shkak të viktimitave njerëzore. Ndryshe nga disa shtete të tjera të NATO-s, përkufizimi i SHBA-së për armët autonome specifikon përfshirjen e LAWS, por të mbikëqyrur nga njeriu.

Shtetet e Bashkuara kanë përdorur prej kohësh sisteme pa pilot për të shënjestruar anëtarët e organizatave ndërkombëtare terroriste, ku një operator njerëzor ka dhënë gjithmonë urdhrin për të vrarë. Ky është një sistem i krijuar për t'u siguruar njerëzve mundësinë që të ndërpresin funksionimin e armëve, gjatë dhe pas aktivizimit, nëse vlerësohet gabim kjo shënjestër. Përfitimet dhe rreziqet e mundshme të përdorimit të LAWS, duhet të analizohen me kujdes, duke vlerësuar efektet dhe defektet që rrjedhin nga ky evolucion. Pa një kornizë ligjore mbikëqyrëse për armët autonome, rrezikohet një përgjigje e vonuar dhe e ngjashme me atë që ndodhi pas përdorimit të bombës së parë atomike. Përfitimet gjatë automatizimit të armëve

vdekjeprurëse në fushën e luftimit, janë edhe më të mëdha. Për shkak të mungesës së emocioneve njerëzore negative që lidhen me ankthin, frikën, lodhjen, përfitimin personal, kushtet shëndetësore etj., IA-ja (Inteligjenca Artificiale) mund të bëjë zgjedhje objektive në kohë krize, të cilat do të shpëtojnë jetë njerëzish. Kompjuterët e LAWS nuk i nënshtrohen të njëjtave kufizime si njerëzit, që është aftësia për të operuar në mjedise luftarake për periudha të gjata kohore, pa nevojën për furnizim, ushqim, logjistikë etj., deri në përfundimin e operacionit, zbatimimi i LAWS paraqet disa “sfida” mbrojtjeje dhe sigurie të vetë sistemit, të tilla si hakërimi i sistemit, nëse ky sistem përdor aplikacione të IA-së. Një nga sfidat e sistemeve LAWS është fakti se gabimet njerëzore zakonisht i adresohen një individ të vetëm, ndërsa gabimet në sistemet komplekse të IA-së, rrezikojnë dështim të përgjithshëm të sistemit teknologjik ‘smart’.

Reagimet ndërkombëtare ndaj LAWS sot janë kontradiktore, por e marrin parasysh “bekimin” dhe “mallkimin”, që vjen nga kjo armë, e cila akoma është në hapat e para dhe e pa zhvilluar plotësisht. Disa shtete përdorin armë gjysmë autonome, ku njeriu ka të drejtë të ndërhyjë dhe ndërpresë ekzekutimin e sulmit. Makinat nuk e kuptojnë se çfarë do të

thotë të vrasësh një qenie njerëzore. Një nga avantazhet më të mëdha të LAWS, domethënë mungesa e emocioneve të tyre, është gjithashtu një e metë qendrore. Paaftësia e një roboti për të reflektuar mbi veprimet e tij, ose për të kuptuar vlerën e jetës së një individi, në thelb i kthen njerëzit e synuar në objekte. Nëse një kompjuter kryen një veprim të paligjshëm në luftim do të ishte e pamundur të ndëshkohej. Presioni nga OJQ-të do të përballte LAWS, pasi Konventa për Armët Konvencionale, ende nuk ka publikuar rekomandim specifik të politikave për shtetet anëtare në lidhje me kufizimin e tyre. Pavarësisht nëse arrihet një marrëveshje ndërkombëtare që kufizon LAWS, është thelbësor një plan emergjence kundër një teknologjie të tillë të përdorur nga kundërshtarët e NATO-s.

Shumë përdorues të teknologjisë 'smart' edhe në forcat e armatosura, posedojnë celularë të gjeneratave të fundit vetëm për komunikim dhe argëtim pa ditur shumë funksione të tjera të tij. Shumë kush nuk di që në celularin e tij mbart një telekomandë që aktivizon një pajisje tjetër, një regjistruer të sofistikuar, transmetues të dhënash, madje edhe një armë apo "person tjetër" që ka hyrë në jetën e tij, jeton në të njëjtën shtëpi me të, madje fle në të njëjtën dhomë me të. Duhet të dimë se çdo e dhënë e jona personale që kemi sot në 'Facebook' apo androidin tonë, janë të cenueshme dhe hakerat privatë dhe shtetërorë, do të përpiqen t'i vjedhin dhe përdorin për qëllime dashakeqëse. Shtetet autoritare dhe totalitare, të pasigurt mbi fuqinë e tyre të vërtetë, kanë luftuar gjithmonë intimitetin, me rrjetet e policisë sekrete, siç bëjnë vendet demokratike në luftë apo në kohëra trazirash. Po kalohet në një epokë të mbikëqyrjes së vazhdueshme, por tashmë jo nga policia sekrete, por nga reklamuesit dhe ndërmarrjet tregtare.

Duke poseduar një smartphone, ne rrezikohemi nga një "armë" madje po humbasim edhe disa "gjendje" për të cilat njeriu është investuar në shekuj, si privatësia. Kjo gjendje e të qëndruarit vetëm, pa u ndikuar, shikuar, vëzhguar, shqetësuar, bezdisur apo dëgjuar nga të tjerët, pa dijeninë dhe miratimin e tij. Kompanitë më të pasura në botë, gjenerojnë pasuri duke vendosur sa më shumë gjurmues, dhe kamera brenda ambienteve të jetesës, dhe sa më afër vendbanimeve tona. 'Huawei' kinez është gjigandi kinez i celularëve, që përdor përparësinë teknologjike për spiunazh politik, ushtarak apo tregtar në të gjithë hapësirën ku ai është i shitur. Ky aplikacion është kthyer në armë të shtetit kinez, pasi sistemi autoritar atje kontrollon çdo gjë, monitoron çdo sipërmarrje private dhe si përfundim e përdor atë. Një aparat celulari 'Huawei' vlerësohet të jetë një "marrës" të dhënash dhe transferimi i tyre tek porositesit, bëhet pa dijeninë apo pa asnjë informacion paralajmëruar për klientin nga kjo kompani. Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera perëndimore kanë shprehur shqetësim se Qeveria e Kinës, mund ta përdorë teknologjinë e 'Huawei-t' për të rritur kapacitetet e saj të spiunazhit, sepse sipas legjislationit kinez, çdo kompani ka kontroll, detyrim dhe mbikëqyrje shtetërore.

Në nëntor 2022, 'TikTok', pranoi se punonjësit e kompanisë në Kinë, mund të kenë akses në të dhënat e përdoruesve europianë.

SHBA-të e kanë ndaluar gjithashtu edhe aplikacionin 'TikTok' në telefonat celularë zyrtarë, i cili ka rreth një miliard përdorues në mbarë botën. Pas SHBA-së, komisioni i BE-së u ndaloi punonjësve të tij të përdorin aplikacionin 'TikTok' në telefonat celularë ose laptopët e punës. Arsyeja e vendimit është mbrojtja e të dhënave dhe shqetësimi për aksesin e shtetit kinez në kompaninë 'TikTok'.

Luftën në hapësirën kibernetike, po e zhvillojnë edhe shtetet jo demokratike dhe kundërshtarë me vendin tonë, të tilla si Kina, Rusia, Koreja e Veriut si dhe Irani. Sulmet kibernetike si alarme për bomba në shkolla në Maqedoninë e Veriut, janë bërë shumë shqetësuese nga tetori i vështirë.

Integrimi i inteligjencës artificiale në NATO kërkon një përpjekje të përbashkët të aleatëve për të standardizuar teknologjitë, në sektorin publik dhe privat, për të përmirësuar inovacionin dhe zhvilluar arsimin. Aleanca duhet të shfrytëzojë konkursat e teknologjisë, për të nxitur teknologjitë, me sipërmarrësit, drejtuesit e industrisë private, qeverisjes dhe akademive, të cilët do t'u mundësonin si shteteve ashtu dhe shkencëtarëve privatë të bashkëpunojnë. LAWS paralajmëron se shtetet autoritare, mund t'i zhvillojnë në mënyrë indirekte mjetet autonome vdekjeprurëse, duke e fshehur qëllimin e vërtetë nën avancimin e AI-së tek pajisjet civile. Vendimi i NATO-s për të ecur përpara me zhvillimin e AI-së dhe sistemeve autonome të armëve, kërkon një ndryshim të plotë organizativ dhe etik midis vendeve anëtare. "Ka tre vdekje tashmë të njeriut, kur vdes truri, vdes zemra dhe kur është jashtë rrjetit". Rrjetet sociale shfrytëzojnë padijen, dobësinë dhe vartësinë njerëzore, duke projektuar dhe pasur në mendje gjithmonë një përfitim.

Zhvillimi i vrullshëm dhe i pa kontrolluar për arsye fitimi i medias sociale, ka zhvilluar edhe një "negativitet" tjetër të teknologjisë të ashtuquajtur "dilema Sociale".

A është produkti që ne marrim falas nga rrjetet sociale, një gjë e mirë apo e keqe? Në kapitalizëm gjithçka paguhet dhe nëse ne nuk paguajmë për produktin, atëherë është e qartë se ne jemi vetë produkti. Kjo është industria e blerjes "falas" së vëmendjes. Kjo industri e re ka nevojë për njerëz të shpërqendruar, dhe të hapur ndaj reklamave që në median sociale janë shndërruar në epidemi. Rusia e përdori këtë fenomen në zgjedhjet e vitit 2016, duke arritur të shpërqendrojë opinionin amerikan lidhur me kandidaturat për president mes Klinton dhe Tramp.

Në terma afatgjatë, ky fenomen së bashku edhe me faktorë të tjerë, ka çuar në një epidemi të ashtuquajtur "sëmundje të shpërqendrimit".

Ne i mendojmë platformat tona të mediave sociale, thjesht një mjet për të mbajtur kontakte me miqtë dhe familjen tonë. Po këto platforma, nuk janë thjesht mjete, pasi po të ishin të tilla, ato nuk do na njoftonin, shqetësonin, joshnin dhe manipulonin, duke dërguar një lumë me njoftime dhe e-mail-e, të cilat kanë objektiv të blejnë falas, kohën tonë, vëmendjen tonë dhe përfundimisht vendimin tonë.

# Fusha kibernetike dhe hapësinore: Ndikimi në zhvillimin e operacioneve të mbrojtjes



**N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ,**  
Instituti i Kërkimit Shkencor Ushtarak

**S**ot, diskutimi për sfidat e mbrojtjes kibernetike dhe ngritjen e kapaciteteve në FA trajtohen si çështjet më të ndjeshme nga ekspertë të fushave të tyre përkatëse, dhe jo vetëm. Objekti i konferencës është për të ofruar mbështetje të mëtejshme për ndërtimin e kapaciteteve për të luftuar kërcënimet kibernetike. Pra janë momente për të gjithë ne, të trajtojmë tendencat e politikave të mbrojtjes kibernetike, duke përfshirë forcimin e qëndrueshmërisë kombëtare kibernetike në hapësirën kibernetike.

Kërcënimet kibernetike janë bërë një tipar i vazhdueshëm i jetës sonë të përditshme dhe ekosistemit në të cilin jetojmë. Kohët e fundit, hapësira kibernetike është keqpërdorur gjithnjë e më shumë nga aktorë të ndryshëm për të krijuar çrregullime, për të prishur funksionimin e shërbimeve të ndryshme publike, infrastrukturave kritike dhe për rrjedhojë uljen e cilësisë së jetës sonë. Sulmet kibernetike dhe aktivitetet keqdashëse kibernetike ndodhin vazhdimisht në kohë paqeje, krize dhe konflikti me efekte shkatërruese.

Njohja e dy mjediseve/fushave të reja operationale, mjedisit kibernetik dhe mjedisit hapësinor, ka çuar në përfytyrimin e disa mundësive 'asimetrike' të përfshirjes së një kundërshtari, me qëllim krijimin e dilemave të shumta për të, të cilat ai duhet t'i marrë në konsideratë. Kjo qasje ndaj operacioneve ushtarake është aktualisht e lidhur me konceptin e ri të operacioneve me shumë fusha. Megjithatë, duhet theksuar se jo vetëm njohja e dy mjediseve të reja, por edhe tre mjediseve klasike, përbën operacione me shumë fusha, por edhe mjedisi i ardhshëm i funksionimit në tërësi është një faktor nxitës. Kështu, në këtë artikull, qëllimi është të identifikojmë shkallën në të cilën dy mjediset e reja operationale kontribuojnë në zhvillimin e konceptit të ri të operacioneve, me qëllim që të nënvizojë rrugët e mundshme përpara në drejtim të zbatimit të operacionit, konceptin dhe zhvillimin e veprimeve specifike nga mjediset kibernetike dhe hapësinore. Pas vlerësimeve dhe analizave të kryera, janë venë re se fushat kibernetike dhe hapësinore po humbasin gradualisht rëndësinë brenda fazave të operacionit, ndërkohë që veprimet po copëzohen dhe decentralizohen. Ky fakt duhet të merret parasysh në zhvillimin e formacioneve.

Megjithëse fusha kibernetike dhe ajo hapësinore shihen përgjithësisht si mjedise që përmirësojnë ose mbështesin veprimet në ajër, tokë dhe në det, unë besoj se, në mjedisin aktual të sigurisë, rëndësia e tyre nuk është më pak e rëndësishme se ajo e fushave konvencionale. Kjo është kryesisht për shkak të faktit se ato mund të ndikojnë në fuqinë luftarake të një kundërshtari të mundshëm ose të forcave të tyre në një masë të tillë që përqindja e forcave të prekura prej tyre mund të jetë vendimtare në rezultatin e një konflikti, edhe para se konflikti të arrijë në fushëbetejën e saj të konfliktit të hapur. Besoj se kjo është në fakt tipologjia e llojit të ri të konfliktit, në kuptimin e arritjes së objektivave me mjete që nuk e kalojnë

kufirin që konsiderohet si shkas për planifikimin dhe zhvillimin e veprimeve ushtarake konvencionale, si p.sh. fillimi i një lufte konvencionale. Kështu, dy fushat e reja duket se i përshtaten në një masë të madhe asaj që qarkullon në mjedisin e tanishëm dhe të ardhshëm të sigurisë. Kjo është edhe arsyeja që mendoj se analiza e zhvillimeve në mjediset kibernetike dhe hapësinore është e rëndësishme në ditët e sotme.

Megjithatë, duhet të pranojmë që në fillim se këto mjedise ndikojnë, në idenë e deklaruar më parë për përmbushjen e objektivave pa shkakuar një konflikt të hapur, në një masë më të madhe të instrumenteve të fuqisë së shtetit, përveç atyre ushtarake, si ato diplomatike, informative dhe ekonomike. Instrumenti ushtarak ndikohet në një masë më të madhe vetëm gjatë harkut kohor në të cilin shkaktohet konflikti i hapur.

Ne vërejmë një mungesë lineariteti, në kuptimin që dy fusha të bashkangjitura me ato klasike dhe në varësi të instrumentit ushtarak kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në instrumentet diplomatike, informative dhe ekonomike, duke i shërbyer më pak instrumentit ushtarak në operacionet me shumë drejtime si faza e konkurrencës. Ky kompleksitet mund të jetë i vështirë për t'u menaxhuar. Megjithatë, është e nevojshme të analizohen elementët që dy mjediset e reja futin në marrëdhëniet e tyre me mjediset klasike dhe brenda instrumentit ushtarak në tërësi. Kjo mund të çojë në një ndërgjegjësim për mundësitë e përdorimit inovativ të forcave të armatosura në operacionet ushtarake.

Duke u nisur nga premisa se fusha kibernetike dhe ajo hapësinore synojnë, brenda veprimeve ushtarake, të rrisin dhe mbështesin veprime nga mjediset e tjera (ato mund të kategorizohen si shumëfishues të forcës), ne mendojmë dhe synojmë në verifikimin e hipotezës së mëposhtme kërkimore: fushat kibernetike dhe hapësinore do të çojnë në zbritjen e taktikave të reja për shërbimet që operojnë në mjediset klasike (përfshirë kombinimin e tyre inovativ sipas nivelit operacional) dhe do të ndikojë në mënyrën e arritjes së objektivave strategjike ushtarake. Për të nxjerrë përfundime pragmatike që konfirmojnë ose hedhin poshtë hipotezën e krijuar kërkimore, ne do të nënvizojmë korrelacionet e vendosura midis dy fushave të reja dhe operacioneve me shumë drejtime dhe qëllime në tërësi, duke marrë parasysh të dhënat që supozohet të përdoren në këtë punë, zakonisht ka me vete njësi që kanë misionet tilla si inteligjenca përmes veprimeve kibernetike – brenda veprimeve të interpretimit/përpunimit të informacionit.

Shembuj në mbështetje të kategorive të identifikuar janë lartpërmendur, por shkalla në të cilën këto kategori mund të përdoren në ushtri më të vogla është e vështirë për t'u llogaritur. Kështu, besoj se në lidhje me zhvillimet në fushën kibernetike, mund të thuhet se mbrojtja, manipulimi, evazioni dhe përdorimi i informacionit, aspekte që përmbledhin kategoritë e paraqitura, paraqesin një sofistikim të misionit bazë të identifikuar.

Si rezultat, megjithëse ky përpunim i misionit kryesor nuk është pa bazë, duke qenë se zhvillimet teknologjike kanë ofruar një gamë gjithnjë e më të gjerë për identifikimin dhe përdorimin inovativ të mjeteve që mund të ofrojnë ky mjedis, besoj se është e rëndësishme të kujtojmë se është vetëm informacioni që drejton zhvillimet në këtë mjedis.

NATO i ka përkufizuar si 'mjedisi i pestë', në dhjetor 2019, ndërsa në takimi i liderëve të vendeve anëtare të NATO-s (NATO 2022), ka njohur atë si një çështje që lidhet me sigurinë e Aleancës. Kërcënimet kryesore që NATO ka identifikuar në këtë mjedis, ato që lidhen me efektet fizike në hapësirën e jashtme dhe veprimet e drejtuara ndaj aftësive në hapësirë.

Megjithatë, mendoj se është shumë më e rëndësishme të theksohet, nga pikëpamja ushtarake, fakti se nga ky domen mund të ndikohen veprimet në të gjitha fushat e tjera, kështu që hapësira shihet më shumë si një faktor potent për veprimet në fushat e tjera, pa të cilat veprimet e forcave të armatosura mund të privohen nga avantazhi i informacionit të plotë për një kundërshtar të mundshëm. Në këtë kuptim, shqetësimet kryesore përfaqësohen nga: fakti që përfaqëson një mjedis integruar për komunikim; mundëson mbledhjen, interpretimin e informacionit në mbështetje të operacioneve dhe misioneve; me ndihmën e satelitëve, krizat mund të monitorohen dhe NATO dhe mund të ndërhyjë në mënyrë efektive në kohën e duhur.

Pra, konsideroj se veprimet në fushën hapësinore mund të ndahen në veprime fizike që zhvillohen në hapësirë në mjete hapësinore dhe veprime që janë të drejtuara drejt katër fushave të tjera. Këto të fundit ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e ushtrisë. Megjithatë, është evidente se zhvillimi i aftësive për të shkatërruar satelitët e lëshuar në këtë mjedis parashikohet për të parandaluar kategorinë e dytë të misioneve në këtë mjedis. NATO i ndan veprimet hapësinore në veprime drejt, nga dhe në hapësirë. "NATO ka pranuar se sulmet në, nga ose në hapësirë paraqesin një sfidë të qartë për sigurinë e Aleancës dhe mund të çojnë në thirrjen e nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut" (NATO 2022).

Kështu, bazuar në elementët përcaktues të operacioneve me shumë fusha të paraqitura në dokumentin e lartpërmendur, koncepti mund të ndahet në tre elementë kryesorë që kontribuojnë në kuptimin e konceptit të ri: menaxhimi i informacionit (sidomos në fazën e parë dhe të pestë – konkurrencë dhe rikthim në konkurrencë në kushte të favorshme) – veprime që nuk varen vetëm nga instrumenti ushtarak; adresimi i çështjes A2/AD (fazat e dyta dhe të treta – depërtimi dhe shpërbërja) dhe kryerja e operacioneve të përbashkëta të përshtatura me kushtet e reja në mjedisin operacional, nëpërmjet mbështetjes ndërmjet shërbimeve (shfrytëzimi).

Duke qenë se në dy pjesët e para u prezantuan elementët që lidhen me dy fushat e reja si dhe përshkrimi përmbledhës i operacioneve me shumë fusha, do të paraqes shkurtimisht disa aspekte që lidhen me thellësinë strategjike, duke pasur parasysh faktin se, kryesisht, qëllimi i një operacioni, në rastin tonë është të kontribuojë në arritjen e objektivave të nivelit strategjik. Megjithatë, duhet theksuar se operacionet me shumë fusha ka shumë të ngjarë të kryhen në një nivel strategjik për shkak të shtrirjes dhe diversitetit të veprimeve të përfshira (duke mos qenë tërësisht nën komandën dhe kontrollin e instrumentit ushtarak. Problemi me të cilin përballemi, në mjedisin aktual të sigurisë, është fakti se thellësia strategjike nuk i referohet më vetëm hapësirës fizike (gjeografike) dhe mund të ketë forma të ndryshme



që janë shfaqur si rezultat i mënyrave të menaxhimit të informacionit dhe rritjes së saktësisë dhe goditjes së sistemeve të armëve. Kjo është arsyeja që nevojitet një lloj i ri operacioni për t'iu përgjigjur zhvillimeve të reja të konceptit të thellësisë strategjike, në kuptimin e një ideje të re që përmbledh realitetin aktual dhe atë që pritet të ndodhë në të ardhmen e afërt.

Prandaj besoj se ajo do të jetë objekt diskutimi pasi çështja duhet të shqetësojë ushtarakët që janë përgjegjës për zhvillimin e këtij koncepti, identifikimi i mënyrave të përdorimit të fushave kibernetike dhe hapësinore brenda veprimeve specifike për shërbimet ose nxjerrja e taktikave të reja nga shërbimet që marrin parasysh mundësitë e përdorimit të teknologjive nga dy mjediset e reja.

Duke ndihmuar procesin e parapërgatitjes për diskutime të gjera, shkrimi ka subjekt sidomos ndikimin e dy mjedisëve të reja operacionale në zhvillimin e një koncepti të ri të quajtur operacioni me shumë fusha që synon të sintetizojë realitetin përmes një ideje, përshkrimi i elementëve që përbëjnë dy mjediset se menaxhimi inovativ i informacionit i mundësuar nga teknologjia përfaqëson një përditësim të instrumentit ushtarak, duke i mundësuar të ndikojë në rezultatin e një konflikti që në fazat e hershme.

Kontrolli i hapësirës ajrore është thelbësor për kryerjen e veprimeve ushtarake në mjediset detare dhe tokësore, kontrolli i mjedisëve kibernetike dhe hapësinore është gjithashtu vendimtar për operacionet me shumë fusha, pasi të gjitha këto

veprime përfaqësojnë një operacion me shumë fusha.

Brenda këtij kuadri në mënyrë empirike trajtova konceptin e thellësisë strategjike, i cili për mendimin tim është objektivi i nivelit strategjik që operacioni me shumë fusha duhet të jetë në gjendje të arrijë, duke marrë parasysh faktin se thellësia strategjike e epokës së informacionit ndryshon nga ajo që përfaqëson në Luftën e Dytë Botërore.

Në vijim theksoj se çështje të tilla janë edhe doktrinare për faktin se fushat kibernetike, duke analizuar korrelacionet midis tre elementëve, arrijmë në përfundimin se, për instrumentin ushtarak, faza e shfrytëzimit të operacionit me shumë fusha është faktori kyç i suksesit të tij.

Gjithashtu, çështjen e zbatimit të elementeve nga mjedisi kibernetik dhe ai hapësinor brenda shërbimeve, ato duhet të jenë në gjendje të mbështesin operacionet e përbashkëta (faza e shfrytëzimit). Ky aspekt për ne duhet të jetë objekt për zhvillimin e këtij koncepti dhe duhet të çojë në përsosjen e taktikave të shërbimeve për të përfshirë elementët që ofrojnë dy mjediset e reja.

Në përfundim, unë konsideroj se fushat kibernetike dhe hapësinore nuk e kanë arritur ende potencialin e tyre maksimal brenda operacioneve me shumë fusha, dhe shkalla në të cilën ata do të arrijnë këtë potencial përcaktohet nga mundësia e një konflikti midis fuqive të mëdha ushtarake që janë të gatshme për të investuar në zbatueshmërinë ushtarake të teknologjive të reja specifike për këto dy fusha.

# “Arsimimi Ushtarak Shqiptar - 65 vjet Akademia e Forcave të Armatosura”

“**A**rsimimi Ushtarak Shqiptar - 65 vjet Akademia e Forcave të Armatosura”, mbledhi në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes studiuës të historisë ushtarake, kërkues shkencorë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në fushën e arsimit dhe doktrinës.

Krijimi i Akademisë Ushtarake është një ngjarje e rëndësishme e historisë së arsimit ushtarak, të kulturës dhe shkencës ushtarake në nivel kombëtar.

Akademia e Forcave të Armatosura në rrugëtimin e saj 65-vjeçar ka kontribuar në përgatitjen e shumë brezave të liderit ushtarak, në zhvillimin dhe konsolidimin e Forcave të Armatosura.

Për të sjellë edhe njëherë në vëmendje rolin dhe vlerën e këtij institucioni arsimor, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri do të shprehej: “10 Maji është një nga ditët më të rëndësishme në historinë e arsimit ushtarak shqiptar, është dita krijimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, dhe sot mbushen 65 vjet nga krijimi i saj.

Përcjell urimet më të përzemërta për të gjithë studentët dhe kursantët, personelin akademik dhe jo akademik, ushtarak dhe civil, që sot janë pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura.

Puna dhe kontributi juaj i vyer e i përditshëm, gjithnjë e më shumë po i shërben rritjes dhe konsolidimit të Akademisë



dhe shndërrimit të saj në “vatrën” e krijimit të gjeneratës së re të oficerëve të Forcave të Armatosura, por edhe kontribuuese në zhvillimin e shoqërisë, duke formuar liderin e ardhshëm e me karakter të përkushtuar ndaj vlerave që buro-

jnë nga tre fjalët e shenjta: Nderi – Detyra – Atdheu, të cilat diktojnë se çfarë duhet të jemi, çfarë mund të jemi dhe çfarë do të jemi.

Historia 65-vjeçare e Akademisë ka thesar të saj ka kontributin, përkushtimin,





profesionalizmin, devocionin dhe përpjekjet e palodhura të gjithë atyre që kanë qenë pjesë e saj në këtë udhëtim. Thellësisht mirënjohës e falënderues për gjithçka ato mundën dhe bënë për arsimimin ushtarak dhe Akademinë e Forcave të Armatosura.

Në këtë përvjetor të shënuar të 65-vjetorit të AFA-së, një falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata që pavarësisht se nuk janë drejtpërdrejt pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura, me mbështetjen e tyre kanë qenë janë e do të jenë pjesë e rëndësishme e suksesit dhe arritjeve të Akademisë. Ndërsa zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, në fjalën e saj të rastit do të sillte këndvështrimin historik

të zhvillimit të Akademisë të Forcave të Armatosura: “Konferenca të tilla janë të rëndësishme, sepse ato synojnë të vendosin piketat se ku duhet të shkojë arsimi, trajnimi dhe stërvitja në FA. Zhvillimi edhe në kuadër të 65-vjetorit të AFA-së është edhe më domethënës dhe kuptimplotë.

Kjo është e kuptueshme, sepse akademia ka qenë simboli, dinjiteti, trashëgimtarja dhe bashkudhëtarja e të gjitha ndryshimeve, zhvillimeve dhe përparimeve të arsimit tonë ushtarak. Është rasti të shpreh mirënjohjen për kontributin dhe vlerat e të gjithë brezave të pedagogëve, instruktorëve, drejtuesve e kërkuesve, që kanë punuar dhe shërbyer në këtë institucion të arsimit të lartë.

Aktualisht ne jemi në proces të zbatimit të një pakete ndryshimesh dhe zhvillimesh në të gjithë FA-në. Një nga prioritetet e këtyre zhvillimeve është edhe sistemi arsimor. Fakti është që jemi në kërkim dhe zhvillim të një sistemi arsimimi ushtarak të standardeve bashkëkohore, të qëndrueshëm dhe cilësor. Për këtë qëllim, tashmë ne kemi përcaktuar si objektiv modelin elitare të ‘West Point-it’.

Sistemi ynë i sotëm arsimor, është guri i themelit të suksesit apo dështimit tonë në të ardhmen.

Ne jemi të vetëdijshëm për problemet e sotme të arsimit ushtarak. Kjo do të thotë që një nga pritjet e konferencës duhet të jetë përmirësimi i gjendjes së sistemit tonë arsimor ushtarak, i cilësisë, profesionalizmit, fleksibilitetit dhe deri tek kohezioni i tij edhe me standardet dhe politikatat arsimore të vendeve të Aleancës.

Prandaj, ndër sfidat kryesore aktuale, që unë shikoj dhe besoj t’i konsideroj edhe kjo Konferencë, janë zhvillimi dhe konsolidimi i shpejtë i shkollës tonë të përgatitjes së oficerit të ri dhe orientimi i studiuar e i saktë i arsimit tonë ushtarak në tërësi, në të gjitha nivelet dhe për të gjitha kategoritë, drejt nevojave reale të FA-së.

Neve na duhet një sistem fleksibel dhe adaptiv ndaj një mjedisi që ndryshon vazhdimisht dhe me shpejtësi.

Synimi final i arsimit tonë është përgatitja e ushtarakëve tanë të aftë për t’u përballur me një mjedis të tillë”, - do të mbyllte fjalën e saj gjeneralmajor Shehu. Në fjalën e tij përshëndetëse zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Joti falënderoi studiuesit, kërkuesit shkencorë si dhe profesorët e AFA-së për impenjimin në vite drejt perfeksionimit të arsimit të Forcave të Armatosura si dhe ofroi mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes për trajnimin dhe urat e bashkëpunimit me simotrat tona në NATO. Më tej konferenca vazhdoi me të tjerë referate, të cilët trajtuan tematika të ndryshme rreth ecurisë së këtij institucioni dhe pikësynimet e së ardhmes së afërt. Në fund të konferencës në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm u shpërndanë certifikata mirënjohjeje për kontribuuesit në fushën e arsimit, mbrojtjes dhe sigurisë.

# Kremtohet 55-vjetori i krijimit të Batalionit të Xhenios

**N**ë ambientet e Batalionit të Xhenios në një atmosferë festive u zhvillua ceremonia e kremtimit të 55-vjetorit të krijimit të këtij batalioni. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm komandanti Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ferdinant Dimo, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, xhenierë, efektiv të batalionit ndër vite si dhe të ftuar të tjerë. Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, i cili pasi falënderoi pjesëmarrësit u ndal në punën e palodhur, përkushtimin, profesionalizmin e xhenierëve ndër vite dhe deri në ditët e sotme, ku puna e dora e tyre ndihet kudo në vend.

Më pas fjalën e mbajti komandanti i parë i batalionit Xheniero-Ndërtues, Abil Zerani, i cili foli mbi rëndësinë e këtij batalioni që nga krijimi i tij, detyrat e veçanta dhe evoluimin ndër vite. Komandanti i KM, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, në fjalën e tij përshëndetëse kujtoi punën dhe vetëmohimin e xhenierëve ndër vite, angazhimin e tyre në rritjen e sigurisë në vend si eliminimin e minave të paplasura, ndërtimin e urave, prishjen e masiveve shkëmbore etj. Ai përmendi dhe efektivat EOD në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s, në Letoni si dhe u ndal në vëmendjen që ka Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda Mbështetëse në veçanti për modernizimin e këtij batalioni, kompanisë EOD, si aset i Forcave të Armatosura shqiptare. Në fund të ceremonisë u bë një foto e përbashkët.





# FAj, 72 vjet histori suksesi shkruar me germa të arta

**N**ë Bazën Ajrore Farkë u zhvillua ceremonia e 72-vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar.

Në aktivitetet ishin të pranishëm, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, përfaqësues të Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë, Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Aviacionit, pilotë, teknikë, instruktorë si dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore. Në fjalën e rastit, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, pasi i uroi mirëseardhjen të ftuarve, kujtoi 24 prillin e vitit 1951 si datën kur Arma e Aviacionit Shqiptar hodhi hapin e parë të saj, armë e cila ndër vite ka pësuar transformim, modernizim dhe përsosje të teknologjisë, duke theksuar se vit pas viti Forca Ajrore e gjen veten më të kualifikuar dhe më të trajnuar, më të modernizuar teknikisht e më të aftë profesionalisht, aftësi jetike për ruajtjen e vitalitetit të kësaj force dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit. Komandanti i Forcës Ajrore kujtoi me respekt brezat e komandantëve, pilotëve, teknikëve, inxhinierëve dhe punonjësve



civilë, të cilët me pasion dhe përkushtim i shërbyen Aviacionit Ushtarak Shqiptar, duke e bërë atë një armë të dashur për të gjithë, ndërsa kujtoi Dëshmorët e Aviacionit Ushtarak, të cilët sot janë nderi dhe krenaria e

Forcës Ajrore. Në emër të shoqatës së Aviacionit Ushtarak Shqiptar përshëndeti gjeneral brigade Astrit Jaupi. Në përshëndetjen e tij shprehu falënderimet dhe mirënjohjen për të gjithë ushtarakët dhe punonjësit civilë të Forcës Ajrore, duke theksuar se: “Historia e Aviacionit Ushtarak ka shkruar me germa të arta, punën, kontributin dhe sakrificat deri në ato sublime të gjeneratave të tëra të komandantëve, pilotëve, teknikëve, personelit inxhiniero-teknik dhe atij mbështetës, civil dhe ushtarak, të cilët shërbyen me përkushtim e dashuri në përmbushjen e misionit të Forcës Ajrore.”

Aktiviteti u mbyll me një foto të përbashkët dhe një takim me veteranët e Aviacionit Ushtarak.



# Arsyet, domosdoshmëria e krijimit dhe karakteri gjithshqiptar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, në vitet e para të shtetit shqiptar



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

## Organizimi i strukturave dhe formacioneve


Me krijimin e shtetit shqiptar të pavarur, vërtiteshin e dyndeshin probleme dhe vështirësi të mëdha. Ndër të parat ishin dhe organizimi i strukturave dhe formacioneve të Forcave të Armatosura Shqiptare. Këto duhej të bënin mbrojtjen e vendit nga pushtuesit fqinj, si dhe ruajtjen e qetësisë dhe të rendit. Në këtë kohë vendi ishte i izoluar tërësisht. Shtetit të ri i nevojiteshin ushqime, armatime dhe municione, pajisjet dhe veshjet e domosdoshme për të mbajtur forcat ushtarake. Sapo ishte krijuar infrastruktura e nevojshme, që ishte e paktë dhe e pafuqishme për realizimin e detyrave dhe qëllimit për të cilat ishin ngritur. Veprimet luftarake mbrojtëse vijonin dhe vendin e kërcënonin rreziqe të reja.

Mehmet Pashë Dërralla, i ndihmuar prej 15 oficerësh holandezë, nën komandën e kolonel De Veer, formoi një xhandarmëri prej 4 000-5 000 vetë si mbrojtje e parë ushtarake për qeverinë e re. Xhandarmëria u nda në detashmente, kompani dhe kalorësi me 120 ushtarë. Këto kishin veshje italiane, si dhe ishin të pajisur me pushkë, topa dhe mitraloza. Komandën në këtë xhandarmëri e mori Gilhard. Fuqitë e Ismail Qemalit u ndihmuar dhe nga Aqif Përmeti, i cili në SHBA, kishte mbledhur vullnetarë shqiptarë, si dhe kishte organizuar bandën "Vatra". Qeveria kërkoi nga komandanti i Beratit, Kara Said Pasha, për të siguruar rezerva me armë, municione dhe materiale luftarake nga ushtria e tij, para se të largohej për në Turqi.

Në këto rrethana Majori Ali Shefqet Shkupi erdhi në Shqipëri

nga fundi i prillit 1913. Në moshën 30-vjeçare, ai ishte një personalitet i njohur, ushtarak i talentuar dhe atdhetar i njohur dhe i afirmuar. Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe Ministria e Luftës i ofruan atij postin e rëndësishëm dhe të vështirë të Kryetarit të Shtabit Madhor (Shtabit Madhner). Kështu, më 4 maj 1913, doli vendimi për krijimin e Shtabit Madhor nga Qeveria e Vlorës. Për ndërtimin e Forcave të Armatosura Shqiptare, Ali Shefqeti me energjinë, dinamizmin dhe talentin e tij, si dhe të bashkëpunëtorëve, gërshetoi mjaft mirë përvojën, mençurinë dhe moshën e gjeneral Dërrallës, duke u përputhur me realitetin shqiptar të asaj kohe.

Ngritja dhe vënia në lëvizje e këtij organizmi pati një rëndësi të veçantë për ushtrinë. Ky veprim shënoi një nivel të ri të organizimit të saj. Vetë shtabi përbënte një dukuri dhe praktikë bashkëkohore të përparuar dhe njëkohësisht dëshmonte kulturën e mirë politike e ushtarake të drejtuesve të shtetit. Nga pikëpamja organizative shtabi përbëhej nga: qarqet e shtabit madhner, shkresina e shtabit madhner, komisioni i rregulloreve dhe ushtrimeve, komanda e trajtimit të policisë e xhandarmërisë dhe komisioni i ndërtimit. Shtabi Madhor ishte konceptuar dhe ndërtuar, por edhe veprroi, si një organ bazë i Ministrisë së Luftës.



Kjo do të thoshte se ai edhe nga ana praktike ishte përgjegjës kryesor për organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimeve luftarake të FA-ve.

Misioni i shtabit madhuer ishte organizimi, përgatitja dhe drejtimi profesional i veprimeve luftarake të Forcave të Armatosura. Shtabi Madhor u strukturua dhe u organizua me disa zyra të nevojshme dhe vijoi ndërtimi i strukturave të FA-së, ku u përfshinë forcat aktive, rezerviste dhe vullnetare. Në kuadrin e organizimit të forcave aktive të ushtrisë Shqiptare, në linjën e raporteve me Ministrinë e Luftës, të cilën e informonte rregullisht, kryetari i shtabit Madhor e njoftonte, më 31 maj 1913, për punën që bëhej për të organizuar kompaninë model në Vlorë, me ushtarë shqiptarë.

Ministria e Luftës dhe Shtabi Madhor filluan të punonin me përkushtim dhe profesionalizëm në përgatitjen e rregulloreve ushtarake. Në to përcaktohej mënyra e organizimit, rekrutimit ushtarak, drejtimi i forcave, jeta dhe stërvitja e ushtrisë së re shqiptare. Kështu Shtabi Madhor u angazhua për të diskutuar dhe miratuar në Qeverinë e Vlorës "Rregulloren e organizimit (formimit) të Milicisë Shqiptare", të dokumentuar më 3 qershor 1913.

Krijimi i milicisë ishte i domosdoshëm deri sa të formohej dhe organizohej në një shkallë të nevojshme, ushtria e rregullt shqiptare. Në këtë rregullore, me artikuj (nene) të veçantë qartësoheshin problemet e organizimit, të detyrimit ushtarak, të hierarkisë, detyrat luftarake, çështje të administrimit, të rregullit ushtarak etj.

Ky dokument tipik bashkëkohor, flet edhe sot pas 110 vjetësh për nivelin kulturor dhe profesional të këtyre ushtarakëve, por që dëshmon edhe për përmasat e ushtrisë shqiptare dhe të seriozitetit të saj.

#### **Ushtria shqiptare me kërkesa të një ushtrie të rregullt**

Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 29 korrik 1913, vendosi pavarësinë e plotë të Shtetit Shqiptar. Ajo caktoi një komision ndërkombëtar për kontrollin e xhandarmërisë. Kjo forcë do të organizohej nga oficerë suedezë për të siguruar qetësinë dhe rregullin e brendshëm. Deri në këtë vit nuk mund të flasim dhe përmendim për ndonjë ushtri shqiptare të rregullt.

Në gjysmën e dytë të vitit 1913, Shtabi Madhor sipas planit të miratuar nga Ministria e Luftës, po organizonte një ushtri shqiptare me kërkesat e një ushtrie të rregullt. Kjo u duk në organizim, në pajisje, në armatim, në veshje dhe në stërvitje. Kështu u organizua një kompani model, që më pas do të ndiqej nga disa të tjera. Kështu u porositën në Austri armatime (topa, mitraloza), municione, uniforma të nevojshme për një ushtri të rregullt. U bashkëpunua me oficerë holandezë, si koloneli De Veer, që u morën me organizimin dhe stërvitjen e Xhandarmërisë shqiptare.

Për herë të parë në shtetin shqiptar u zbatua ligji ushtarak i rekrutimit. Kështu u porositën prefekturat e vendit për procedurat e rekrutimit të djelmoshave shqiptarë për shërbim të rregullt ushtarak. Në kreun e kësaj rregulloreje të "Detyrimit Ushtarak", theksohej se shërbimin ushtarak do e kryente "çdo mashkull nga mosha 20-40 vjeç, që është në gjendje të mirë shëndetësore". Merita e këtij shtabi ishte plotësimi i nevojave të ushtrisë me rregullore, duke i shqipëruar ato nga literatura bashkëkohore.

Me mbërritjen e princ Vidit, në mars 1914, në Shqipëri ndodhën luftime të pjesshme kundra armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Në statusin e Principatës Shqiptare bëhej fjalë për një lloj ushtrie, duke u organizuar në Milici, që të mos ishte në kazerma, por të mblidhej për ushtrime dhe stërvitje. Në kohën e Vidit nuk pati ndonjë përparim për sa i përket ushtrisë. Xhandarmëria e organizuar nga kolonel Tomson,



sidomos në Durrës ishte prej kontingjentesh vullnetarësh, si dhe një bateri të vogël artilerie.

Shënohet një përparim në këtë periudhë, kur Ali Kosturi, në krye të 250 ushtarëve dhe 50 kalorësve të xhandarmërisë, u ngarkua t'u bëjë ballë fuqive greke që kërcënonin Korçën. Aty kishte dhe xhandarë nga Vlora, por që ishin shumë të dobët për plotësimin e detyrës së ngarkuar. Kështu në bashkëpunim me prefektin e Korçës Pandeli Evangjelin, u formua një ushtri e vogël për mbrojtjen e kufirit. Kështu u thirrën në shërbim 20-40-vjeçarë dhe formuan nga në batalion në qendrat: Kolonjë, Korçë, Devoll dhe Starovë. Komanda e këtij regjimenti u vendos në Korçë, ndërsa batalionet u ndanë në kompani dhe u shpërndanë në kufi. Oficerët kishin veshur uniforma dhe ushtarët me bluza ushtarake dhe kasketa në formë angleze dhe të armatosur me pushkë. Organizimi i rregullt në ushqime dhe transport i dha formë kësaj ushtrie dhe me ndihmën e oficerëve holandezë. Ky organizmi mund të quhet si formacion i parë ushtarak i rregullt i Shtetit të ri.

#### **Masa për ngritjen e fuqive ushtarake të popullit shqiptar**

Në periudhën nga largimi i Princit deri në ardhjen e Fuqive të Antantës, në Shqipëri sundoi anarkia dhe u mbush me luftëra në çdo cep të saj. Gjatë Luftës së Parë Botërore në Shqipëri nuk mund të flitej për institucione të mirëfillta legjitime e kombëtare, vendin e kishte mbërthyer anarkia. Ushtritë e Fuqive të Mëdha, Austro-Hungaria dhe Italia e Franca hynë në Shqipëri nga viti 1915. Ato morën masa për ngritjen e fuqive ushtarake të popullit shqiptar, ku secila nga këto fuqi përpqej të ndihmonte në rikrijimi e Shqipërisë indipendente. Italianët në zonën e tyre të pushtimit formuan dy batalione me nga katër kompani secili. Komandantët e këtyre njësive deri në fund të luftës ishin italianë. Nga fundi i luftës në rreshtat e këtij legjioni disa shqiptarë që kishin mbaruar në Itali kurse dhe Akademi Ushtarake. Qendra e batalioneve ishte në Gjirokastër, Delvinë dhe më pas në Përmet. Ushtarët e batalioneve paguheshin çdo ditë, u jepej bukë, kafe e sheqer. Kishin të veshur uniforma italiane dhe si shenjë dalluese mbanin një qeleshe të bardhë me simbolin e shqiponjës. Armatimi i tyre përbëhej nga pushkë dhe mitraloza italianë. Në këtë periudhë u formuan kompani me trupa vullnetarë shqiptarë, që udhëhiqeshin nga shqiptarë dhe ishin të pavarur nga komanda italiane.

Fuqia e këtyre forcave u përdor për të forcur kufirin dhe mbrojtur vendin në pjesën jugore të Shqipërisë nga Korça në Vlorë. E veçantë është se batalionet e rregullta vepruan sipas rregullit dhe të gjitha ushtrimeve të stërvitjeve të rregulloreve përkatëse, ndërsa batalionet e parregullta luftonin sipas

traditave të tyre. Në këtë periudhë kujdesi i austriakëve për stërvitjen ushtarake ishte tepër i veçantë, pasi në këtë vit ata kishin pushtuar pjesën më të madhe të Shqipërisë. Në këtë kohë, nga bisedimet e austriakëve me Malin e Zi, u liruan mjaft personalitete shqiptare që ishin internuar aty. Sukses të dukshëm pati Gilhardi, i cili me ndihmën e Ahmet Zogut, mblodhi një kontingjent dhe veproi në qarkun e Vlorës, ku krijoi nëntë batalione me nga 500 veta secili. Ndërsa në krahinën e Korçës formacionet vullnetare nën komandën e Sali Butkës, mbrojtën juglindjen e vendit. Trupat austro-hungareze marshuan drejt Vlorës dhe më pas u shtrinë në Berat e Pogradec, u organizua një rregull i ri në formacionet vullnetare. Kështu në çdo sektor u vendos dhe një kompani shqiptare, duke shërbyer bashkë me austriakët.

Në Shkodër dhe në Krujë e qendra të tjera, duke i lëshuar udhë një logjike më të mirë, u organizuan shumë batalione shqiptare, si rezerva dhe të rekrutuar. Të gjitha këto masa për të mësuar popullsinë që në këtë periudhë nuk njihnin aspak rekrutimin dhe shërbimin ushtarak. Në fillim këto batalione përbëheshin prej vullnetarëve, por më pas hyri në fuqi rekrutimi. Kështu formacionet e reja filluan stërvitje ushtarake nga oficerë austriakë dhe nënoficerë boshnjakë, si dhe aspirantë shqiptarë që kishin bërë kurs në Shkodër. Më pas u krijuan dhe dy batalione me malësorë, ku secili prej tyre kishte flamurin e kuq me shqiponjën e zezë. Kështu në paradën e mbajtur para Komandantit të Truparmatës, gjeneralit Trollman, batalionet shqiptare morën me të drejtë lavdërime për qëndrimin e bukur të tyre. Kështu filloi stërvitja ku u trajnuan 1 500 luftëtarë. Rreth 40 djem shqiptarë u dërguan në shkollat ushtarake të Austrisë dhe një pjesë e tyre u kthye në atdhe mbas luftës, ku hynë në ushtrinë shqiptare dhe shërbyen me devotshmëri. Të gjitha këto formacione u shpërndanë me mbarimin e Luftës së Parë Botërore. Qëndroi vetëm një, batalioni i milicisë nën komandën e Mark Rakës dhe më pas të Ismail Tazatit që ishin në Gjirokastrë e Delvinë. Ky batalion më pas u vendos në Korçë pas largimit të francezëve dhe një pjesë në Tiranë. Në këtë periudhë në Kosovë formohet një batalion milicie, nën drejtimin e Ali Rizait, i cili ende vazhdonte t'i qëndronte besnik ushtrisë, por dhe ky u shpërnda shpejt. Në këtë periudhë të luftës u stërvitën oficerë dhe ushtarë, si në drejtim të artit të luftimit, por edhe në drejtim të bashkëpunimit dhe të pajisjes me armatim e municione të kohës. Nga sasia e madhe e materialit të luftës që lanë ushtritë e huaja që po tërhiqeshin nga vendi, u pajis ushtria e më pastajshme.

### Rimëkëmbja e ushtrisë dhe shtatmadhoria

Gjatë okupacionit Italian, deri në gusht 1920, në Durrës u përqendruan mjaft oficerë, ku nën komandën e Kapitenit Ismail Haku u organizua një Xhandarmëri vendase. Italianët e përkrahën këtë organizim dhe prunë në Shqipëri nënkolonelin Ridolf dhe karabinierë. Kështu në Tiranë u çel një shkollë për oficerë dhe aspirantë të Xhandarmërisë. Duke kryer një kurs deri në katër muaj, në gusht 1919 u formua një batalion xhandarmërie. Kështu në qendrat e prefekturave u ngritën komanda batalionesh, në nënprefektura, komanda kompanish dhe në krahina komanda toge e posta të nevojshme. Me këtë organizim të ri u larguan karabinierët dhe shërbimi i xhandarmërisë në të gjithë tokën shqiptare u besojë formacioneve vendase.

Qeveria e Kongresit të Lushnjës, në janar 1920, krijoi Ministrinë e Luftës, me në krye gjeneral brigade Ali Riza Kolonjën. U ringrit struktura e Shtatmadhorisë, me në krye nënkolonel Ali Shefqetin. Në nëntor 1920 u caktua ministër Luftime kolonel i Shtatmadhorisë Selaudin Said Shkoza. Në detyrën e kryetarit të



Shtabit Madhor u caktua Ali R. Kolonja, i cili kryente dhe detyrën e komandantit të Divizionit aktiv të Ushtrisë.

Shtatmadhoria varej nga ministri i Luftës. Ajo vlerësohej si një hallkë e rëndësishme për organizim, drejtim, stërvitje dhe planëzim për veprimtarinë e Ushtrisë. Shtatmadhoria ishte racionale në përbërje dhe efektive në veprimtarinë e saj. Kishte në varësi seksione: të mobilizimit, personelit, intendencës, planëzimit etj. Ajo kryente detyra si hartim të projektligjeve, rregullore të shërbimit ushtarak, drejtim të operacioneve ushtarake për ruajtjen e rendit dhe të integritetit territorial të vendit etj.

Hulumtimi i fillesave të shtabit ushtarak shqiptar në këto 110 vjet të jetës së tij, nuk është vetëm një domosdoshmëri historike, por edhe me rëndësi të veçantë në krijimin e kujtesës kombëtare të ushtrisë shqiptare. Shumë nga ëndrrat dhe projektet e ushtarakëve shqiptarë të asaj kohe janë tashmë të mishëruara më së miri në reformat e suksesshme në Forcat e Armatosura shqiptare. Megjithatë, ende sot është mirë që disa prej këtyre traditave të risillen në ushtri, për të theksuar rëndësinë e ushtrisë kombëtare, e cila sot po iu përgjigjet njëkohësisht edhe sfidave të kohës, duke qenë pjesëmarrëse përkrah ushtrive të NATO-s. Nëse të gjithë përpiqemi të bëjmë detyrën tonë si qytetarë e ushtarakë të mirë, atëherë me të vërtetë kemi kryer një detyrim ndaj vetes, familjes dhe kombit. Një komb i ditur dhe me ushtri e shtabe profesionist nuk ka rëndësi se sa i madh është, do të dijë t'u bëjë ballë sfidave e të dalë faqebardhë.



Shtabi i Ushtrisë Shqiptare

# Arma e Tankeve në rrugëtimin e saj historik



VETERAN I ARMËS SË TANKEVE,  
MYFIT METANI

## Fillesat e organizimit të Armës së Tankeve...

Fillimisht struktura më e lartë organizative e armës së tankeve ishte Dega e Tankeve me shef Adnan Qatipin në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë. Në përbërje ajo kishte instruktor për taktikën, zjarrin e teknikën. Dega e Tankeve në momentet e para u ndesh me shumë probleme të strukturës organizative, të vendvendosjes (rajonet e përqendrimit), të drejtimeve të përdorimit e të detyrave të armës së tankeve në llojet e luftimit në bashkëveprim me këmbësorinë, artilerinë etj. Sipas artit ushtarak të kohës, detyra për ndërtimin e strehimeve nëntokësore (tuneleve) e vendosjen e teknikës së tankeve në to, krijimin e kushteve për efektivin për jetesë e stërvitje etj. Dega e Tankeve zgjidhi më së miri problemet momentale. Në vitet 1946-1960 Arma e Tankeve u pajis me tanke T-34. U krijuan njëri pas tjetrit reparte tankiste (batalione tankesh-bt.) në Zall Herr të Tiranës me komandant batalioni Estref Musabelliu, në Shkodër, në Elbasan me komandant batalioni Aleko Koka, në Berat me komandant batalioni Loni Kristo (fillimisht Demo Liço), në Korçë me komandant batalioni Shefqet Dini, në Gjirokastrë, në Fier me komandant batalioni Demo Liço. Në vendet e vendosjes së reparteve mungonin kushtet më minimale të jetesës e stërvitjes. Niveli e mjeshtëria e

drejtimit të komandantëve, në kohë rekord e ndryshuan gjendjen. Fillimisht krijuan kushtet e nevojshme minimale për jetesë e stërvitje e në vijimësi shumë reparte u bënë model në ushtri. Batalionet e tankeve me 31 tanke përbëheshin nga tri kompani tankesh me nga 10 tanke secila. Kompanitë e tankeve me 10 tanke nga tri toga tankesh me nga 3 tanke secila dhe një tank i komandantit të kompanisë.

## Për një staf më cilësor

Pas viteve 1960 Arma e Tankeve mori një zhvillim në historinë e saj. Para drejtuesve të tankeve në Shtabin e Përgjithshëm të ushtrisë dolën një sërë detyrash, që kërkonin staf të madh e cilësor për t'i zgjidhur. Në vitin 1965 Dega e Tankeve u bë komandë e tankeve dhe mjeteve të blinduara me komandant Abas Fejzo. Ai nuk ishte tankist, por me specialitetin e tankeve bëri shumë për armën që drejtonte. Kur drejtoi Brigadën e Parë të Tankeve në Zall Herr të Tiranës nga viti 1960 e bëri model në ushtri për jetesën dhe stërvitjen. Ndërsa vetë mori dhe patentën për guidimin e tankut e të transportuesit të blinduar. Me punën dhe autoritetin e tij, Abaz Fejzo e ngriti Armën e Tankeve në majat më të larta në historinë e saj. Kjo periudhë koïncidoi edhe me krijimin e një varg Br.T e bt. në të gjithë Shqipërinë. Për të përballuar një mori detyrash në vijimësi, Abaz Fejzo krijoi një staf me kuadro me integritet, me moral e nivel të lartë profesional, përgatitje e eksperiencë të gjatë në punë si Loni Kriston në degën operative, Astrit Çobani në teknikë, etj.

Për komandën e tankeve dhe mjeteve të blinduara detyrat më parësore ishin: caktimi i rajoneve të përqendrimit (dislokimi, vendvendosja) të njërive dhe reparteve të formuara e në formim e sipër. Formulimin e detyrave luftarake të Br.T dhe bt. në të gjithë territorin e republikës, në përputhje me planin strategjik të

mbrojtjes së vendit sipas kritereve të AUP për përdorimin e tankeve në llojet e luftimit. Grupi i punës i formuar për këtë qëllim punoi me përkushtim me dhe pa orar. Saktësuan dhe eksperimentuan me tanke në terren me detaje çdo element të detyrave luftarake të njësisë e reparteve në çdo lloj përdorimi e luftimi të tankeve të përcaktuara në AUP. Punohej në zyrën e punës për hedhjen në hartë të varianteve të detyrave të çdo njësie e reparteve tankiste në të gjithë vendin. Kur një nga pjesëtarët e grupit të punës të drejtorisë operative të Shtabit të Përgjithshëm, gjendet në zyrën e hartave të tankeve dhe midis të tjerave iu thotë se: “Kjo shigjeta që ju keni hedhur në hartë duhet këtu dhe jo aty ku e keni hedhur ju”. Në këtë kohë Abaz Fejzo e dëgjon këtë ndërhyrje të përfaqësuesit të drejtorisë operative dhe i thotë: “Jemi ne që vendosim për përdorimin taktik të tankeve se jemi specialistë të tyre dhe jo ju”. Më pas komandanti i Tankeve dhe Mjeteve të Blinduara Abaz Fejzo ia tregoi ndodhinë Petrit Dumes, i cili e vlerësoi mendimin e komandantit. Këtë ndodhi e mësuan tankistët dhe vlerësuan komandantin për mbrojtjen e merituar të Armës së Tankeve. Sa kohë në detyrë ishte Abaz Fejzo komandant i Tankeve dhe Mjeteve të Blinduara, arma e tankeve ishte në rolin që i takonte, sepse ishte forcë goditëse kryesore e forcave tokësore.

### Arma e tankeve hap kurs në Akademi

Më pas u bënë ndryshime të jashtëzakonshme. Më 1 shtator 1971 në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm u hap për herë të parë në historinë e armës së tankeve kursi për tanke. Myfit Metani në moshën 27 vjeç kishte një gëzim, sepse ishte akademisti i parë i këtij kursi. Në këtë kurs akademistët tankistë u aftësuan në mënyrë profesionale nga pedagogët e talentuar tankistë si Loni Kristo, Dino Brati, Koli Koçollari etj., në taktikën e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit, në mësimje, mbrojtje, në luftimin kundër desantit ajror, në marshim me parashikim luftimi ndeshës, etj. Ndërsa nga tekniku tankist më kompetenti në zanat Dhimitër Mitrushi, mësuan për herë të parë taktikën e sigurimit teknik të njësisë dhe reparteve tankiste. Ky kurs profesional u dha mundësi kuadrove tankistë të argumentonin më me kompetencë e ta konkretizonin më së miri në terren me efektivin, artin e përdorimit taktik të tankeve në llojet e luftimit. Kursi i radhiti në njohuri të AUP me këmbësorët, artiljerët, xhenierët etj., duke rritur autoritetin e kuadrove të tankeve. Tankistët në këtë proces vendosnin vetë për taktikën e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit dhe evitonin me kompetencë çdo ndërhyrje të specialiteteve të tjerë.

Me mbarimin e kursit për tanke në akademi, Myfit Metani

emërohet shef i Shtabit në Br.T në Korçë. Të parën detyrë që bëri ishte kontrolli i planeve të luftës për përdorimin e BrT në llojet e luftimit. U çudit dhe u habit, për përdorimin e Br.T në mësimje në drejtimin të Qafë e Qarrit - Ersekë. Ishte planëzuar të përdorej në krahun e majtë të rrugës automobilistike Qafë e Qarrit - Ersekë, drejtim ku nuk kalon dhe dhia. Ai planëzim ishte bërë nga dega operative e shtabit të DK të Korçës para hapjes së kursit për tanket në Akademi, duke ia dhënë shtabit të Br.T për ta zbatuar. Ndaj dhe e filloi punën për përdorimin e Br.T në luftim, sepse kishte mbaruar akademinë për artin e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit. Për këtë mangësi vuri në dijen shefin e Shtabit të divizionit Izet Murati. Ai e dëgjoji me vëmendje dhe i vuri detyrë të korigjonte jo vetëm këtë mangësi, por të shikonte të gjithë planin luftarak të Br.T dhe të bënte korigjimet e nevojshme. Pas ribëri planin luftarak të Br.T e miratoi në shtabin e DK dhe menjëherë saktësoi detyrat për shtabin e Br.T, komandat e shtabet e reparteve e nënrepartet dhe të efektivit. Ky saktësim i planit luftarak u rishikua, u riparua dhe u reflektua në të gjitha njësitë e repartet tankiste.

### Organika e tankeve dhe mjeteve të blinduara

Autoriteti i Armës së Tankeve, në vitet 1965-1974, u ngrit në majat më të larta. Ajo u kthye nga degë në komandë të tankeve dhe mjeteve të blinduara me komandant Abaz



Fejzo. Gjatë kësaj kohe u krijua një varg Br.T dhe bt. në qytetet më kryesore të vendit. Organika e Br.T fillimisht përbëhej nga tri batalione tankesh me nga 31 tanke secili dhe një tank i komandantit të brigadës. Shuma e përgjithshme 94 tanke. Në të pastajmen organika e Br.T përbëhej nga tri batalione tankesh me nga 22 tanke secili dhe një tank i komandantit të Br.T. Shuma e përgjithshme ishte 67 tanke. Zvogëlimi i sasisë së numrit të tankeve





në Br.T ndodhi se kompanitë e tankeve në batalionet e tankeve me organikë u bënë me nga dy toga tankesh me nga 3 tanke secila dhe një tank i komandantit të kompanisë (gjithsej 7 tanke). Me detyrat që kryente në kuadër të mbrojtjes së përgjithshme të vendit, sipas Artit Ushtarak, Arma e Tankeve ishte forca kryesore goditëse e trupave tokësore. Më 1 shtator 1971, u hap kursi për tanke në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë. Hapja e kursit për tanke, programi që përvetësohej nga kuadrot tankistë, e rriti nivelin me atë të këmbësorëve, artiljerëve tokësorë e kundërajrorë, xhenierëve etj., që e kryenin kohë më parë kursin për armët e tyre. Kuadrot tankistë pas shkollimit i përcaktounin vetë detyrat për njësitë, repartet e nënrepartet e tyre. Me aftësitë e autoritetin e tij, Abaz Fejzo e çoi Armën e Tankeve nga suksesi në sukses.

Në mesin e vitit 1974, Komanda e Tankeve dhe Mjeteve të Blinduara u kthye në drejtori të tankeve. Në vijimësi si në të gjithë ushtrinë u bënë shumë ndryshime. Në vitin 1975 u mbyll kursi i tankeve në Akademi, nga propozimi i drejtuesit tankist. Vendimi i Këshillit të mbrojtjes përfshinte vazhdimin e kursit për tanke në Akademi. Në këtë kohë ishte i pranishëm mendimi i momentit se midis taktikës së tankeve e taktikës së këmbësorisë nuk ka dallime thelbësore, por disa veçori të parëndësishme që nuk pengojnë zhvillimin e përbashkët të kursit në Akademi. Numri i kursit për tankistë nuk ishte plotësuar në sasinë e nevojshme të grupit mësimor, për të evituar këtë, drejtuesit tankistë pranuan në heshtje që akademistët tankistë të shpërndareshin në grupet e këmbësorisë e të përgatiteshin me atë program

që mësonin këmbësorët. Për njohuritë për taktikën e tankeve edhe akademistët tankistë bënë atë sasi orësh që bënë dhe akademistët këmbësorë. Ky veprim bëri përfundimisht fakt të kryer heqjen e kursit për tanke në Akademi. Në vendimin e Këshillit të Mbrojtjes për armët e shërbimet e tjera, Ministria e Mbrojtjes lejohej t'i hapte vetë kurset për to kur e kishte të nevojshme. Ndërsa për kursin për tanke duhej të mblidhej Këshilli i Mbrojtjes e të vendoste hapjen e tij se tankistët e mbyllën vet atë. Ai kurs nuk u hap asnjëherë sa ekzistoi Arma e Tankeve.

Dega e Tankeve, e krijuar në vitin 1974, kishte drejtor Aleko Kokën. Më pas u emërua Lili Bullari. Në vijimësi drejtor i Tankeve u emërua Refat Gjyzele e në fund të viteve 1990, Kujtim Nasupi. Pas vitit 1974 u vazhduan arritjet për përmirësimin cilësor të kushteve për jetesë e stërvitje. Zëvendësimi i shoferëve ushtarë me nënoficerë profesionistë me pagesë për guidimin e tankeve, transportuesve të blinduar ndikoi së tepërmi për zhvillimin më cilësor të stërvitjes. U ndërtuan ambiente e poligone më cilësore, ambiente të shumëllojshme për aktivitete sportive e argëtimi pas stërvitjes etj. Vendimtare për arritje ishte ndihma financiare e shtetit. Krahas arritjeve u vërejtën dhe disa mangësi që ndikuan në zvogëlimin gradual të rolit të armës së tankeve si forca kryesore goditëse e forcave tokësore e përcaktuar në AUP. Meqë tanket varehin nga drejtuesit këmbësorë, kjo nuk do të thoshte që ata të na diktonin në taktikën e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit, në probleme që ndikonin në uljen e gatishmërisë së Armës së Tankeve etj. Vetë ne u dhamë mundësinë për heqjen e kursit për tanke në Akademi.

# ASNI, 92 vite shërbim 'inteligjent' i Forcave të Armatosura

**K**rijimi i Shërbimit apo Armës së Ndërlidhjes vite më parë përbën një moment të rëndësishëm në një nga shërbimet me rëndësi të veçantë në funksionimin, por në radhë të parë për komandimin e strukturave ushtarake të Forcave tona të Armatosura.

Zanafilla e krijimit të kësaj agjencie daton, më 30 qershor 1931, me krijimin e dy kompanive të ndërlidhjes dhe një kompani telegrafiste. Pas gjithë këtyre viteve shërbim ndërlidhje, sot ASNI është në gjendje të sigurojë dhe të mbështesë me sisteme komunikimi dhe informacioni për realizimin e komandim-kontrollit të FA-së në nivel strategjik dhe operacional në të gjitha kohërat si dhe të shkëmbejë informacion me NATO-n, të trajtojë dhe të stërvitë personelin e shërbimit të ndërlidhjes në FA.

Ky shërbim ndër vite ka pësuar ndryshime të njëpasnjëshme, duke pasur dhe vëmendjen e liderëve politik dhe ushtarakë të Forcave të Armatosura. Sot njihet ASNI, e cila planifikon, zhvillon, instalon dhe siguron pajisjet e sistemet kompjuterike dhe të komunikimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ajo siguron përputhshmëri me sistemet e automatizuara të komandimit, kontrollit, komunikimeve dhe ato kompjuterike të NATO-s.

ASNI menaxhon dhe garanton sigurinë e sistemeve të automatizuara të informacionit të FARSH-së. Trajnon personelin e nevojshëm që kërkohet për të përdorur dhe mirëmbajtur sistemet e automatizuara dhe të ndërlidhjes të FARSH-së.

Kjo agjenci është një arterie dhe komponent shumë i rëndësishëm dhe i pa zëvendësueshëm i gjithë përpjekjes që FA-të bëjnë për të mbajtur me nder edhe me dinjitet pozicionin që u takon si pjesë e NATO-s.

Sot kjo strukturë numëron 92 vite aktivitet me sfida dhe arritje. Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare përcaktohet se: "Shqipëria renditet ndër vendet ku zhvillimi i telekomunikacionit, qasja në internet dhe

informatizimi i shoqërisë përparon shumë shpejt. Rritja e komunikimit përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, por në të njëjtën kohë, ajo e ekspozon atë ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike me aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë.

Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në institucionet publike, të telekomunikacionit dhe sistemin financiar e bankar, duke shkaktuar edhe ndërprerje të shërbimeve jetike. Asetet dixhitale në rritje janë pjesë integrale e operacioneve ushtarake, ndërkohë, rritja e varësisë së punës nga asetet dixhitale, krijon kërcënime të mjedisit të sigurisë kibernetike.

Me Siguri Kibernetike do të kuptojmë: kushtet në të cilat hapësira kibernetike është e mbrojtur në lidhje me ngjarjet aksidentale ose me vetëdëshje të cilat konsistojnë në marrjen dhe transferimin e të dhënave, në modifikimin e tyre, shkatërrimin ose bllokimin e paligjshëm të sistemeve të komunikimit e të informacionit, për shkak të masave të papërshtatshme të sigurisë.

Fusha dixhitale e hapësirës kibernetike është fusha e pestë e operacioneve ushtarake në botë, së bashku me ajrin, detin, tokën dhe hapësirën.

Teknologjia e komunikimit dhe e informacionit i mundëson Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura (MM/FA) efikasitetin në Komandim - Kontroll, mbështetje logjistike dhe shërbime të tjera të cilat janë të mbështetura në sistemet e komunikimit dhe informacionit.

Kjo strategji e promovuar nga MM synon: mbajtjen e një mjedisi operimi elektronik të sigurtë, të qëndrueshëm dhe të besueshëm, i cili mbështet sigurinë në strukturat e MM/FA dhe rrit përfitimet e mjedisit dixhital për to; vendosjen e standardeve për përdorimin e sigurt të hapësirës kibernetike; inkurajimin për një zbatim gjithëpërfshirës; garantimin e sigurisë dhe progresit për strukturat dhe sistemet e ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të MM.

Strategjia e Sigurisë Kibernetike përshkruan sfidat aktuale në çështje të sigurisë të sistemeve të ndërlidhjes



dhe informacionit (SNI) dhe pikat kryesore me qëllim për të përballuar këto sfida. Një sërë faktorësh si shpejtësia e zhvillimeve teknologjike, dinamika dhe kompleksiteti i shfrytëzimit të hapësirës kibernetike, e vendosin Ministrinë e Mbrojtjes dhe FA përpara sfidave reale për ngritjen e kapaciteteve për mbrojtjen kibernetike, të shoqëruar me politika, udhëzime, procedura koordinuese e monitoruese. Për rrjedhojë, Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike do të rishikohet në përshtatje me këto ndryshime.

Qëllimi kryesor i saj është të sigurojë orientime, koherencë dhe fokus, për një qasje gjithëpërfshirëse, për të zhvilluar kapacitetet ushtarake në hapësirën kibernetike në tre vitet e ardhshme. Ministria e Mbrojtjes përcakton sigurinë kibernetike nëpërmjet masave në lidhje me konfidencialitetin, disponibilitetin dhe integritetin e informacionit që trajtohet, përpunohet, ruhet, transmetohet dhe komunikohet me mjetet elektronike. Vendosja dhe zbatimi i këtij prioriteti për MM/FA, përcakton nevojën në: Menaxhimin e riskut të hapësirës kibernetike përmes përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen e nivelit të trajnimit, sigurimin e informacionit, informimit më të konsoliduar për situatën dhe duke krijuar mjedis të sigurt dhe sisteme të qëndrueshme; Garantimin e integritetit dhe disponibilitetit të sistemeve nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbrojtjes kolektive, duke mbajtur pamje operationale të përbashkët; Garantimin e kapaciteteve të integruara, duke bashkëpunuar ngushtë me Komandat e FA-së, Shërbimet

dhe Agjencitë për vendosjen e kapaciteteve të reja atje ku ato nevojiten më shumë.

Strukturat përkatëse të sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të MM/FA punojnë në mënyrë aktive për të siguruar infrastrukturë të sigurt për këto sisteme, nëpërmjet organizimit, alokimit të burimeve të duhura, kushteve të përgjithshme të mira dhe masa efektive.

Këto struktura integrojnë sigurinë dhe forcat në infrastrukturën e informacionit për të mbrojtur veprimtarinë e MM-së dhe FA-së si dhe të gjithë përdoruesit e këtyre sistemeve. Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike do të ketë përputhshmëri me kërkesat që shtrohen vazhdimisht në këtë fushë dhe do të respektojë të gjitha parimet e parashikuara në konventat, marrëveshjet ndërkombëtare, iniciativat që do të ndërmerren, me synimin që të mbrojë dhe parandalojë ndërhyrjen ose dëmet në Sistemet e Ndërlidhjes dhe Informacionit (SNI).

Kjo Strategji do të fokusohet në: • Masa për të adresuar kërcënimet që drejtohen ndaj sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të MM dhe FA. • Masa ndërgjegjësuere për krimin kibernetik. • Masa për të ndërtuar besimin dhe sigurinë në përdorimin e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të MM dhe FA. • Zhvillimi, rishikimi dhe rifreskimi i politikave, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave ekzistuese për të siguruar përputhshmëri me kërkesat aktuale.

# Krijimi i bazës së Kuçovës, aseti i Forcave të Armatosura në rrugën e shndërrimit të saj në bazë të NATO-s

**R**eparti Ushtarak 3362 Kuçovë mbante emrin Reparti "23 Peza". Ai u krijua si formacion i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Bërthama e parë e këtij regjimenti u krijua me vendim të posaçëm, ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik për teknikën e re reaktive me të cilën do të pajisej reparti. Krahas këtyre u morën masa për përgatitjen e ambienteve për pritjen e efektivit dhe teknikës.

Pas përfundimit të përgatitjes së efektivit pilot e inxhinieroteknik, Regjimenti mori formën e plotë, i gatshëm për kryerjen e detyrave.

## 15 maj 1955 është dita e krijimit të regjimentit

Me vendim të posaçëm të Kuvendit Popullor Nr.81 datë 06.11.1956, Regjimentit i dorëzohet Flamuri Luftarak me mbishkrimin "Regjimentit 23 të Aviacionit Gjuajtës PEZA".

Në janar të vitit 1956, në regjiment filloi përgatitja luftarake e organizuar mbi bazën e një planëzimi të rregullt. Në maj të këtij viti me urdhër të ministrit të Mbrojtjes u krijua nënreparti i ofiçinës së mirëmbajtjes së aviacionit me komandant Daut Gurabardhi, ndërkohë që një pjesë e pilotëve shkuan për studime për helikopterë.

Në korrik të vitit 1957, në këtë aerodrom u ul për herë të



parë avioni bombardues Il-28, i cili hyri në armatimin e Aviacionit tonë Luftarak. Në dhjetor në Kuçovë ulet një avion transporti anglez "Skymaster". Me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor për kryerjen me sukses të kësaj detyre u dekoruan pilotët Kosta Dede e Mahmut Hysa, si dhe aviodrejtuksi Shyqyri Balla.

Në muajin shtator 1959, regjimenti mori pjesë në stërvitjen me trupat e armatës në rajonin e Ersekës. Dhe në muajin nëntor regjimenti mori pjesë në paradën ushtarake me rastin e 15-vjetorit të çlirimit të atdheut.

Në muajin prill të vitit 1961, për herë të parë filloi eksperi-





Në vitin 1995 krijohet Baza e Mbrojtjes Ajrore Kuçovë, Reparti Ushtarak 4030 (ish-1875). Viti 1999, është viti i kthimit në normalitet, ndërsa në vitin 2001, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore, ky repart kalon në “Akademia e Forcave Ajrore”, duke pasur në vartësi dhe Fakultetin Teoriko-Mësimor Vlorë. Në vitin 2003 vazhduan punimet nga pala turke në aerodromin e Kuçovës, të cilat përfunduan në kohë sipas planit.

Në vitet në vazhdim si detyrë kryesore ka qenë modernizimi i infrastrukturës

për plotësimin e standardeve dhe kushteve të aerodromit të Kuçovës si “Host Nation Support”.

Disa prej drejtuesve në vite të Bazës së Kuçovës ishin: Niko Hoxha, Fahri Bubësi, Bardhyl Taçi, Harilla Rebi, Agim Balili, kolonel Fatmir Meçe, nënkolonel Agim Matraku, Gëzim Ismaili, Andon Todri, Tomorr Dyrmo, Flamur Hoxha, Syrja Gjoka.

Tashmë, NATO po investon për modernizimit e bazës ajrore të Kuçovës. Ky investim strategjik i NATO-s në Shqipëri do të sjellë një standard të ri për Forcat e Armatosura dhe do të shërbejë si bazë mbështetëse për NATO-n, duke ofruar transport ajror, mbështetje logjistike, policimin ajror si dhe trajnime dhe stërvitje.

Kuçova do të shërbejë njëkohësisht edhe si bazë kombëtare për Forcën Ajrore Shqiptare dhe ky Investim strategjik i NATO-s në Shqipëri, do të sjellë një standard të ri për Forcat tona të Armatosura. Padyshim, një investim i këtyre përmasave krijon mundësi të reja për zhvillimin ekonomik e social të të gjithë rajonit, ku planifikohet ndërtimi i kësaj baze të re ajrore të teknologjisë së fundit.

mentimi i karburantit të markës shqiptare, i prodhuar nga punonjësit e laboratorit të naftës, me në krye inxhinierin Stefan Kagjini. Komandanti i Regjimentit, piloti Niko Hoxha me avionin 332 bëri provën e parë në ajër.

Në vitin 1964, në vartësi të regjimentit u krijuan dy reparte të reja, Batalioni i Shërbimit të Aerodromit dhe Grupi i Radio-Dritës.

Në vitin 1965 krijohet skuadrilja e tretë reaktivo-mësimore për përgatitjen e pilotëve, teknikëve të rinj, me komandant pilotin Sali Dibra.

Në fillim të vitit 1966 filluan punimet për ndërtimin e Uzinës së Riparimit të Avionëve, ndërsa në muajin prill repart pajiset me një skuadrilje “MIG-17”.

Në gusht të vitit 1975 eksperimentohet për herë të parë qitje natën me raketa, ndërsa në vitin 1977 për herë të parë eksperimentohet bombardimi nga fluturimi horizontal në lartësi të vogël.

Në vitin 1979, në detyrën e komandantit të regjimentit emërohet Harilla Rebi dhe në atë të komisarit, Viktor Vangjeli. Po këtë vit u vu në gatishmëri për drejtimin luftarak të regjimentit Vendkomanda e Kohës së Luftës.

Në paradën ajrore me rastin e 35-vjetorit të çlirimit të Atdheut, repart mori pjesë me 9 avionë.

Në mars të vitit 1981, me ndihmën e efektivit pilot e teknik të repartit, Kinostudio “Shqipëria e re” xhroi film-in artistik “Gjurmë në kaltërsi”, kush-tuar armës së Aviacionit, ku ndihmë konkrete dhanë pilotët Harilla Rebi, Viktor Vangjeli, Agim Balili, Gjergji Spaho, etj., duke kryer një sasi të madhe fluturimesh në funksion të filmit, si dhe duke organizuar e ndihmuar edhe në punët e tjera. Në vitin 1984, repart emërohet “Regjimenti 23 i Aviacionit Gjuajtës Bombardues”, ndërsa në vitin 1985 dekorohet me urdhrin “Për shërbime të shquara në fushën e mbrojtjes”.



# Mbrojtja Kundërajrore, “sytë tanë në qiell”

**Q**ë kur u realizua fluturimi i parë i një avioni me motor në botë, nisën edhe përpjekjet për të konstruktuar armë për kundërveprim ndaj këtij mjeti të ri luftarak. Procesi i zhvillimit të armatimit e teknikës së Mbrojtjes Kundërajrore ishte i njëkohshëm me atë të Aviacionit. Në vitin 1914 topat e artilerisë kundërajrore të prodhimit më të hershëm fillimisht u vendosën në platformat e mjeteve lundruese detare më pas në vijën bregdetare dhe në pozicione zjarri fushore në vijë të drejtë në zonën e luftimeve gjatë Luftës së Parë Botërore.

Avioni i parë armik mbi tokën shqiptare u rrëzua më 23 korrik 1920. Në luftën e Vlorës në betejat e ashpra të 23 korrikut 1920, luftëtarët shqiptarë rrëzuan një avion që fluturonte ulët dhe mitralonte pozicionet e tyre. Abduraman Çiraku (mbështetës i Ismail Qemalit) ka dëshmuar se me sulmin e parë në Kotë, forcat italiane u shpartalluan. "Atje zumë rob mbi 1300 vetë. Veç materialit tjetër ushtarak, shumë edhe 3 topa. Topat na duheshin për luftimet e mëvonshme, prandaj çeta më ngarkoi mua t'i marr në dorëzim. Bëra gati 2 topa, njërin ia dhamë çetës të Tepelenës, tjetrin e mbajta vetë e vendosa mbi Kaninë në Majë të Çuçiës tek Qafa e Pllakës. Me predhat e topave që iu kapëm armikut, fundosëm katër luftanije dhe rrëzuam një aeroplan bombardues që ranë në fushën Peshkëpisë", - thotë Avni Skënderaj, ish-oficer i Mbrojtjes Kundërajrore.

Më 1 shtator 1928, në Tiranë u prezantuan topat e dërguar nga Italia, Musolini, për Mbretin Zog. "Në pallatin mbretëror gjëmuan topat e sjellë nga italianët të zbrazur nga ushtarët shqiptarë të veshur me uniform italiane", kujton ish-ushtaraku Skënderaj. "Ushtria, financat, doganat, banka kombëtare, xhandarmëria, drejtoheshin nga italianët".

Tre bateritë e para me dekret të Mbretit, më 1 korrik 1931, u përhapën në pozicione zjarri në vijën bregdetare, një bateri në Shëngjin, një në Durrës dhe një bateri në Sarandë.

Pikërisht dekreti i datës 1 korrik 1931, për përhapje në pozicione zjarri të këtyre baterive ishte edhe dokumenti



ku u mbështet udhëheqja politike, shtetërore, ushtarake e Shqipërisë në vitin 1995, për rishikimin e datave zyrtare të krijimit të llojeve të armëve të ushtrisë shqiptare të reformuar në post diktaturë. Pra 1 korriku 1931 është data zyrtare e krijimit të Mbrojtjes Kundërajrore të shtetit shqiptar, por për studiuesit mbetet ende për të hulumtuar se si ka funksionuar Mbrojtja Kundërajrore në vitet e Mbretërisë.

Pas Luftës NAÇI, ushtria gjermane la në territorin shqiptar disa topa 20 mm e 25mm. Ky armatim trofe u grumbullua u riparua dhe u vendos në pozicione zjarri që në vitin 1945. Dhe në tetor 1945 u dërguan në Bashkimin Sovjetik 12 studentë për të përgatitur oficerët e parë. Gradualisht u rrit numri i ushtarakëve të AKA, raketave, Radiolokacionit të përgatitur pas vitit 1961 vetëm në shkollat ushtarake dhe akademinë ushtarake shqiptare. U rrit sasia e armëve e teknikës luftarake dhe u organizua sistemi MKA sipas kërkesave të kohës.

Në vitin 1990, Shqipëria kishte 24 regjimente të MKA-së,

4 grupe raketash kundërajrore 72 radarë të zbulimit të largët ajror, 102 grupe AKA, 18 batalione mit KA, 380 bateri AKA, 210 kompani mit KA14.5 mm, 570 toga mit KA 12,7 të përhapura në 1380 pozicione zjarri e vrojtimi. Gjithçka ishte për mbrojtjen e hapësirës ajrore të vendit në bashkëpunim të ngushtë me Aviacionin luftarak, Flotën luftarake detare, Forcat tokësore dhe Forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore.

Brezi i parë i ushtarakëve të MKA-së i përket viteve 1945-1970, brezi i dytë viteve 1970-1995 dhe brezi i mëvonshëm ai i pas viteve 1995 e më tej. Gjenerata e parë e ushtarakëve, ka meritën historike të ngritjes nga themelet të MKA-së, rritjes në sasi e cilësi në kushtet kur vendi ishte anëtar i Traktatit të Varshavës. Gjenerata e dytë përjetoi vështirësitë e shërbimit në kushtet e Luftës së Ftohtë dhe izolimit të vendit. Gjenerata e tretë përjetoi reformat e thella pas ndryshimeve politike të vitit 1990. Në rrethanat e reja krejt të ndryshme nga ato më



parë, ushtarakët e MKA-së kryen misionin në kushtet e anëtarësimi të vendit në Aleancën Euroatlantike, NATO.

### **Mbrojtja Kundërajrore dhe Aviacioni, transformimi**

Sipas dokumenteve arkivore, përpjekjet për krijimin e Armës së Aviacionit janë të hershme. Qeveritë e para Luftës së Dytë Botërore, me gjithë përpjekjet, nuk arritën ta realizojnë një gjë të tillë, kryesisht për arsye ekonomike, thonë dokumentet. Mbrojtja Kundërajrore dhe Aviacioni janë “takuar e ndarë” disa herë nga forma organizative, por bashkëpunimi i tyre ka qenë gjithnjë i pashkëputur. Në fillimet e saj, arma e Aviacionit ka qenë pjesë e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore, gjë që ka vazhduar deri në vitin 1974 për t'u bashkuar përsëri në Forcat e Mbrojtjes Ajrore në vitin 1995. Komandanti i parë i Aviacionit ka qenë Edip Ohri, i cili e ka komanduar atë deri në vitin 1974, për të vazhduar më tej me komandantët e tjerë të

Aviacionit ndër vite.

Mbrojtja Kundërajrore, Aviacioni Luftarak dhe repartet e Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore pavarësisht nga format organizative të ndryshme në vite kanë qenë gjithnjë të lidhura e në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, por edhe me lidhje varësie e strukturore të ndryshme me njëra-tjetrën në vite.

Mbrojtja Kundërajrore e vendit ka si ditë të themelimit të saj 1 korrikun e vitit 1931, datë në të cilën doli akti ligjor “Mbi organizmin e Ushtrisë Kombëtare” dhe u sanksionua vendosja e tri baterive të para kundërajrore në vendin tonë në portet e Shëngjinit, Durrësit e Sarandës. Mbrojtja Kundërajrore pati një zhvillim të madh për kohën në vitet 60-70. Në vitet 1954-1955 ajo u pajis me bateri KA-85mm e mjete radioteknike më të sofistikuara, ndërsa në vitet 1957-1958 u pajis me bateri 57 dhe 100mm. Në vitet 1959-1969, në armatim futen edhe raketat e drejtuara, topat AKA-37mm, topat 57mm dhe 100mm me drejtim automatik, mitralozat 14,5mm me katër tyta, dhe me radarë të zbulimit të largët, të mesëm, të afërt. Regjimenti i Raketave të Drejtuara Kundërajrore, që konsiderohej si krenaria e kësaj arme është krijuar më 6 dhjetor të vitit 1968. Në vitet '70 kishte 22 regjimente të AKA-së, 18 batalione mitraljerë AKA, që llogarisnin rreth 6 gryka zjarri për çdo kilometër të frontit.

Kurse Forcat Ajrore si strukturë u krijuan në vitin 2000 sipas strukturës organizative të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të parashikuara nga Kushtetuta, ku në Forcat Ajrore bënë pjesë, Regjimenti i Helikopterëve, Brigada Ajrore, Detashmenti Ajror, Bazat Ajrore Mbështetëse, Batalioni i Vëzhgimit Ajror, Batalioni Logjistik, Qendra e Shërbimit Meteorologjik, Qendra e Riparimit të Avionëve, Shkolla e Trupës e Forcave Ajrore dhe nënreparte ndihmëse. Të gjitha këto reparte në vite e kohë të ndryshme kanë qenë pjesë e Mbrojtjes Kundërajrore dhe të Aviacionit Luftarak.

Me ndryshimet dhe implementimin në strukturën e re në vitin 2007 edhe në Forcat Ajrore u bënë ndryshime me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe arritjen e standardeve të kërkuara për anëtarësimin në NATO. Me ndryshimet e ndodhura në strukturë në vitin 2007 deri në fund të vitit 2009. Forcat Ajrore u ristrukturuan në nivel Brigadë Ajrore dhe repartet e saj ishin: Regjimenti i Helikopterëve Farkë, Batalioni i Mbrojtjes Ajrore Marikaj, Shërbimi Meteorologjik, Baza Ajrore Rinas, Baza Ajrore Kuçovë, ndërsa Shkolla e Trupës së Forcave Ajrore kaloi në varësi të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Me ndryshimet e bëra në TOP, në fillim vitin 2010 Forcat Ajrore u ristrukturuan sërish në nivel Force Ajrore. Me ristrukturimin e ri Regjimenti i Helikopterëve kaloi në Bazën Ajrore. Baza Ajrore Rinas kaloi në Detashment VIP, QOSA (Qendra Operacionale e Sovranitetit Ajror) në QKR (Qendra e Kontroll Raportimit), Detashmenti Provizor Marikaj dislokohehet në Rinas dhe emërtohet Qendra e Vëzhgimit Ajror.



# QPR, “struktura port ku hyn gjaku i ri” në FA

**R**eformimi i Forcave të Armatosura në kuadër të anëtarësimit në NATO dhe standardizimi i tyre strukturor çoi në krijimin e një strukture të re personeli, Qendrën e Personel Rekrutimit, e cila do të kishte si mision rekrutimin e ushtarëve aktivë dhe administrimin e dosjeve të personelit ushtarak të Forcave të Armatosura. Në vijimësi, misioni dhe detyrat e Qendrës së Personel Rekrutimit kanë evoluar në funksion të strukturës dhe ndryshimeve ligjore të ndodhura në FA.

Misioni i kësaj qendre është rekrutimi i kandidatëve për oficerë e ushtarë/detarë aktivë, promovimi dhe informimi i publikut, përpunimi dhe administrimi i dokumentacionit dhe i të dhënave të personelit të ushtarakëve aktivë dhe atij në rezervë/lirim, realizimi i trajtimit financiar të ushtarakëve në rezervë/lirim si dhe vënia në efikasitet dhe burimeve njerëzore

dhe materiale në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Qendra e Personel Rekrutimit e filloi veprimtarinë e saj, më 22 qershor të vitit 2007, si një domosdoshmëri e zhvillimit të Forcave të Armatosura, me një mision mjaft domethënës siç është ai i menaxhimit të ciklit jetësor të burimeve njerëzore të FA-së. Sot, mund të thuhet se QPR zhvillon një proces rekrutimi, i cili garanton që Forcat e Armatosura shqiptare të kenë në gjirin e tyre një brez të ri, që është në gjendje të kryejë më së miri të gjitha detyrat në përmbushje të misionit kushtetues brenda vendit, ashtu dhe detyrimet në shërbim të paqes kudo në botë, në kuadër të Aleancës dhe strukturave të tjera ndërkombëtare. Kjo qendër, nëpërmjet programit të automatizimit të të dhënave të personelit aktiv, bën të mundur administrimin e tyre në sistem me mjaft kujdes e transparencë, përkushtim e profesionalizëm, gjë e



cila është baza e ecurisë në karrierë të personelit të FA-së. Administrimi i të gjitha dosjeve të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe i të dhënave të kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak në QPR të të gjithë shtetasve meshkuj në vend, ka rritur më tej rëndësinë dhe përgjegjësinë e saj. Por QPR bashkëpunon gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Qarqe, Postën Shqiptare në të gjithë vendin, pushtetin qendror dhe vendor si dhe të gjitha institucionet e tjera brenda dhe jashtë FA-së, me qëllimin e vetëm për të garantuar një shërbim sa më cilësor për ish-ushtarakët si dhe atyre që ia kushtuan karrierën FA-së. Personeli i QPR-së i shërben në kohë reale kësaj kategorie ushtarakësh pa vonesë, me cilësi, profesionalizëm dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie, duke bërë të gjitha përpjekjet që procedurat burokratike të lehtësohen në maksimum në interes të tyre. Në këto 16 vjet, misioni dhe detyrat themelore të QPR-së kanë ardhur duke u zgjeruar dhe konsoliduar. Numri i personelit të qendrës është dyfishuar dhe ajo tani shtrihet në gjithë hartën e Shqipërisë. Në të 12 qarqet e vendit u ngritën seksionet e rekrutim-mobilizimit, të cilat jo vetëm përmirësojnë procesin e rekrutimit të brezit të ri si kontingjent i FA-së, por më e rëndësishmja, ato janë themeli dhe baza e krijimit dhe zhvillimit të komponentit të rezervës, e cila tashmë është një sfidë jo vetëm për QPR, por për vetë Forcat tona të Armatosura.

Duke shkruar për këtë strukturë kaq të rëndësishme, që nga krijimi e deri më sot s'mund të lëmë pa përmendur personelin e QPR-së dhe drejtuesit e saj ushtarak ndër vite, që me punën e tyre kanë bërë të mundur përmbushjen më së miri të detyrave dhe misionit të kësaj qendre. Punonjës ushtarakë dhe civilë janë në një bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA-së. Kanë qenë pikërisht këto dy shtylla të rëndësishme institucionale që me përkujdesjen e vazhdueshme të tyre, kanë mbështetur vazhdimisht gjithë veprimtarinë e QPR-së, madje ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, shpesh e ka bërë pjesë të axhendës së tij në takime të ndryshme promovuese aspektin për rekrutët e rinj në qarqe e rrethe si dhe në aktivitete të tjera të qendrës.

### **QPR, domosdoshmëri e menaxhimit të ciklit jetësor të Burimeve Njerëzore të FA-së**

Qendra e Personel Rekrutimit është një strukturë me shumë rëndësi në fushën e administratës shtetërore. Ajo u krijua si domosdoshmëri e disa faktorëve teknikë dhe politikë nëpër të cilët po kalonte vendi. “Para vitit 2007, rekrutimi ishte bërë problematik në ushtrinë dhe vendin tonë. Degët ushtarake ose qendrat e rekrutimit kishin shumë vështirësi në misionin e tyre dhe në atë kohë mernim me polici ushtarak për të ruajtur repartet ushtarake. Kjo mënyrë krijoi probleme në vijimësi”, shprehen ish drejtuesit e QPR-së.

Nga ana tjetër, evidenca ushtarake pësoi një vakum për faktin se një pjesë e madhe i shmangeshin shërbimit ushtarak dhe një pjesë kishin ikur refugjatë dhe ishte e pamundur të vijohet ende me atë ligj. U shtrua problemi i menaxhimit të të dhënave të personelit, i cili kishte krijuar informacione të një abuzimi të mundshëm dhe mos administrimi të saktë në atë kohë. Në këto kushte, MM dhe SHP bëri një administrim të ligjit ekzistues të shërbimit ushtarak dhe gradualisht filloi të ndërtonte një ligj të ri të ushtarit profesionist.

Në vitin 2007, në prag të hyrjes në NATO, ushtria jonë ishte 100% profesioniste. “Në atë kohë misioni i kësaj qendre personeli ishte i dyanshëm, - kujtojnë drejtuesit e parëve të qendrës, - pasi së pari qendra duhet të bënte rekrutimin, por kësaj radhe rekrutim profesionist, ushtarë profesionistë dhe studentë për shkollat e larta dhe së dyti të bënte administrimin e të dhënave të personelit”. Në ato vite, përveç fushës së rekrutimit të ushtarëve profesionistë, u menaxhuan jo vetëm të dhënat e personelit aktiv dhe atij në rezervë, por u krijuan edhe kartotekat nëpër reparte për nënoficerin dhe ushtarin profesionist si dhe personelin civil, detyra që shkuan drejt automatizimit dhe sot funksionojnë në mënyrë perfekte.

Drejtuesit e kësaj strukture kanë tentuar të rrisin autoritetin e kësaj strukture të re, jo vetëm brenda FA-së, por veçanërisht në pushtetin vendor, duke bërë një fushatë të gjerë marketingu. Ata kanë arritur të krijojnë një strukturë të re të menaxhimit duke ruajtur strukturat e kartotekave, veçanërisht të nënoficerit dhe të ushtarit profesionist si strukturë e re. Nga ana tjetër, u transformuan degët ushtarake në përputhje me misionin e ri që po mernte ushtria. Në tërësi, u krijuan përshkrimet e para të detyrës, rregulloret e para dhe u ngrit profili i një qendre, e cila do të ishte kjo e sotmja. Gjithashtu një kontribut të vazhdueshëm ka dhënë ekipi amerikan i CUBIC për vizionin dhe strukturën e QPR-së. Nga ana tjetër, QPR është “struktura port ku hyn gjaku i ri” në FA dhe si e tillë ka mjaft rëndësi për menaxhimin dhe administrimin e të dhënave të të gjithë personelit apo efektivit të FA-së dhe mbi të gjitha



në procesin e karrierës dhe në marrëdhënien njerëzore, shpirtërore apo shërbyese që ka me të gjithë ushtarakët në rezervë dhe lirim. Rugëtimi i QPR-së ka ardhur duke shënuar progres, sidomos në shpejtësinë e saktësinë e shërbimit duke vënë theksin mbi komponentin rezervist, i cili ka marrë një rëndësi reale dhe në këtë kuadër QPR ka rol primar, sidomos me degët e saj në rrethe, qendrat e mobilizimit të rezervistëve në qarqe, 12 të tillë. Kjo e ka dyfishuar numrin e personelit dhe ka përmirësuar më tej nivelin e shërbimit të punës të funksionimit të kësaj qendre, sigurisht duke i shërbyer detyrave dhe misioneve që ka FA.

### **Arritjet e QPR-së ndër vite**

Përqendrimi në kartotekën e QPR-së i dosjeve të ushtarakëve në rezervë/lirim, përqendrimi i të dhënave të SHDUA, përgatitja e procedurave standarde të pranimit, administrimit, kërkesave që kanë shtetasit për pajisjen me vërtetim për SHDUA si dhe përgatitja e dokumentacionit për përfitimet suplementare për ushtarakët në rezervë dhe lirim, janë arritje të QPR në këto 16 vjet. “Përpunimi i dokumentacionit të ushtarakëve për përfitime suplementare bëhet brenda afateve të përcaktuara jo vetëm pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Qarqe (ISSH 12 drejtori), por dhe qytetarëve nëpërmjet shërbimit postar si dhe takimit të drejtpërdrejtë në zyrat e institucionit tonë, duke bërë jo vetëm ballafaqimin me të dhënat në dosjen e tyre personale, por dhe sqarime të nevojshme kur ka paqartësi nga ana e tyre”, thotë zëvendëskomandanti i QPR-së nënkolonel Aleks Rapi.

Shërbimi që ofrohej brenda 2-3 ditëve nga mbërritja e kërkesës së qytetarit nëpërmjet Postës Shqiptare, sot në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, urdhrin të Kryeministrit nr. 153, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 1.1.2020”, ofrimi i shërbimeve nga Qendra e Personel Rekrutimit për përpunimin e dokumentacionit për përkujdesje e përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim, realizohen vetëm elektronikisht nëpërmjet platformës “e-Albania”, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me nënshkrim elektronik, thekson nënkolonel Rapi. “Në QPR, - tha ai, - nuk janë të pakta rastet kur qytetarët vijnë enkas për të takuar personelin tonë për t’i falënderuar në shenjë respekti e mirënjohjeje”.

Në këtë institucion bëhet hedhja e të dhënave të personelit të FA-së, në programin e ri të automatizimit të të dhënave të personelit të FA-së, përgatitja dhe vënia në dispozicion të komisioneve të karrierës, i dokumentacionit të kandidatëve për t’u shqyrtuar për marrjen e gradës dhe kryerjen e kursit institucional të radhës, bazuar në të dhënat e informatizuara; dërgimi në MM e SHPFA (sipas fazave), i listave të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve/detarëve aktivë sipas gradave që plotësojnë kohën e qëndrimit në shërbim aktiv në FA

(me moshë); realizimi i planit të rekrutimit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së; krijimi i një databaze me të dhëna të detajuara për ushtarakët (oficer, nënoficer dhe UP) në rezervë/lirim/pension; përgatitja e dokumentacionit për përfitimet e suplementare (modulari nr. 03), lirim e pension, vërtetimeve për vjetërsinë në shërbim në FA (modulari nr. 31) si dhe vërtetimit për pagën; vërtetim për vjetërsi në shërbim dhe pagën mesatare referuese neto Modulari Nr. 03; për efekt pensioni, vjetërsi shërbimi invaliditeti ose familjar (për ushtarakët në rezervë/lirim për efekt pensioni pleqërie, Modulari Nr. 31); për pagën referuese për periudhën e trajtimit financiar të ushtarakëve sipas VKM nr. 225, datë 29.05.1992 dhe VKM nr. 07, datë 10.01.1996; Vërtetime karriere për personelin ushtarak në R/L/P si dhe vërtetime vjetërsie në punë për personelin civil; hartimi i përshkrimit të punës për personelin e Qendrës së Personel Rekrutimit; Përgatitja e planit të veprimit “Për Marketingun”, përditësimi në dosjet personale dhe në databazë i Urdhrave të Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm i FA-së si dhe të Komandantëve të Forcave për emërim në detyrë të personelit të FA-së, sipas strukturës së re.

QPR vitet e fundit ka përmirësuar shërbimin ndaj shtetasve, plotësimin në kohë të kërkesave për pajisje me vërtetim SHDUA dhe të dokumentacionit për përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim/pension. Ajo njëkohësisht vazhdon me standardizimin, automatizimin, administrimin dhe përditësimin e të dhënave të personelit aktiv në FA dhe atij në R/L; koordinimin me njësitë e repartet e FA-së, me qëllim realizimin e procedurave për sigurimin e mundësive dhe shanseve të barabarta të kandidatëve për të shërbyer në FA, pavarësisht përkatësisë fetare, krahinore, etj.

QPR po vazhdon zbatimin e masave konkrete për promovimin dhe informimin e publikut (zhvillimi i marketingut), për rekrutimin e kontingjenteve në interes të FA-së. Bashkëpunimi me organet e pushtetit vendor, zyrat e punës dhe institucionet arsimore në të gjitha prefekturat, për promovimin dhe rekrutimin është pjesë e punës në vazhdimësi. Një drejtim tjetër i rëndësishëm i Qendrës së Personel Rekrutimit është administrimi, menaxhimi dhe përditësimi i të dhënave në dosjet personale dhe në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për personelin ushtarak dhe civil aktiv në Forcat e Armatosura.

Përmeshja e misionit mbështetet në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore, rregulloreve e procedurave standarde dhe falë kontributit të dhënë nga kompania amerikane SAIC/CUBIC, u bë e mundur vënia në efikasitet në vitin 2012 i programit të automatizimit të të dhënave (SMBNJ) të personelit aktiv. Të gjitha këto të dhëna të administruara në sistem, i shërbejnë më së miri menaxhimit të personelit nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura si dhe komisioneve të karrierës për mbarëvajtjen e procesit të shqyrtimit të personelit ushtarak për promovimin e tyre dhe ecurinë në karrierën ushtarake.

Përkujdesja ndaj ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe familjeve të tyre, është një drejtim me shumë rëndësi i Qendrës së Personel Rekrutimit. Përqendrimi i të gjitha dosjeve të ushtarakëve të kësaj kategorie, rreth 55.000

dosje si dhe i procedurave për pasqyrimin në dokumentet e kërkuara për të gjitha llojet e pensioneve dhe përfitimeve suplementare, e ka bërë shumë të vlefshme punën e personelit, duke i dhënë më shumë cilësi, shpejtësi dhe transparencë trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesave të kësaj moshe. Administrimi i të dhënave për kryerjen e Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak Aktiv i rreth 1.700.000 shtetasve shqiptarë meshkuj, në Qendrën e Personel Rekrutimit si dhe ofrimi i këtij shërbimi publik pa pagesë brenda 2-3 ditëve, ka bërë që të njihet e vlerësohet nga shtetasit dhe institucionet shtetërore në vend. Personeli i kësaj qendre është gjithmonë në dispozicion të të gjithë qytetarëve të cilët hasin vështirësi të ndryshme, duke i dhënë zgjidhje sa më të shpejt problematikave të tyre. Përvoja e ofrimit të shërbimeve sa më afër publikut, pranë çdo zyre postare, por dhe tashmë aplikimi online në e\_Albania, kanë bërë të mundur rritjen e cilësisë së shërbimit, aplikimin dhe marrjen e përgjigjeve dhe dokumentacionit të nevojshëm nga ana e qytetarëve. Risi e misionit dhe e detyrave të strukturës aktuale të Qendrës së Personel Rekrutimit është dhe krijimi i komponentit të rezervës, i domosdoshëm jo vetëm si përvojë e vendeve të Aleancës ku aderojmë, por dhe për t'u ardhur në ndihmë e për t'u përdorur në përballimin e situatave emergjente në zona të ndryshme në vend. Ngritja dhe funksionimi i strukturës së komponentit të rekrutimit për ushtarakët aktivë e ata të rezervës në 12 qarqet e vendit si dhe për Forcat e Komandat, bën të mundur sigurimin e burimeve njerëzore e materiale, kur kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme, lidhjen dhe bashkëpunimin e ngushtë së Forcave të Armatosura me organet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera publike e jopublike.

### **Rekrutimi, sfida përballë qendrës**

Rekrutimi si një nga detyrat bazë të kësaj qendre, fokusohet në kryerjen e fushatave të promovimit dhe informimit të grupeve të interesit dhe individëve mbi mundësitë që

ofrojnë FA-të për një karrierë të sigurt dhe një jetë më të mirë për të rinjtë dhe të rejtat që dëshirojnë të bëhen pjesë e saj. Bazë për rekrutimin e oficerëve të rinj, ushtarit/detarit aktiv janë kriteret ligjore të përcaktuara si dhe politikat e rekrutimit të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes. Ai kryhet sipas planit dhe nevojave të Forcave të Armatosura, duke i dhënë përparësi rekrutimit të shtetasve me arsim të lartë dhe me aftësi të mira për specialitete të veçanta. Vlen të theksohet që shpeshherë përfaqësuesit më të lartë civilë dhe ushtarakë kanë qenë pjesë e takimeve të zhvilluara në institucionet arsimore të vendit. Kandidatët të regjistruar me dokumentacion të rregullt i nënshtrohen testeve fizike, intelektuale dhe psikologjike. Qendra e personel Rekrutimit është angazhuar gjithmonë të zbatojë me përpikëri dhe transparencë të gjitha procedurat ligjore për përzgjedhjen e kandidatëve më cilësorë për realizimin e planit të rekrutimit. Ajo vepron në bazë të një programi të caktuar 6-mujor, ku për 6-mujorin e dytë 2023, ka në plan të rekrutojë 439 personel. Me gjithë angazhimin e bërë gjatë fushatave të rekrutimit, marketingut të zhvilluar gjatë kohëve të fundit, rritjes reale/shtesës së pagave të ushtarakëve aktiv në Forcat e Armatosura me 30% nga data 1 korrik 2022, si dhe me 7 % nga marsi i këtij viti, realizimi i planit të rekrutimit nuk ishte në nivelin e kërkuar. Si problem, e evidentuar është tendenca e lëvizjes së të rinjve për mundësi më të mira jashtë vendit, i cili është dhe burimi kryesor për rekrutim në FA. “Duke analizuar situatën e rekrutimit në FA, lind nevoja e kryerjes së një studimi të thelluar, me ndryshimet e nevojshme ligjore ku mund të përdoren të dyja format e rekrutimit: vullnetar dhe fillimin e atij me detyrim, duke përcaktuar moshën e rekrutimit dhe kohë/afate të tjera rekrutuese nga ligji aktual nr. 9047, datë 10.07.2003, në vartësi të numrit përgjithshëm të personelit në FA e të situatave rajonale”, specifikon zëvendëskomandanti i QPR-së, nënkolonel Aleks Rapi.



# Nuk është e lehtë të plakesh me DINJITET... 000



**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit  
të Botimeve

**N**uk është e lehtë të plakesh me dinjitet... Duhet të pranosh lëkurën e re, “brazdat” e reja, pamjen e re... Duhet të bësh paqe me frymëmarrjen më të shkurtër, me rimëkëmbjen më të ngadalë pas sëmundjeve, me nyjat që dhembin, me venat, me flokët e bardhë që dalëngadalë ia zënë vendin valëzimit të flokëve plot jetë të rinisë... Duhet ta pranosh dhe ta duash veten në një epokë të re, të rikrijosh vetveten, të vazhdosh të jesh kureshtar, të qeshësh dhe të vazhdosh “të pastros” dhëmbët për t’i bërë ata të shkëlqejnë përsëri... Duhet të kultivosh ironinë, të kuptosh që mund të vazhdosh të gabosh, të zgjedhësh njerëz të tjerë me kujdes, të dalësh nga vetvetja, të kthehesh te ajo, të këndosh, të mallkosh “mësuesit” e jetës, të tallesh me frikën, të jesh krenar dhe të pranosh trupin tënd... Nuk do jetë e lehtë, por së paku përpqi të vjetërsohesh si vera, të “parfumosh” dhe të shijosh si ajo edhe me kalimin e viteve... Problemi kryesor në modernitet është përballja me një krizë morale të përmasave të mëdha. Jetojmë në shoqërinë e bollëkut material, por në të njëjtën kohë përballemi me humbjen e arsyes dhe absolute morale. Më së shumti kultura perëndimore rrezikohet nga pikëpamja e pakët e dinjitetit njerëzor. “Dinjiteti nuk bie nga qielli. Ai nuk mund të blihet dhe as të shpiket. Dinjiteti është shpërblim i rezervuar për ata që punojnë me ndërgjegje” Në jetën e përditshme na takon shpesh të dëgjojmë të flitet për njerëz me dinjitet, të dinjitetshëm, dinjitarë etj., dhe po kaq shpesh për

individë pa dinjitet. Dinjiteti është një tërësi vlerash morale tek njeriu dhe, në mënyrë të veçantë, vetëdija që ka individi për këto vlera, vetëdije që manifestohet në sjelljet dhe qëndrimet e njeriut ndaj të vërtetës, të drejtës dhe të moralshmes. Në historinë e njerëzimit ka pasur prirje për ta matur dinjitetin e individit në raport me pasurinë apo pozitën e tij në shoqëri, por koha ka provuar se dinjiteti është një pasuri morale individuale.

Ashtu si karakteri dhe personaliteti që i hedhin rrënjët tek njeriu qysh në moshë të re, edhe dinjiteti si formë e shfaqjes së tyre fillon të manifestohet mjaft herët dhe e shoqëron njeriun gjatë gjithë jetës. Përgjithësisht dinjiteti i individit përcaktohet nga sjelljet dhe qëndrimet që mban ai kundrejt individëve të tjerë, familjes dhe shoqërisë në tërësi, dhe nga shkalla e përputhjes së këtyre sjelljeve e qëndrimeve me kodin moral të shoqërisë.

Në Shqipëri dhe jashtë saj kemi parë dhe mund të gjejmë me mijëra individë “të famshëm”, të pasur apo politikisht të pushtetshëm, të cilët sillen e veprojnë pa kurrfarë dinjiteti.

Para fushatës së pasuksesshme turke për rusët në 1711, sundimtari moldav, Princi Cantemir, hyri nën patronazhin e Pjetrit të Madh. Në përfundim të paqes me turqit, Pjetrit iu dha një nga kushtet e propozuara nga Veziri i Madh: ekstradimi i Kantemirit. Disa nga të afërmit e bindën Pjetrin të pajtohej me kushtet e armikut. Duke e shtyrë perandorin drejt tradhtisë, ata e siguruan Pjetrin se fjala që i kishte dhënë Kantemirit ishte vetëm një fjalë; se, pasi ka tradhtuar sundimtarin moldav, Pjetri nuk do ta njollosë shpirtin e tij me mëkat. Megjithatë, Pjetri qëndroi i palëkundur dhe pushoi së rënkuari, duke thënë: “Më mirë do t’ua dorëzoja tokën turqve deri në Kursk sesa të pajtohesha me këtë. Do të kem shpresë për të rifituar atë që më është dhënë, por të mos mbaj fjalën do të thotë të humbas përgjithmonë nderin”.

Një njeri i nderuar ka shumë virtyte, ai karakterizohet nga sinqeriteti, fisnikëria e shpirtit, qëllimi i ndershëm dhe i drejtpërdrejtë për t’iu përmbajtur marrëveshjeve të arritura më parë, ndërgjegjia, mirësjellja, guximi dhe ndërgjegjia e pastër. Nderi e zbkuron njeriun.

Shekspiri ka thënë: “Nuk është veshja ajo që e zbkuron njeriun. Ndërsa dielli shkëlqen nga pas reve të zeza, kështu nderi shkëlqen nën rrobat e varfra”.

Mosmarrëveshjet e një personi me nder në çdo kohë u ndëshkuan



# PËRGATITJA E OFICERIT SHQIPTAR - LIDERIT ME KARAKTER



Dr. Valbona Zeka,  
Fakulteti i Mbrojtjes  
dhe Sigurisë

**N**dryshimet rrënjësore në mjedisin strategjik të sigurisë, padyshim që diktojnë zhvillimin e forcës, reformimin dhe modernizimin e tyre, nivelin e gatishmërisë, aftësisë për të qenë ndërveprues, të qëndrueshëm dhe efikas në operacionet me vete apo me aleatët, si dhe doemos kërkojnë një trupë ushtarake profesionale dhe të mirë trajnuar.

Këto ndryshime përherë dhe më shumë diktojnë nevojën e evoluimit dhe zhvillimit të procesit të arsimit, trajnimit dhe stërvitjes për përgatitjen e personelit të Forcave të Armatosura, për një spektër të plotë në zgjidhjen e detyrave në fushën e operacioneve.

Përgatitja profesionale duhet të ngrihet vazhdimisht, përvoja dhe mësimet e kaluara, duhet të përdoren për të dritësuar objektivat për të ardhmen. Institucionet arsimore e stërvitore dhe veçanërisht Akademia e Forcave të Armatosura, në përgatitjen e programeve të studimeve dhe kurrikulave, duhet të mbajë në konsideratë baraspeshën e duhur mes koncepteve akademike universitare dhe realitetit operacional me qëllim realizimin e efektit të duhur në përgatitjen e gjeneratës së re të oficerëve.

Forcat e Armatosura duhet të ndërmarrin veprime për të përmirësuar aftësitë luftuese të trupës së saj, të oficerëve dhe të nëno-

ficerëve në mënyrë që të vazhdojnë të operojnë në rrugë të efektshme në këta misione shumë të rrezikshme, e në mjedise lufte jo të zakonshëm.

Kërcënimet ndaj sigurisë, të cilat janë më të ndryshme, më të vështira për t'u parashikuar dhe neutralizuar, kërkojnë që institucionet e arsimit dhe trajnimit të përshtatin programin e tyre për të nxjerrë oficerë, nënofficerë dhe ushtarë të përgatitur të aftë të orientohen në të gjitha llojet e luftës sot.

Ndryshimi i formave të konfliktit, kërcënimet dhe rreziqet me natyrë jo konvencionale apo terrorizmi, siguria energjetike, kërcënimi kibernetik dhe ndryshimet klimatike, sfidat dhe kërcënimet hibride, përhapja në rritje e luftës asimetrike, krahas me armët e taktikat konvencionale e jo konvencionale në fushëbetejë, kërkojnë gjithnjë e më shumë një angazhim të vazhdueshëm të Forcave tona të Armatosura dhe një trajtim gjithëpërfshirës ndaj operacioneve për përballimin e kërcënimeve e rreziqeve të reja, si dhe reflektim e ndikim në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor ushtarak, doktrinës ushtarake dhe edukimit profesional të ushtarakut në veçanti. "Mjedisi ynë i sigurisë është më kompleks dhe i kontestuar më shumë se kurrë më parë, me konkurrencën globale, sulmet e sofistikuar kibernetike, teknologjitë përçarëse, terrorizmin brutal, përhapjen e armëve bërthamore dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike ndaj sigurisë."

Ky mjedis ka sjelle një dinamikë të re të operacioneve të sotme, por dhe te ardhme. Nëse hedhim një vështrim të dekadës së fundit do të shohim se ka pasur ndryshime të jashtëzakonshme gjeopolitike dhe gjeostrategjike, të cilat kanë prodhuar një dok-

trinë të re të aktorëve kryesorë global dhe një konceptim të ri të përdorimit të forcës ushtarake. Shembull më domethënës i këtyre ndryshimeve në dekadën e fundit është edhe agresioni i fundit ushtarak rus ndaj një vendi të pavarur siç është Ukraina, ku po zbatohen të gjitha format e luftës, diversive, hibride, kibernetike, asimetrike e deri tek ato konvencionale klasike.

## **Përgatitja profesionale si një proces i vazhdueshëm**

Në këto rrethana, ngritja profesionale e ushtarakut shqiptar merr një rëndësi të dorës së parë. Programi i dijes, përgatitja profesionale e oficerëve, nënofficerëve dhe ushtarëve është një proces i qëllimshëm, i vazhdueshëm, i ndarë në faza progresive. Ai është një proces nëpërmjet të cilit, studentët shndërrohen nga qytetare civilë në ushtarë profesionistë të përgatitur dhe në drejtues të aftë, si oficerë për të komanduar operacione ushtarake, për të drejtuar ekupe dhe organizata në zbatimin e detyrave me përpikëri në kohë.

Ecuria profesionale arrihet nëpërmjet sin-tezës së vazhdueshme të njohurive, aftësive dhe eksperiencës së fituar nëpërmjet trajnimit institucional dhe realizimit të programeve të studimit, trajnimit ekstrakurrikular, detyrave/eksperiencës operacionale dhe vetëzhvillimit. Themelet e zhvillimit profesional të ushtarakut e kanë bazën e dijes tek shkolla. Akademia e Forcave të Armatosura është struktura kryesore e cila mbështet Forcat e Armatosura me burime njerëzore të arsimuara, trajnuara dhe të kualifikuara.

Nëpërmjet sistemit të arsimit dhe stërvitjes, Forcat e Armatosura u japin njësisë të

tyre specialistë; ushtarakë dhe drejtues të stërvitur, shumë të përshtatshëm, të gatshëm për të kryer misionet bazë operacionale dhe funksionale të kohës së luftës. Një sistem arsimor dhe trajnues i mirë përqendruar dhe i organizuar përgatit profesionistë ushtarakë të suksesshëm në fushëbetejë. Ky sistem, gjithashtu, i përgatit profesionistët ushtarakë për detyra më komplekse dhe pozicione përgjegjësie gjithnjë e më të mëdha. Arsimit dhe trajnimit në mënyrë parësore përfshin bazat, qendrat trajnuese dhe infrastrukturën akademike, të cilat kryejnë stërvitjen fillestare dhe plotësojnë arsimimin e mëtejshëm profesional për studentet dhe drejtuesit specialistë.

Aftësitë ushtarake që kërkohen sot për misionet të tilla janë komplekse dhe duhet të pasqyrohen në programet studimore, në programet ekstrakurrikulare dhe në doktrinën e arsimimit, sepse Forcat e Armatosura janë dhe mbeten një mjet efektiv i politikës së sigurisë.

Natyrë e profesionit ushtarak është e tillë që, aftësitë e ushtarakut janë të bazuara në përgjegjësitë maksimale të tij ndaj detyrës, si dhe kualifikimin e aftësimin e tij, për të kryer me përpikëri detyrën apo misionin e ngarkuar sipas funksionit që ka. Sistemi profesional i përgatitjes në akademi siguron që oficerët e ardhshëm të jenë të stërvitur, të edukuar, të përgatitur për t'u bërë drejtues të suksesshëm. Një program efektiv dhe i arrirë i arsimimit ushtarak përgatit drejtuesit për përgjegjësitë e shtruara dhe vendos kushtet për të aftësuar ata që të arrijnë rezultate të suksesshme në hierarkinë e komandimit.

Forcat e Armatosura kanë nevojë për drejtues, që të jenë profesionistë dhe të aftë të veprojnë në zona shumë larg njëra - tjetrës, në mjedise të ndryshme dhe të integruara në forca operacionale të bashkuara, kombëtare, shumëkombëshe dhe të përfshira, si edhe me forcat e operacioneve speciale dhe organizatat joqeveritare. Këta drejtues dhe ushtarakë profesionistë kërkohen të jenë më karakter të fortë moral, të jenë të vetëdijshëm dhe të përshtatshëm, të qetë në situata të pasigurta, të aftë të presin dhe zbatojnë urdhra, të vijoje nga veprimet e tyre, të dedikuar në profesionin e ushtarakut dhe të jenë shumë të aftë psikologjikisht dhe fizikisht në çdo rrethanë.

Përgatitja profesionale është proces i vazhdueshëm që zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura, i cili u jep kandidatëve për oficerë nëpërmjet programeve të studimit, të gjitha nivelet (ciklet) e studimit nga bachelor, master shkencor dhe doktoraturë. Procesi merr në konsideratë së pari, drejtuesit ushtarakë dhe profesionistët, që të jenë teknikisht dhe taktikisht të aftë në kompetencat e tyre bazë, të përshtatshëm për ndryshimin.

Dallimi i ndryshimit ndërmjet stërvitjes reale dhe operacionale apo performancës së fushëbetejës është e vështirë. Zhvillimi i koncepteve akademike universitare si qëllim më vete, mund të heqë vëmendjen nga objektiva të mirëfilltë ushtarakë dhe anasjelltas. Në këtë pikëpamje qëllimi kryesor në përgatitjen e programeve të studimit ka qenë dhe është ndërthurja e këtyre dy koncepteve njëri me tjetrin, si dhe zhvillimin veçmas të programit të karakterit për të krijuar në tërësi një program studimor efektiv për studentët.

Aftësimi i liderit profesional arrihet nëpërmjet disa fushave, të cilat japin eksperiencën e duhur gjatë zhvillimit në karrierë. Fusha e parë dhe më esenciale është shkolla, e cila nuk ka qëllim të nxjerrë oficerë të mësuar, por oficerë që dinë të mësojnë. Më tej me rëndësi jo të paktë është përvoja në punë, vetëzhvillimi dhe këshillimi. Këto katër fusha ndërlihen, duke përdorur informacionin e marrë dhe vlerësimet nëpërmjet burimeve dhe metodave të ndryshme.

“Profesioni ushtarak për shkak të edukimit dhe të shkollimit të theksuar ka një respekt për arritjet intelektuale...”

Menaxheri ushtarak duhet të jetë i përgatitur për të vënë në përdorim arritjet e tij intelek-

në zgjidhjen e detyrave, ku theksi vihet në pjesëmarrjen e studentit dhe kontributin e procesit mësimor. Ushtimet në situata të caktuara taktike, fizike, operacionale apo dhe strategjike, seminarët e lidhshmit dhe ushtimet e planifikimit për momentet e krizave janë disa shembuj të arsimimit dhe trajnimit efektiv të grupeve të vogla.

### Formimi i liderit me karakter

Shërbimi në Forcat e Armatosura, duke filluar në moshën rinore nuk mund të shihet ndryshe vetëm si një formë e edukimit moral. Shprehja gjermane “Die Schule der Nation” (Shkolla e Kombit) në fakt shpreh një apel të shërbimit ndaj kombit, i cili ofrohet përpos një përgatitjeje profesionale edhe shpirt të unifikuar kombëtar. Forcat e Armatosura ngulisin në personelin ushtarak virtytet dhe shprehitë e të menduarit dhe të vepruarit me vlera të larta morale, etike dhe profesionale.

Ushtarakët profesionistë dhe ushtritë profesioniste mund t'i bashkëngjiten kodeve të sjelljes e të mendimit e të lulëzojnë edhe në mjediset e një shoqërie indiferente ose armiçësore”.

Qëllimi përfundimtar i aftësimit profe-



tuale, sepse ai është i interesuar për zgjidhjen shkencore produktive të problemeve komplekse administrative dhe organizative”.

Pikërisht qëllimi i Akademisë së Forcave të Armatosura është që nëpërmjet programeve të japë bazën e shëndoshë, mbi të cilën mbështetet i gjithë zhvillimi profesional i së ardhmes së oficerit.

Synimi është në zhvillimin e programeve të gjithë cikleve të ruhet progresiviteti për zhvillimin e kompetencës taktike, teknike dhe fizike, si edhe dimensionet qendrore të udhëheqjes.

Modeli ideal për procesin e zhvillimit të drejtuesve brenda arsimimit dhe trajnimit institucional është zhvillimi në grupin e vogël

sional, padyshim që është formimi i drejtuesve kompetentë dhe i ushtarakëve profesionistë.

Këta drejtues dhe ushtarakë profesionistë do të japin shumë qartë qëllimin, drejtimin, motivimin dhe një vizion për vartësit e tyre, ndërsa zbatojnë misionet funksionale të kohës së luftës dhe operacionet e kohës së paqes.

Lidershipi ka një rol të rëndësishëm në ngritjen profesionale të studentëve tanë gjatë procesit të zhvillimit të programeve të studimit. Studentët janë gati të ndjekin një drejtues, në vendosmërinë dhe aftësitë drejtuese të të cilit ata kanë besim.

Vendosmëria është një nga cilësitë kryesore të udhëheqjes së frytshme. Kur një drejtues, i cili ndryshon gjithnjë vendimet dhe urdhrat e tij, nuk do të vonojë të humbasë çfarëdo besimi që ushtarët e tij mund të kenë patur më përpara. Vendosmëria lidhet me zotërimin e profesionit dhe dijeve ushtarake.

Një pedagog dhe drejtues i mirë duhet të ketë njohuri përpos programit akademik edhe për atë të karakterit, natyrën e njeriut dhe parimet që lidhen me sjelljen njerëzore. Kjo sjellje e bën drejtuesin të jetë më pranë shpirtit dhe mendjes së vartësve të vet. Duke njohur anët e brendshme, hallet dhe shqetësimet e vartësve e bëjnë drejtuesin të parashikojë dhe kontrollojë sjelljen e njerëzve që udhëheq dhe drejton. Skendërbeu ishte jo vetëm një komandant dhe strateg i shquar ushtarak, por ai ishte edhe një drejtues dhe psikolog që njihte mirë artin e të bërit për vete komandantët dhe ushtarët vartës të tij. Kjo qasje ka ndikim në zhvillimin e karakterit të studentit, duke kultivuar tek ai kompetencën shoqërore, sociale dhe profesionale.

Në këtë kontekst zhvillimi i karakterit tek studentet ka një rol vendimtar në formimin e ardhshëm të oficerit. Motoja e Akademisë "West Pointit", me të cilën jemi duke bashkëpunuar është se, "Askush nga ne nuk mund të thotë, kjo është përgjegjësi e dikujt tjetër. Edukoni, trajnioni dhe frymëzoni Korpusin e Kadetëve, në mënyrë që çdo i diplomuar të jetë një lider i porositur me karakter i përkushtuar ndaj vlerave të Detyrës, Nderit, Vëndit dhe i përgatitur për një karrierë të përsosmërisë profesionale dhe shërbimit ndaj Kombit si oficer në Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara".

Akademia e Forcave të Armatosura, krahas zhvillimit të programit akademik, rëndësi të madhe po i kushton zhvillimit të programit të karakterit. Qëllimi i këtij programi është se si ai të formësojë/ndërtojë dhe përshkruajë liderët me karakter, të cilët të jenë të brendësuar me idealet e Detyrës, Nderit, Etikës ndaj Forcave të Armatosura dhe Atdheut.

Synimi për çdo të diplomuar do të jetë krijimi i liderit me karakter, i përkushtuar ndaj vlerave të Detyrës, Nderit, Atdheut dhe i përgatitur për një karrierë të suksesshme profesionale dhe shërbimit ndaj Kombi si oficer.

Akademia e Forcave të Armatosura në formimin e gjeneratës së re të oficerëve ka si pikësynim për të diplomuar individë që janë të certifikuar në karakterin (Nderin), kompetencën (Detyrën) dhe angazhimin (Përkushtimin ndaj vëndit) të një oficer i ngarkuar në profesionin e ushtrisë.

Në këtë kuadër, të gjitha strukturat akademike dhe komanduese të AFA-së kanë një përgjegjësi kryesore për të ndikuar në formimin/ndërtimin e karakterit ose të lehtësojnë zhvillimin e karakterit në secilin individ gjatë periudhës 4-vjeçare të studentit në akademi.

Në strategjinë e zhvillimit të karakterit në radhë të parë duhet të synohet shndërrimi i studentit/kadetit nga "njeri civil" në "njeri me uniformë" të përshtatur me disiplinën, rregulloret, rregullat e brendshme, kodin ushtarak, që tregojnë formësimin e idealeve të tij, ndaj Detyrës, Nderit dhe Atdheut.

Pas këtij hapi do të jetë e gjithë veprimtaria programore e kurrikulare e nevojshme dhe që vlerëson periodikisht efektivitetin e strategjisë, duke mundësuar kushtet për integrimin, sinkronizimin dhe vlerësimin individual dhe kolektiv të studentëve.

Zhvillimi i programit të karakterit do jetë i ndërfutur në të gjitha programet e tjera për të gjitha ciklet e studimit. Ai duhet të zhvillohet natyrshëm nga secili drejtues apo pedagog i stafit akademik. Drejtimi ka shumë rëndësi në veprimtarinë akademike dhe mësimore. Drejtimi përbën artin e sjelljes me njerëzit me objektiv që drejtuesi të ndikojë tek ata, duke i bindur të veprojnë në drejtimin e duhur. Drejtimi nuk duhet ngatërruar me detyrimin, ato janë dy gjëra diametralisht të kundërta. Le të kujtojmë shprehjen e famshme të Uellingtonit: "Mua më pëlqen t'i bind njerëzit dhe jo të ushtroj një autoritet mbi ta".

Në këtë kontekst, zhvillimi i këtij programi kërkon në radhë të parë njerëz të përkushtuar, me integritet dhe moral të lartë.

Shembulli personal është kontributi më i mirë në zhvillimin e programit të karakterit dhe formësimin e njerëzve profesionalë dhe liderëve me karakter. Sa më i drejtë dhe i ndershëm, sa më shumë dinamikë dhe këmbëngulje të shfaqë një drejtues përpara vartësve të tij, aq më shumë autoritet, respekt dhe dashuri do të fitojë ai prej tyre.

Kjo sjellje e bën atë një shembull dhe model të një njeriu që nuk bën ndarje dhe vlerësim të dyshimta. Ata shohin se si dënimi dhe falënderimi janë të merituar dhe vlerësimi i komandantit të tyre është i padiskutueshëm. Vartësit e respektojnë këtë sjellje dhe i ndjekin me besnikëri këta udhëheqës dhe drejtues sepse ata kuptojnë se, kjo lidhet me të gjithë dhe është në interes të të gjithëve. Gjenerali Robert Li ishte jo vetëm një udhëheqës dhe komandant i shquar në betejat që zhvillonte, por autoriteti i tij ishte fituar edhe për sjelljen dhe qëndrimin e dashur që tregonte ai për oficerët dhe ushtarët vartës të tij.

Për ushtarët ai ndjente detyrimet më të mëdha. Ai i quante ata krenaria e tij. Ai përpiqej gjithnjë për mirëqenien e tyre. Ishte kjo arsyeja pse ushtarët e tij kishin një nderim, një devocion dhe një afekcion që pak udhëheqës ushtarakë e kanë gëzuar. Edhe pse ai nuk e pranonte këtë vlerësim, ai e kishte fituar me meritë atë. Duke folur për aftësitë dhe autoritetin që duhet të gëzojë një drejtues, Karl Fon Klauzeviçit theksonte se: "Funksioni i parë i komandantit është të frymëzojë e të nxisë ushtarët për të bërë gjëra

të vështira, në rrethana të vështira".

Arsimimi është procesi i dhënies së njohurive dhe aftësive intelektuale me të cilat informacioni mund të përkthehet në një mënyrë të arsyeshme duke përdorur gjykimin e shëndoshë. Arsimi është në thelb instruksioni formal, zakonisht i kryer në mjedise klase, me njohuri të shtuara, aftësi, mendim kritik, me vendimmarrje të përmirësuar dhe/apo përvojë si produkti i dëshiruar për studentin. Kjo metodologji është në kontrast me stërvitjen, ku një detyrë bazë apo stërvitje përdoret në kushte specifike dhe, këtu standardet përdoren për të vlerësuar aftësitë e individit dhe të njësisë operationale.

Zhvillimi i programeve dhe arsimimi mbështeten në aftësi, përvojë dhe ekspertizë, që drejtuesit e fitojnë në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe kurset e trajnimit e ndryshme civile apo ato ushtarake, të kryera në vendet partnere dhe ato të NATO-s.

Nëpërmjet procesit të arsimimit në të tria ciklet e studimit dhe më tej në kurset e karrierës, studentët marrin njohuri të qëndrueshme për të kryer detyra të vështira ndërsa mësojnë vlerat, karakterin, aftësitë dhe veprimet thelbësore për drejtimin me cilësi të lartë dhe profesionalizëm. Kur të njëjtat përmasa të drejtimit testohen, aplikohen dhe përforcohen, atëherë ato forcohen nga kërkesat operationale në vazhdimësi dhe programet e mira të vetëzhvillimit, ku drejtuesit fitojnë dhe ruajnë kompetencën e vërtetë në profesionin e tyre. Është i njohur fakti që baza e një fuqie ushtarake është trekëndëshi i njohur force-moral-motivacion. Kur flasim për komponentin e forcës duhet të theksojmë se krahas pajisjes me armatim dhe teknologji një vend të rëndësishëm zë përgatitja e personelit ushtarak dhe në veçanti përgatitja fizike. Në përcaktimin e fuqisë luftarake ka pak rëndësi sa të përparura janë platformat, armatimet ose pajisjet e njësive ushtarake, nëse njerëzit që i drejtojnë ato janë të pamotivuar, janë të pa stërvitur ose u mungon udhëheqja e duhur.

Sot, Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë të angazhuara në mjaft detyra operationale dhe për pasojë ato janë dislokuar në misionet brenda vëndit, ashtu edhe në misionet paqeruajtëse, ku për pasojë nuk gjejnë kohë të mjaftueshme për të bërë përgatitje fizike dhe stërvitje të programuara si në kohë normale.

Programet akademike, ushtarake, fizike dhe të karakterit që ofrohet Akademia përbëjnë mjetet kryesore për të zhvilluar tek trupa ushtarake, pesë aspektet e karakterit individual dhe rritjen e performancës profesionale. Programi Akademik ka synime kryesore të zhvillimit të karakterit në pikëpamjen morale, sociale dhe aspektet e tjera të zhvillimit të qytetarisë. Programet e tjera kontribuojnë në qëllimet kryesore dhe mbështetëse të karakterit bazuar në aktivitetet e tyre.



Akademia e Forcave të Armatosura, nëpërmjet zhvillimit të Programit Fizik është fokusuar në performancën dhe aspektet e lidërshiptit të karakterit, duke bërë të mundur rritjen e rezistencës fizike dhe mendore, duke forcuar guximin përmes vështirësive individuale dhe në grup, duke zhvilluar një shpirt fitues dhe duke demonstruar më të mirën sportive. Stafit pedagogjik dhe personeli komandues, oficerët përgjegjës sfidonjë dhe frymëzojnë studentët për të rritur performancën dhe karakterit e tyre drejtues.

Pjesëmarrja aktive në sporte, klube konkurruese në disiplina të ndryshme sportive si atletikë, gjimnastikë, futboll, volejboll, basketboll etj., krijon mundësi dhe i ofron çdo student një mundësi të përditshme për t'u zhvilluar fizikisht, mendërisht dhe nga ana etike.

Por ama, në çdo kohë është tepër i domosdoshëm kondicioni fizik. Kondicioni fizik, si komponent i performancës sportive, formohet nga veprimi i përbashkët me përparësi i proceseve energjike, duke shfaqur si aftësinë e forcës, shpejtësisë, qëndrueshmërisë dhe lëvizshmërisë artikulare, në bashkërendim me cilësitë e domosdoshme psikike të këtyre aftësive.

Ushtrimet fizike që ushtrojnë studentët në terrene sportive apo palestër, padyshim i bëjnë ata të aftë fizikisht dhe në të njëjtën kohë u nevojiten atyre për të kryer detyra sa më të vështira, si për shembull, marshimet në distanca të gjata, në zhvillimin e stërvitjeve komplekse ose operimi në zona që nuk janë lehtësisht të lundrueshme. Në këtë kuadër, studime të shumta të kryera kanë dalë në përfundimin se, përgatitja fizike u mundëson individëve që të ushtrojnë rregullisht atë, një numër të madh mundësish dhe benefitesh që përfshijnë, jo vetëm kontrollin e fizik, por një gjendje të mirë shëndetësore, përmirëson humorin dhe anën moral-psikologjike dhe anën karakteriale.

Trupa pedagogjike në Akademi, por dhe drejtuesit në strukturat e FA-së, duhet të organizojnë fushata të trajnimit fizik për të promovuar aftësi të besueshme profesionale për trupat e tyre, në mënyrë që ata të mund të përballen me çdo lloj ngjarjeje, veçanërisht ato që ndodhin në mënyrë të papritur.

Padyshim, kjo është një përgjegjësi në radhë të parë e çdo ushtaraku në mënyrë individuale, por edhe e strukturave drejtuese të përgatitjes fizike në të gjithë piramidën e Forcave të Armatosura.

Në studimet e ndryshme të kryera në SHBA, rezultati i këtij edukimi drejtues është përputhja e përmirësuar me programimin e përgatitjes fizike, me shpërndarjen e burimeve, duke bërë kështu një ulje të gjasave për sëmundje fizike dhe psikologjike të studentëve. Këto rezultate ndodhin kur udhëheqësit kup-

tojnë vlerën dhe dobinë e këtij sistemi.

Vetëdija apo përgatitja e pedagogëve dhe drejtuesve në akademi me ndikim në opinionin e komunitetit akademik për perspektivën, vlerat dhe prioritetet e Akademisë së Forcave të Armatosura kërkon patjetër modelimin e një kulture dhe vlerave brenda strukturave tona akademike, por edhe më gjerë në rrafshin shoqëror.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm në veprimtarinë mësimore dhe akademike në AFA është udhëheqja me shembullin personal. Një gjeneral i spikatur amerikan thoshte se: "Në arenën në të cilën jeton dhe vepron drejtuesi i lartë i ushtrisë, ju duhet të jeni bindës me audiencën të ndryshme. Ju duhet të jeni bindës me audiencën e brendshme të ushtarakëve dhe civilëve që shërbeni...". Duke lexuar me kujdes shembujt e shumë komandantëve të suksesshëm dhe me autoritet, vëmë re se një



ndër cilësitë që i ka bërë ata të jenë të tillë ka qenë energjia dhe shembulli personal që ata kanë treguar. Shembulli i gjeneral Stillull për drejtimin dhe realizimin me sukses të marshimit prej 140 milje nga Burma për në Indi, nën drejtimin e jo një reparti të rregullt ushtarak por të një turme të paorganizuarish burra dhe gra, është një model që tregon se, atje ku shembulli personal, qëndrueshmëria fizike dhe energjia e komandantit udhëheq, vartësit të ndjekin dhe vlerësojnë autoritetin me të cilën drejton. Komandat e njëjse ushtarake dhe drejtuesit e të gjitha niveleve duhet të ruajnë infrastrukturën e përgatitjes fizike dhe ndërkohe të ndërtojnë objekte të reja shtesë të trajnimit fizik, në mënyrë që të inkurajojë sa më shumë personelin ushtarak

dhe civil në Forcat e Armatosura që të bëjnë sa më shumë përgatitje fizike, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e mirëqenies së tyre. Ngjarjet dhe fenomenet në fushën ushtarake kanë karakter historik, ato varen, zhvillohen e kushtëzohen nga sistemi shoqëror. Mjedisi i sigurisë, niveli i zhvillimit të teknikës dhe armatimit, mënyrat e reja të zhvillimit të veprimeve luftarake të ndërlikuara ndikojnë drejtpërdrejt në strategjitë e doktrinave ushtarake të drejtimit. Kryerja me sukses e operacioneve ushtarake kërkon një doktrinë të qartë dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme, kur operacionet do të kryhen nga forca aleate ose të koalicionit.

Dhe kjo arrihet në pasurimin e kurrikulave arsimore, nëpërmjet futjes së doktrinave të reja të NATO-s dhe në të njëjtën kohë zhvillimin e pasurimit e doktrinës ushtarake kombëtare.

Akademia e Forcave të Armatosura, nëpërm-

jet zhvillimit të programit akademik dhe programit të karakterit, merr një rol parësor në ngjizjen e aftësive moral-psikologjike tek trupa studentore si garantuese e lidërshiptit të ardhshëm të suksesshëm. Autoritetin drejtues, nuk e jep pozicioni komandues/drejtues apo gradat ushtarake, as trashëgimia familjare, por ta japin vlerat etike, morale dhe profesionale.

Autoriteti është vetëm produkt i edukimit, karakterit, punës dhe sjelljes individuale të një drejtuesi ushtarak.

Profesioni i ushtarakut merr vlera të tjera dhe mund të themi se, nga përvoja e misioneve shqiptare dhe atyre të vendeve euroatlantike dhe partnere, ato duhet të jenë në një konvergencë sa më të lartë me vlerat civile.

# Gjeneral brigade Xhebexhia: Suksesi për çdo detyrë kërkon që të afrosh zemrën, mendjen dhe vullnetin në çdo kohë



Intervistoi:  
**MIMOZA GOLIKJA**

**F**orca Tokësore u krijua më 29 gusht të vitit 2000, duke përfshirë në radhët e saj njësi dhe reparte me traditë me një veprimtari të pasur shumëvjeçare, të përhapura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sot Forca Tokësore është njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura.

Me një përbërje prej 5 divizionesh këmbësorie me rreth 55 brigada dhe 300 batalione në 167 rajone të ndryshme të vendit, Forca Tokësore u përfshi në një proces transformimi të thellë e të gjithanshëm sipas koncepteve të ushtrive perëndimore dhe me kalimin tërësisht të strukturave të kësaj force, nga një ushtri e shërbimit të detyrueshëm në një ushtri profesioniste, duke rritur nivelin e operacionalitetit.

Forca Tokësore është hallka kryesore e FA-së, ajo ka në strukturën e saj, Komandën dhe Shtabin e FT si dhe repartet e nënrepartet me të cilat bën të mundur realizimin e misionit të saj.

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i Forcës Tokësore me një karrierë të gjatë në Forcat e Armatosura, ka nisur rrugëtimin e tij si,



komandant toge në Regjimentin Komando, më tej specialist në Seksionin e Analizës, Drejtoria e Zbulimit (J2), në SHPFA, detyra të ndryshme në Drejtorinë e Zbulimit (J2), shef Seksioni (S-2), në qendrën e Radio-Zbulimit (SIGINT), zëvendës komandant i Qendrës së Radio-Zbulimit (SIGINT), Oficer Shtabi për Inteligjencën, përfaqësia Ushtarake Shqiptare në NATO, Bruksel. Shef i Qendrës SIGINT, Agjencia Inteligjencës Ushtarake, Drejtor i Drejtorisë së SIGINT, Agjencia Inteligjencës Ushtarake, shef i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes (G-3/7), Komanda e Forcës Tokësore. Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes J3/7 në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së. Zëvendës Përfaqësues Ushtarak Shqiptar në NATO dhe Atashe i Mbrojtjes për Mbretërinë e Belgjikës dhe jo rezident për Republikën e Francës. Në vitin 2020, gradohet me gradën madhore “gjeneral brigade”, ku do të kryente detyrën si komandant i Forcës Detare, më tej komandant i Komandës Mbështetëse.

**Z. gjeneral, duke mundësuar këtë bashkëbisedim, më jepet rasti të sjell në vëmendje që bashkëpunimi juaj me median ushtarake është i hershëm, si autor apo bashkautor i shkrimeve në revistën “Mbrojtja” dhe në gazetën “Ushtria”. Por, këtë herë tashmë në një pozicion tjetër, dëshirojmë që ju të ndani me ne**

**përvojën tuaj si ushtarak me një eksperiencë mjaft cilësore. Si e vlerësoni ju këtë eksperiencë në FA?**

Ju falënderoj për mundësinë që po më krijoni për të biseduar me gazetën Tuaj kaq të nderuar, respektuar e vlerësuar, si një media pranë dhe për gjithë personelin dhe familjarët e ushtarakëve. Sigurisht, tashmë që po mbushen 30 vjet e kthen e mendon për vitet që kanë kaluar është e vështirë që të japësh një përgjigje të prerë. Është sa një eksperiencë dhe karrierë si e çdo ushtaraku tjetër po aq edhe specifike me veçori individuale me vështirësi dhe rezultate. Këto 30 vjet nisin atje në vitet e largëta, kur nuk ishim më tepër se 13-14 vjeç të veshur me ngjyrën e gjelbër dhe ecën nëpër rrugë sa të vështirë po aq edhe sfiduese.

Ndjehem mirë që rruga ime ka ecur gradualisht nëpër gjithë etapat e karrierës së një ushtaraku deri në rangun që mbaj sot, për të cilën çdo ushtarak e ka një objektiv të synuar. Si vartës e si epror, si koleg e si shok, si individ e si ekip, unë kujtoj jo vetëm detyrat e ndryshme, por edhe bashkudhëtarët që kemi pasur në krahë. Tashmë tani edhe në pozicionin e Komandantit të Forcave Tokësore unë ndjehem sa i vlerësuar po aq edhe i përkushtuar.

**Ju përmendët se gjatë karrierës keni kryer detyra të ndryshme, për një ushtarak në zinxhirin e drejtimit dhe komandimit, si**

**në fushën operacionale ashtu edhe në ato të përfaqësimit. Më herët në Përfaqësinë Ushtarake shqiptare në NATO, Bruksel, dhe më tej zëvendës-përfaqësues ushtarak në NATO, atashe ushtarak i mbrojtjes për Mbretërinë e Belgjikës dhe jo-rezident për Republikën e Francës, etj. Çfarë do të thotë për një ushtarak kur kryen këto detyra jashtë vendit në aspektin e përfaqësimit të FA-së?**

Vërtet është një numër i larmishëm detyrash, ku çdo njëra ka veçoritë e veta dhe dallon jo pak nga të tjerat. Pavarësisht se secila kërkon angazhim serioz dhe përkushtim të veçantë ato në çdo kohë përfaqësojnë sfida. Sigurisht që një detyrë operacionale nga një detyrë përfaqësimi dallojnë mjaft, sepse ndërsa në të parën aftësitë qëndrojnë veçanërisht në organizim dhe drejtim, në të dytën (përfaqësim) sfidat bëhen edhe më të mëdha, sepse ballafaqohesh në përfaqësimin e Forcave të Armatosura dhe të vetë shtetit. E ndërsa e para të jep mundësinë e rishikimit dhe përmirësimit, e dyta nuk të lejon të gabohesh në asnjë rast, sepse mundësia vjen vetëm njëherë.

**Duke u ndalur në detyrat që keni kryer së fundmi, z. gjeneral, ju keni pasur shansin dhe sfidën të keni qenë në pozicionin e drejtuesit si Komandant i Forcës Detare, më pas Komandant i**

**Komandës Mbështetëse dhe aktualisht Komandant i Forcës Tokësore. Cilën shihni si të përbashkëtën dhe dallimin midis tyre, apo edhe më tepër, me përvojën e një drejtuesi, cila detyrë është më 'pranë zemrës' tuaj, nëse krahasojmë?**

Çdo detyrë ka specifikat e veta, por edhe karakteristika të përbashkëta. Çdo njëra prej tyre, nëse kërkon ta realizosh cilësisht kërkon përkushtim dhe më tepër se individualitet kërkon punë në grup. Asnjë detyrë nuk realizohet individualisht por në gjithë zinxhirin e komandimit që nga niveli më i lartë e deri te ushtari apo punonjësi që ndodhet në pozicionin më të thjeshtë. Dallimet sigurisht që ekzistojnë, por ndoshta janë ato që e bëjnë edhe më interesant angazhimin. Dhe sigurisht që krahas vështirësive sot më jepet mundësia që të ndjehem edhe më afër për gjithë angazhimet që kanë forcat e armatosura, pavarësisht llojeve të tyre. Sa për 'zemrën' do të thosha që sukcesi për çdo detyrë kërkon që të afrosh 'zemrën', mendjen dhe vullnetin në çdo kohë.

**Ne e njohim vendin dhe rolin që luajnë Forcat Tokësore në strukturat e FA-së. Cilat mendoni ju, se janë disa nga detyrat kryesore me të cilat po angazhohen FT?**

Në respekt edhe të forcave të tjera, por edhe gjithë strukturave të FA-së, Forcat Tokësore mbajnë sot peshën më të madhe me detyra nga më të rëndësishmet, që nga zhvillimi dhe ruajtja e kapaciteteve për një nivel sa më të lartë gatishmërie, kjo jo vetëm për misionin e tyre por edhe për situatën mjaft delikate në rajonin tonë. Por detyrat tona nuk kufizohen vetëm në operacione, por edhe në detyra të tjera ku spikat ndihma ndaj komunitetit, veçanërisht në emergjencat civile, në rast fatkeqësish natyrore apo humane: që nga tërmete, përmbytje, zjarre avari të ndryshme në infrastrukturë e të tjera, pavarësisht nga koha dhe vendi. Po aq të rëndësishme janë edhe angazhimet në misione në kuadrin e aleancave e partnershipeve e veçanërisht që lidhen me NATO-n, BE-në, OKB-në e të tjera.

**Duke hyrë pak më thellë në strukturën e Forcës Tokësore: Komandën dhe Shtabin e FT apo dhe repartet e nën-**

**repartet, me të cilat ajo bën të mundur realizimin e misionit të saj. A mund të veçojmë një strukturë si më specifike?**

Me këtë pyetje ju më dhatë mundësinë që unë të përshëndes gjithë strukturat e Forcave Tokësore që nga Shtabi e deri në njësitë më të thjeshta, për punën e tyre cilësore, angazhimin e tyre të plotë dhe besimin që të realizojnë çdo detyrë pavarësisht nga shkalla e vështirësisë. FT punojnë si një zinxhir dhe mund të jenë të suksesshme vetëm si të tilla. Drejtues, ushtarë e punonjës janë po aq të rëndësishëm në misionin dhe detyrat që kemi apo që na afrohen në çdo kohë. Ato janë të veçanta në strukturë, apo në përbërje por të njëjta në rëndësi për misionin që kemi.

**Kalendari juaj i stërvitjeve duket mjaft dinamik. A do të veçonit disa prej tyre?**

Është e vërtetë që Forcat Tokësore kanë një kalendar nga më të ngjeshurit për stërvitje si forcë apo në kontekstin multinacional. Ndërsa në stërvitjet brenda vendit, fokusi kryesor janë stërvitjet dimërore, ujore dhe malore me kohëzgjatje të ndryshme. Në stërvitje multinacionale do të veçoja DEFENDER EUROPE 23, ku FARSH kishin një rol të veçantë specifikisht në TFS (Task Force South) dhe kam kënaqësinë t'ju informoj se e përfunduan cilësisht dhe me një angazhim dinjitoz së bashku me aleatët.

**Ju përmendët më lart që FT trajnon dhe merr pjesë me trupa në misionet e mbështetjes së paqes në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së apo edhe në formate të tjera. Në çfarë raporti i vendosni ju këto forca krahasuar me homologët e tyre?**

Nuk do të mjaftonte vetëm se si i vlerësojmë ne standardet që ato kanë arritur. Kontingjentet tona pa asnjë dallim pas stërvitjeve janë angazhuar për vite në mjaft operacione së bashku me aleatët, për të cilat kanë marrë prej tyre vlerësimet më cilësore jo vetëm për aftësi por edhe për përkushtim. Kjo i referohet standardit mjaft të lartë të stërvitjeve, me norma të njëjta me ato të angazhimit si edhe partnerët tanë. Ne jemi optimistë se, duke u bazuar në standarde të tilla në do të jemi në të njëjtin nivel në të gjitha operacionet dhe stërvitjet e përbashkëta.

**Cila është stërvitja e radhës dhe a jeni në koordinim edhe me strukturat e tjera të FA-së?**

Çdo vit vendet e Ballkanit organizojnë stërvitjen "Strong Balkan" ku pjesëmarrja e personelit të FT-së është e pandërprerë. Këtë vit ne jemi vendi organizator (mikpritës) për këtë stërvitje me pjesëmarrjen e 9 vendeve. Jam i sigurt që do të realizojmë me sukses këtë përgjegjësi, ku fokusi kryesor do të jetë shkëmbimi i eksperiencave në mbështetje të paqes në Ballkan dhe përforcimi i bashkëpunimit dhe operacionalitetit.

Ndërsa për sa i përket bashkëveprimit me strukturat e tjera është dinamik me ndjenjë të përbashkët përgjegjësie e cila na jep edhe më tepër mundësi për sukses.

Forca Tokësore është një nga strukturat më të suksesshme në dhënien e ndihmës së parë të popullsisë në përballimin e fatkeqësive natyrore me një mision sa mbresëlënës aq dhe frymëzues.

Është e vërtetë që ndihma e popullsisë na gjen të parët në përballimin e rrezikut. Njësitë tona i gjen në çdo kohë të motit dhe të terrenit pranë popullsisë dhe për këtë kemi marrë edhe vlerësimet më të mira nga strukturat qendrore dhe lokale të qeverisjes, por veçanërisht të vetë popullsisë në zonat e rrezikuara. Ne përgatitemi për këto detyra dhe kapërcejmë vështirësitë në çdo situatë. Për ne mbetet një detyrë e përhershme.

**Zoti gjeneral, që në fillim të intervistës përmendëm bashkëpunimin tuaj me median ushtarake. Ne ju gjemë në një numër titujsh si "Liria e Irakut" në 2006 dhe "Proceset integruese të Evropës Juglindore" në 2007, por edhe si autor dhe bashkautor në librin e botuar nga Universiteti Kombëtar i Inteligjencës në SHBA dhe Agjencia e Inteligjencës Ushtarake Shqiptare.**

**Është pasion kjo fushë?**

Pavarësisht se detyrat e ndryshme kanë qenë operacionale dhe kanë kërkuar mjaft kohë, përsëri mendoj se të gjithë ushtarakët duhet të jenë e të angazhohen me librin, si një nga miqtë dhe këshilltarët më të mirë. Sigurisht që pasioni ka rolin e vet, por edhe vullneti duhet të jetë pjesë e këtij angazhimi. Edhe njëherë ju falënderoj ju si media në nxitjen e këtij pasioni dhe në pasqyrimin që i bëni gjithë angazhimit të Forcave të Armatosura.

# ASLLAN ZEMANI:

## Kujtesa historike është palca e një kombi

Intervistoi:  
**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit të Botimeve

**D**r. Asllan Zemani, u lind në qytetin e Tiranës. Pas përfundimit të gjimnazit “Qemal Stafa”, vijoi studimet e larta në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1981 u titullua ‘oficer’.

Më pas emërohet në detyrën e shefit të stërvitjes në brigadën sulmuese në qytetin e Librazhdit, e më pas shef i stërvitjes në repartin ushtarak të qytetit të Lezhës. Pas rreth tetë vjetësh në këto detyra, ndoqi studimet në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë, pas të cilës emërohet komandant batalioni në njësitë e Tiranës. Boton shkrime nga aspekte të jetës dhe të veprimtarisë së repartit por edhe për historinë ushtarake dhe përvojën luftarake të popullit tonë në shekuj.

Me ndryshimet që po ndodhnin në ushtri dhe reformën që po bëhej hap pas hapi, në vitin 1993, për rezultate të dukshme emërohet punonjës shkencor dhe pedagog në Akademinë e Mbrojtjes, në departamentin e Historisë Ushtarake. Ishte kjo një mundësi e mirë për të thelluar më tej njohuritë dhe për të filluar një punë kërkimore shkencore, ku vetë institucioni i Akademisë e kishte përparësi. Krahas punës si pedagog në lëndën e historisë ushtarake, filloi dhe përgatitjet për provimin universitar për lëndën “Historia e shek. XX”, në Fakultetin e Historisë në Universitetin e Tiranës, studime në Arkivin e Shtetit dhe në Arkivin e Forcave të Armatosura.

Në vitin 2000, paraqiti temën e disertacionit “Organizimi i formacioneve ushtarake të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare” dhe



mori gradën shkencore “Doktor i shkencave në fushën ushtarake”. Në të gjithë këtë rrugëtim, mbi 40 vjet në shërbim në FA-së, ka botuar mjaft shkrime, kumtesa, studime dhe libra të publikuar. Është bashkautor në librat e publikuar si “Personalitete ushtarake shqiptare në vite” (1912-1997), vëllimi 1, “Historia e Ushtrisë Shqiptare”, (Organizimi), 1912-1944, vëllimi I, “Albanian Armed Forces in Photos”, “the History, Graziani Arti Gra-fiche-Corato” Bari, Itali dhe “Agresion ushtarak, gusht ’49”.

Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 2008, është autor i disa zërave të mesëm dhe zërave të vegjël të botuar.

Dr. Asllan Zemani prej vitesh përgjegjës i

Muzeut të Forcave të Armatosura, njohës dhe studiues historik i aseteve të këtij institucioni, sot në pension, por gjithmonë me pasionin dhe dashurinë për këtë vlerë të ushtrisë shqiptare, vjen për gazetën ‘Ushtria’ në Ditën Botërore të Muzeve, me një pasqyrim të plotë të aktivitetit dhe vizionit për të ardhmen e këtij institucioni të rëndësishëm të historikut të Forcave të Armatosura.

**Z. Asllan, pse është caktuar 18 maji ‘Dita Ndërkombëtare e Muzeve’?**

Data 18 maj është Dita Ndërkombëtare e Muzeve në mbarë botën. Në vitin 1977, me Rezolutën Nr.12 të Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve (ICOM) është caktuar 18

Maji, si “Dita Ndërkombëtare e Muzeve”. Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve, që varet nga UNESCO, ka ndihmuar në ngritjen e nivelit shkencor të muzeve përmes botimeve të ndryshme, veçanërisht në përcaktimin e kriterëve dhe standardeve për trajtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Më shumë se 30 000 muze në rreth 100 vende të botës, përfshirë edhe vendin tonë, angazhohen me aktivitete të larmishme me rastin e kësaj dite. Edhe për Muzeun e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Dita Ndërkombëtare e Muzeve ka qenë një ditë e shënuar me një aktivitet origjinal gjithëpërfshirës. Në këtë kuadër është përgatitur dhe realizuar “Dita e Hapur”, çdo vit, me objektivin e qartë për të promovuar vlerat historike të Forcave të Armatosura jo vetëm tek ushtarakët, por në mbarë shoqërinë e interesuar për këtë qëllim nëpërmjet objekteve muzeore të shumtë dhe të cilët përbëjnë Historinë e Ushtrisë Shqiptare.

#### **Kur filloi aktivitetin e tij, Muzeu i Forcave të Armatosura?**

Në kufijtë e mbylljes së një shekulli jete të pandërprerë juridikisht si shtet dhe si Forca të Armatosura më së fundi, në korpusin e ndërtesave muzeale për nga vlerat, të KDS-së (tani të M. Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së) u krijua institucioni i Muzeut të FA-së, ku në zanafillën e tij gradualisht po kristalizojnë arkivimi i historisë së këtij shekulli jete për Forcat e Armatosura, ashtu siç është kjo periudhë ekzistence, me të mirat e me problemet e saj, me lavdinë dhe me dështimet. Historia e varësisë të këtij institucioni për herë të parë nga Ministria e Mbrojtjes (atëherë Ministria e Mbrojtjes Popullore) e ka zanafillën e vet menjëherë pas dekadës së parë pas çlirimit të vendit, tashmë siç dihet e emërtuar “Muzeu i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare”. Më pas, në vitet ’60, kemi rritje në numër të muzeve nëpërmjet dy tipologjive të tyre, në muzetë historikë të Armës (shërbimit), i Aviacionit, i Tankeve, i shërbimit të ndërlidhjes, dhe muzetë historikë të Njësive, të cilat kryesisht hapat e para të tyre i kishin si ekspozita të thjeshta me të dhëna historiko - dokumentare nga jeta dhe veprimtaria e njësive përkatëse dhe më pas në vitet ’70 ato morën karakterin e muzeut, duke u përsosur vazhdimisht. Ndihmesë spikatëse për këto ka dhënë

muzeologu Major Riza Drishti. Fatkeqësisht i gjithë ky rrjet i dendur i muzeve, ku konservohej dhe ekspozohej vetë identiteti, historia dhe veprimtaria e një pjese të historisë së Forcave të Armatosura, u harruan deri në dëmtim e vjedhje qysh në fillimet e viteve ’90, duke lënë Ushtrinë Shqiptare pa një “shtëpi” ku të ruhej dhe të ekspozohej historia dhe tradita e saj në fushën ushtarake, fushë ku nga shumë studiues pranohet dhe shumë fakte historike vërtetohet se, gjendet një pjesë shumë e rëndësishme dhe përfaqësuese edhe e historisë së kombit shqiptar.

Kujtesa historike është palca e një kombi, sepse pa të nuk mund të projektosh asgjë për të ardhmen. Po nuk dite se nga vjen si do të dish ku do të shkosh? Kjo sentencë shumë domethënëse për ndërtimin e një Muzeu ndoshta Kombëtar Ushtarak, ishte ngacmim ngulmues qysh në fund të viteve ’90 nga historianët ushtarakë, duke u kurorëzuar me ngritjen e një komisioni nismëtar me në krye ushtarakun, studiuesin dhe pedagogun e vjetër të Historisë Ushtarake dhe të Forcave të Armatosura, koloneli, prof. dr. Proletar Hasani.

Në kujdesin e veçantë të z. Pandeli Majko (atëherë Ministër i Mbrojtjes) kjo nismë u kurorëzua me miratimin e një drafti, të konsultuar me muzeologë me eksperiencë, mbi të cilin do të bazohej e gjithë përmbytja e muzeut. Njëkohësisht u bë edhe përmirësimi i terrenit për të përzgjedhur se ku do ndërtohej ky institucion, duke patur parasysh sipërfaqen relativisht të madhe për shtrirjen e tij. Më pas heshtje dhe me këmbënguljen e grupit nismëtar, më 3 nëntor 2008, u zhvillua edhe një konferencë për ndërtimin e Muzeut Historik Kombëtar me ushtarakë të lartë të FA-së si dhe një personel i specializuar, që kishte përgatitur edhe referatet e punën e paraqitur për ndërtimin e këtij muzeu, i cili më së fundi filloi funksionimin në prag të festimit të 100-vjetorit të Pavarësisë dhe 100-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Shqiptare, më 4 dhjetor 2012.

#### **Cilat janë vlerat institucionale dhe edukative që ofron ky muze?**

Tashmë në këtë fillim shekulli muzetë në tërësi, këto institucione kulturore-studimore dhe edukuese, po konsiderohen e përcaktohen në dritën e një vizioni të ri, kthimin e tyre në platforma komunikimi të standardeve bashkëkohore. Për këtë

edhe stafi i institucionit për përgatitjen e këtij projekti për perspektivën e zhvillimit të Muzeut të Forcave të Armatosura u mbështet në këto politika, të cilat janë:

- Respekto të shkuarën për të ndërtuar të ardhmen;
- Vizioni i ri - kthimi i muzeve në platforma komunikimi të standardeve bashkëkohore;
- Muzeologjia-shkencë për edukimin e brezit të ri me trashëgiminë kulturore;
- Muze për të gjithë, muze pa barriera - prioriteti i muzeologjisë në mbarë botën.

Postulati, respekto të shkuarën për të ndërtuar të ardhmen, me një përhapje të gjerë në botën e qytetëruar ka nisur të ngacmojë edhe ndjeshmërinë e shoqërisë shqiptare gjatë viteve të fundit. Komunikimi kulturor tashmë konsiderohet si një proces social i rëndësishëm me ndikim të dukshëm në zhvillimin e vendit. Në një shoqëri të hapur me komunikim dhe teknologji të zhvilluar, institucionet e kulturës luajnë një rol parësor, jo vetëm si instrumente zhvillimi, por edhe si referenca të rëndësishme historike që na orientojnë në formimin e identitetit kombëtar.

Pikërisht komunikimi nëpërmjet muzeve dhe krijimi i lidhjeve mes muzeologjisë dhe shoqërisë konsiderohet sot më shumë se domosdoshmëri. Nëpërmjet koleksioneve që prezantojnë, muzetë evokojnë vlera të mbijetesës së qytetërimeve në shekuj, duke i transmetuar ato te brezat e rinj si një trashëgimi e pazëvendësueshme. Për këtë, tashmë kemi një vizion të ri, i cili kthen muzetë në platforma komunikimi të standardeve bashkëkohore.

Vizioni modern nuk i koncepton muzetë vetëm si destinacione të vizitueshme, por i përcakton si qendra potencialisht edukative. Kjo nënkupton që vizitorët jo vetëm të informohen, por edhe të përfshihen në programe kreative e kërkimore. Pavarësisht nga misioni i tyre specifik si muze ushtarakë, ato janë edhe qendra komunikimi dhe perceptimi të diversitetit kulturor për vizitorët.

Muzetë janë institucione ku njerëzit shkojnë jo vetëm për t'u informuar por edhe për të mësuar. Përqasja e aktiviteteve muzeale me programet e shkollave është një parim i rëndësishëm për mirëfunksionimin e një muzeu. Muzeologjia është një shkencë e re për realitetin shqiptar, ndaj sot shtrohet si domosdoshmëri futja e koncepteve të reja për edukimin e brezit të ri me trashëgiminë

kulturore, ku muzetë dhe sitet arkeologjike zënë vendin kryesor.

'Muze për të gjithë', ky është edhe një prioritet i veçantë muzeologjisë në mbarë botën. Ekspozitat interesante dhe tërheqëse, interpretimi profesional i koleksioneve, respektimi i diferencave intelektuale, janë disa nga veprimtaritë që rrisin vizitueshmërinë. Shekulli 21 ka nisur me objektiva të qarta për menaxhimin e muzeve, por edhe për shumë drejtues të muzeve kombëtarë dhe lokalë në vende të ndryshme të botës, që kanë kuptuar plotësisht rëndësinë e këtyre institucioneve në zhvillimin e kulturës.

Synimi i stafit të Muzeut të FA-së ka qenë i orientuar gjithmonë në realizimin e misionit nëpërmjet vizionit modern e bashkëkohor të muzeve, duke kthyer gradualisht Muzeun e FA-së në një qendër potenciale edukative nëpërmjet prezantimit dhe propagandimit të vlerave historike të Forcave të Armatosura Shqiptare, qysh nga lindja e deri në anëtarësimin e tyre në NATO e më gjerë mbi bazën e një rikonceptimi të ri e të ndryshimit të formatit të ekspozitës në institucion muzeal, duke synuar nivelin e Muzeut Kombëtar të FA-së.

#### **Si janë të ndara pavijonet dhe cili është burimi i koleksioneve të këtij muzeu?**

Muzeu ynë, ndonëse ka pak më shumë se një dekadë që ka filluar aktivitetin, është i pasur dhe i veçantë në llojin e tij në të gjithë rrjetin muzeor kombëtar.

Kjo ndërtesë e Muzeut të FA-së me stil ndërtimi që i përket atij të periudhës musoliniane (fashiste), është pjesë përbërëse

e projektit dhe ndërtimeve të Kasermës dhe të Fushës së Xhenios, e projektuar nga Zyra e punimeve të Xhenios të Armatës pas bashkimit të shtetit dhe të Forcave të Armatosura Shqiptare me ato të Italisë fashiste. E gjithë kjo sipërfaqe arriti në afro 180.000m<sup>2</sup>, në vitet 1939-1941 të shekullit të shkuar. Pikërisht në një nga këto ndërtesa, që shërbenin për depo, magazina apo ofiçina është ngritur edhe Muzeu ynë, i cili është i përbërë nga dy pjesë: nga Muzeu i Brendshëm, me hapësirat përkatëse prej rreth 1000m<sup>2</sup> si dhe Muzeu i Hapur, që ndodhet kryesisht në pjesën e pasme të kësaj ndërtese, ku janë të vendosur të gjitha kalibrat e armëve të artillerisë tokësore e kundërajrore si dhe parku i mjeteve luftarake dhe të transportit të Ushtrisë Shqiptare. Muzeu ishte ideuar dhe fatkeqësisht u zbatua si një ekspozitë armatimi fare e përkohshme për 2 deri në 3 muaj pa ndarje të domosdoshme të historisë, sipas periudhave historike që ka kaluar organizimet e Ushtrisë Shqiptare.

Ky muze përbëhet nga tre pavijone: Holli qendror, Pavijoni i Epokës 1450-1944 dhe Pavijoni i Luftës së Ftohtë:

#### **Holli qendror i këtij Muzeut**

Në këtë hapësirë, që shërben edhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme përkujtimore apo për hapje ekspozitash me tematikë të ndryshme, janë vendosur fotot e të lidshimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së sipas periudhave kohore respektive të drejtimit të këtyre dy institucioneve kryesore të Ushtrisë Shqiptare, në krahun përballë

ndodhen dy ekspozitorë me emblema apo stema të dhuruara nga personalitete apo vizitorë të ushtrive të ndryshme pjesëtarë apo jo të NATO-s si dhe të vizitorëve vendas. Në skajin tjetër ndodhet këndi me objekte muzeale që së bashku me pianon, janë përdorur në periudhën e para viteve '90 nga ish-Shtëpia Qendrore e Ushtrisë. Objekti muzeal, që ndodhet në qendër të muzeut me elemente artistike, është një ekzemplar i Raketës Sam-2, prodhim kinëz, pjesë përbërëse e Forcave të Armatosura Shqiptare në vitet 1960-1990.

#### **Pavijoni i periudhës 1450-1944**

Në këtë pavijon janë ekspozuar objekte muzeale të përdorura gjatë periudhave më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, duke filluar me armë të përdorura në periudhën e Skënderbeut e deri tek armët trofe të Luftës së Dytë Botërore.

#### **Pavijoni i Luftës së Ftohtë**

Në këtë pavijon janë ekspozuar objekte muzeale të Ushtrisë Shqiptare të periudhës së viteve 1945 deri në 1990. Gjejnë pasqyrim që nga fishekët e kalibrat më të vogël deri tek mortajat e lehta dhe granatahedhësit. Janë ekspozuar objekte muzeale të tre forcave kryesore ushtarake, Forca Tokësore, Detare dhe Ajrore.

Gjithashtu janë pasqyruar objekte muzeale të armëve dhe shërbimeve të ndryshme në ushtri si: logjistika, transporti, xhenio, ndërlidhja, kimia dhe shëndetësia.

Përveç objekteve muzeale të periudhës së komunizmit janë ekspozuar pushkë dhe pistoletat të viteve 1900-2000.

- Me mjaft interes për vizitorët është mënyra e paraqitjes së predhave të kalibratit të rëndë, minave, granatave të dorës, të cilat qëndrojnë të vendosura në kutitë e tyre e shprehin qartazi masivitetin e depove të municioneve dhe tuneleve nëntokësorë në të gjithë Shqipërinë. Sapo futesh në këtë pavijon hasesh me ekspozimin e një numri të madh helmesh që të sjellin ndërmend paradat ushtarake të zhvilluara në vitet 1980-të.

Interesante është harta me relief Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Greqisë.

Kjo hartë është përdorur në Akademinë Ushtarake për procesin mësimor, ku studentët mësonin taktikën ushtarake duke iu bazuar relievit. Avio-shenjë është përdorur gjatë stërvitjes për qitje të artillerisë kundërajrore, i cili shërbente për tërheqjen e objektivit të qitjes.



Në këtë pavijon shohim një kabinë piloti Mig-21, ky ishte avioni reaktiv më modern i Flotës sonë Ajrore.

Çadër fushore, për të sjellë në kujtesë fushimet dhe zborët e ushtrisë, është ngritur kjo çadër fushore.

Në hyrje të muzeut, në pozicionin vertikal është vendosur raketa Sam-2. Kjo raketë është prodhuar në Kinë dhe është përdorur në FA në vitet 1960-1990.

#### **Pavijoni i katit të dytë**

Arsimimi, në disa stenda të vendosura në katin e dytë, është pasqyruar historiku i arsimimit ushtarak shqiptar. Historiku i arsimimit fillon me hapjen e Shkollës së Mesme Ushtarake "Skënderbej" në 1945, vazhdon me Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në 1946, Akademinë e Mbrojtjes, Akademinë e Aviacionit, Akademinë e Marinës dhe Akademinë e Nënoficerëve në 1995.

*Këndi i Forcave Speciale dhe i Batalionit Komando.* Në këtë kënd janë pasqyruar aspekte të forcave speciale dhe forcave komando gjatë misioneve paqeruajtëse në vende të ndryshme. Këto dy forca janë të ilustruara me foto dhe uniformat përkatëse.

*Jeta artistike.* Këndi i objekteve muzeale të jetës artistike kulturore në Forcat e Armatosura në vitet 1950-1990. Kryesisht këto objekte janë kostume popullore, aparate fotografikë dhe filmimi.

*Këndi i sportit.* Sporti dhe përgatitja fizike kishin një rëndësi të madhe në FA. Pas çlirimit të vendit, brenda FA-së u formua klubi shumë-sportesh "Partizani".

*Toporelievi i vendit tonë.* Në pavijonin e katit të dytë është vendosur një toporeliev gjigand, i ndërtuar i gjithi me dorë nga Instituti Gjeografik i Ushtrisë. Për ndërtimin e kësaj harte janë dashur 10 vjet punë. Kjo hartë e shkallës 1:50.000 përfshin Shqipërinë, Kosovën, një pjesë të madhe të Maqedonisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Ky toporeliev, paraqet të gjitha format e relievit, qendrat e banuara, rrjetin hidrografik, rrjetin rrugor dhe hekurudhor.

#### **Pavijoni i Jashtëm**

Në pavijonin e ambientit të jashtëm të muzeut janë vendosur armë të rënda të artillerisë, mjete të transportit, tanke, avionë reaktivë Mig-19 dhe Mig-21, helikopterë, 4 silurus si dhe një bunker i vogël. Pjesa më e madhe e këtyre objekteve janë prodhime kineze.

#### **A realizohet mirëmbajtja e tyre dhe cilat janë teknikat, kur bëhet fjalë për koleksione të një rëndësie të veçantë?**

Meqenëse fondi bazë i objekteve muzeore i armëve apo pajisjeve i përkasin periudhës historike të viteve 1945-1990, mendoj se ato do të jenë hëpërhë baza e këtij muzeu, të cilat janë vendosur sipas periudhave të organizimit të Ushtrisë Shqiptare, të ndarë me pavijone apo mini-pavijone në vartësi të sasisë së tyre. Të gjitha objektet muzeore të periudhës së përcaktuar që do të vendosen në hapësirat e brendshme të muzeut të vendosen të grupuara, objektet muzeore të armatimit konvencional së bashku edhe me pajisjet e shërbimeve si prapavija, ndërlidhja, kimia, xhenio etj.

Në tërësinë e tyre, ky arsenal i objekteve muzeore, mirëmbahen dhe pastrohen nga stafi i këtij institucioni. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Rep. Ush. 4009, bëhet herë pas here rinovimi i pjesëve të ndryshme të këtij armatimi apo dhe lyerja e mirëmbajtja kryhet sipas një grafiku të hartuar me këtë njësi.

#### **Cilat periudha të Historisë Ushtarake Shqiptare datojnë këto koleksione të muzeut?**

Siç përmenda më parë, fondi bazë i objekteve muzeore, i armëve apo pajisjeve të tjera, i përkasin periudhës historike të Ushtrisë Shqiptare të viteve 1945-1990, të cilat sipas fazave të organizimeve të saj janë vendosur sipas kësaj kronologjie:

**a.** Ushtria Kombëtare Shqiptare, 1945-1954; (Faza e parë) ku kemi krijimin e aviacionit ushtarak (24 prill 1951); më 1953 shërbimin kimik, radio-zbulimin etj.; njëherësh u ringrit Marina Luftarake, tanket, artilleria, transporti, prapavijat e të tjera; arsimimi ushtarak.

**b.** Ushtria Popullore Shqiptare, 1955-1965; (Faza e dytë) hyrja në Traktatin e Varshavës, 14 maj 1955 dhe dalja, shtator 1968. Ushtria Shqiptare u fuqizua me teknikë luftarake si topa obuzë, tanke, autoblinda, artilleri vetëlëvizëse (AVL), katër-silurues, mjete speciale drejtimi, ndërlidhje, xheniere, prapavije etj. nga ish-Bashkimi Sovjetik.

**c.** Ushtria Popullore Shqiptare, 1966-1975; shtimi me pajisje e armatime e teknika të reja luftarake kineze;

**d.** Ushtria Popullore Shqiptare në vitet '70-'80; hartohet për herë të parë plani operativ-strategjik, tekstual dhe grafik, për

mbrojtjen e vendit;

**e.** Ushtria Popullore Shqiptare në vitet 1982-1990; futen shumë armë dhe teknikë e rëndë, si tanke dhe artilleri të prodhimit kinez, të cilat e rritën dukshëm fuqinë e saj edhe në rajon.

Paraqitja e këtyre objekteve me vlera historike, shkencore dhe kulturore, në radhë të parë janë të siguruara, të mbrojtura nga dëmtimet, vjedhjet, lagështira, thatësira, drita e diellit dhe pluhuri, si dhe njëkohësisht deri diku kanë një ndriçim optimal që ato duken mirë. Të gjitha objektet, janë të ndara nga ato për studim tek ato objekte për ekspozim. Njëkohësisht është bërë një selektim i kujdesshëm i materialeve, apo vendosje e tyre e rregullt në hapësirë, nëpër ambiente me formë të përshtatshme por edhe me një rrjedhë logjike sa më interesante. Vendosja e tyre është bërë duke zbatuar rregullin, që këndi i të parit normal fillon 27° nga niveli i syve dhe gjerësia dhe lartësia e ambienteve i përgjigjet kësaj norme. Ndërsa varja e stendave të veçanta nëpër mure është rreth 3 - 5 m<sup>2</sup>, ndërsa ato që i përkasin një epoke të tërë, në mungesë të objekteve muzeore siç është periudha e Skënderbeut, shkojnë 6 - 10 m<sup>2</sup>/copë. Ndërsa vendosja e mjeteve të rënda janë bërë mbi bazamente betoni të ndërtuara në përputhje me peshat, tipin e rrotave etj.

Për ambientet e muzeut, cilësia e ndriçimit është vendimtare. Meqenëse në këtë ndërtesë nuk është parashikuar sa e si duhet ndriçimi artificial, më shumë dominon ndriçimin natyral me dritare të vendosura në të dy faqet e ndërtesës. Mendoj dhe shpresoj se këto rregulla mjaft strikte do të zbatohen në Muzeun e ri, në Bërzhitë.

#### **Cilat janë pavijonet që kanë problem në konceptim dhe duhet të rishikohen?**

Tërësia e pavijoneve të muzeut kanë nevojë për rikonceptim apo për ndriçim, por edhe një sërë rregullash strikte që të marrë formën e plotë të një muzeu. Por, sipërfaqja e vogël në raport me numrin e madh të objekteve muzeore por edhe mungesave të tjera të mirëmbajtjes së objektit e kushtëzojnë shumë zgjidhjen e këtyre problemeve. Por në muzeun e ri shpresoj që të plotësohen dhe të jetë një muze bashkëkohor.

#### **Sa i frekuentuar është Muzeu i FA-së nga turistët vendas apo të huaj qofshin ata?**

Qasja ndaj komunitetit dhe shoqërisë sonë, është një tjetër fokus, i cili ka për qëllim të



specifikojë vlerat të cilat i mbartim prej shekujsh, të artit dhe të kulturës, në raport me vlerat shoqërore, por jo në vlera ekonomike.

Një nga prioritetet strategjike, i cili vazhdon dhe mbetet edhe tani është "Njohja, përhapja dhe promovimi i vlerave të trashëguara të Ushtrisë Shqiptare si dhe ato kulturore, artistike, në shërbim të brezave të rinj, shoqërisë sonë, nëpërmjet grumbullimit, konservimit dhe të ekspozimit të vlerave më të çmuara dhe autentike, që lidhen drejtpërdrejt me historinë, trashëgiminë dhe identitetin e Forcave të Armatosura. Muzeu si institucion ka nënshkruar disa marrëveshje, me universitete publike dhe private, për një bashkëpunim ku shkëmbimi, organizimi, promovimi, kërkimi dhe studimi, planifikimi apo projektimi i shumë aktiviteteve, seminareve, trajnimeve, të përbashkëta etj. Muzeu, me koleksionet e tij, ekspozitat, aktivitetet e ndryshme, cilëson veten si një institucion dinamik, i cili rriti dhe vlerësoi jetën kulturore të komunitetit tonë. Ndërkohë, promovimi në rrjetet sociale, në formatet video ose foto, është gjithashtu një domosdoshmëri dhe një sprovë për të qenë në qendër të vëmendjes. Krahas promovimit dixhital, në MFA mund të aplikohen dhe forma të tjera dhe të reja teknologjike.

**A kemi një numër të përafërt të vizitorëve në një ditë në Muze dhe në cilat periudha interesi është më i lartë?**

Si rezultat i intensifikimit të masave të përmendura më sipër, në periudhën para pandemisë u rrit së tepërmi numri i vizitorëve vendas por edhe të atyre të huaj, të cilët me anë të e-mail-ëve rezervonin datat e vizitave të tyre.

Me gjithë përpjekjet tona por edhe të drejtorisë nga kishim varësinë nuk mundëm që të thjeshtonim rregullat e hyrjes dhe daljes të vizitorëve vendas dhe të huaj. Në rastin më të mirë vizitorët e ndryshëm, vendas e të huaj, që tregonin interes të madh për Muzeun e FA-së, arrinin rreth 6000 deri 7000 vizitorë në muaj. Madje ka pasur raste që një pjesë e këtyre vizitorëve kanë zhvilluar dhe orë mësimi për njohjen e Historisë Ushtarake apo të Forcave të Armatosura Shqiptare si Shkolla "Çajupi", "Sami Frashri" por edhe shkollat private të këtyre niveleve. Njëkohësisht është bashkëpunuar edhe me Fakultetin e Historisë, dhe pothuaj 3-4 vitet e fundit, 3-4 studentë

bëjnë praktikën 1-2 mujore tek muzeu.

**Grupmosha më e shpeshtë e vizitorëve dhe çfarë pëlqejnë më shumë?**

Interes të madh për këtë muze në tërësi tregonin të gjitha grupmoshat, por sidomos nxënësit e arsimimit parauniversitar shfaqnin interes të veçantë, madje e shoqëronin edhe me pyetje specifike që tregonte se ata kishin lexuar para se të bënin vizitën në këtë muze.



**Nëse flasim për turistët e huaj, cilat nacionalitete janë më të interesuara për të njohur vlerat historike të Ushtrisë Shqiptare përmes objekteve?**

Interesim dhe vizita të shumta kishim grupe vizitorësh perëndimorë, si anglezë, francezë, italianë, amerikanë, danezë, suedezë, finlandezë, gjermanë etj. Interesimi i tyre ishte kryesisht tek tipologjia e armatimeve konvencionale apo edhe për llojet e kalibrave të ndryshëm të artillerisë tokësore e kundërajrore. Kishte shumë syresh që kishin njohuri për të dhënat tekniko-taktike të armatimeve të ndryshme, të cilat në muze janë objekte muzeore.

**Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballet ky institucion?**

Tashmë në këtë fillim të dekadës së tretë të shekullit të 21-të, muzetë në tërësi, këto institucione kulturore-studimore dhe edukuese, po konsiderohen e përcaktohen në dritën e një vizioni të ri, kthimin e tyre në platforma komunikimi të standar-

deve bashkëkohore.

Për këtë, edhe stafi i institucionit vijojnë ecurinë e implementimit të këtij projekti, për perspektivën e zhvillimit të Muzeut të Forcave të Armatosura në bashkëpunim edhe me Muzeun Historik Kombëtar por edhe me institucione të rrjetit muzeor po bënë përpjekjet e duhura për zbatimin e tij. Audio-guida është projekti i parë, është domosdoshmëri për vizitorët për t'u njohur

më mirë me përmbajtjen e muzeut me anë të audio-guidave në gjuhë angleze dhe atë shqip, siç janë pajisur edhe muzetë më të mirë europianë. Kjo paraqet vështirësi të shumta sepse tipologjia e Muzeut të FA-së është e veçantë, si nga madhësia e hapësirës, kronologjia historike, numri i lartë i objekteve dhe gjithashtu larmia e pavijoneve, gjithmonë flas për implementimin e tij në muzeun e ri të Bërzhitës. Në këtë aplikacion mund të krijohen edhe disa kategori, ku e para është audio-guida, e dyta është galeria e fotove, lajmërimet mbi aktivitetet e muzeut etj. Të vendosur në disa tabletë 10 inch, të pajisur me kufje, ku çdo vizitor mund ta marrë atë dhe ta përdorë guidën individuale në audio në dy gjuhë.

Një sugjerim tjetër që mund të bëja është edhe marrëdhënia e muzeut me donatorët, duhet ngritur e forcuar dhe më pas të zgjerohet nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme bashkëpunuese.

# "Akademia e Forcave të Armatosura, garanci për të ardhmen e sigurt"

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI

**A**kademia e Forcave të Armatosura ka dhënë një kontribut efektiv për të arsimuar, edukuar brezat e rinj si dhe për të trajnuar kuadrot oficerë dhe civilët e FA-së dhe institucioneve të tjera të sigurisë, në të gjitha nivelet e komandimit e të drejtimit.

Fokusi themelor i AFA-së është edukimi dhe kualifikimi i oficerëve dhe civilëve, i cili është domosdoshmëri për përgatitjen dhe zhvillimin inovativ të lidhshpët ushtarak për të gjitha nivelet e drejtimit. AFA siguron dhe garanton edukim themelor të nevojshëm për profesionalizmin e oficerëve në të gjitha nivelet si dhe ekspozimin e ideve të reja në karrierën ushtarake.

Me kurset dhe programet e ofruara nga AFA, sigurohet edukimi dhe trajnimi i oficerëve të FA-së si dhe investohet për përgatitjen dhe zhvillimin e tyre në të gjitha nivelet e drejtimit. Koncepti i edukimit dhe arsimimit në AFA fokusohet në detyrimet që shtrohen përpara një force anëtare të NATO-s, në kërkesat aktuale dhe të së ardhmes të FA-së, zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor ushtarak, për ta bërë atë sa më cilësor e fleksibël, në funksion të zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe në përgatitjet për t'iu përgjigjur sfidave, realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë.

Objektivi parësor i AFA-së është mbështetja me burime njerëzore të mirë arsimuara, aftësimi profesional i personelit të FA-së në funksion të rritjes së kapaciteteve operacionale në interes të realizimit të misionit, si dhe kontribuimit në zgjidhjet e çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes në rrafshin kombëtar, rajonal dhe të Aleancës Euroatlantike. AFA, ka shkruar histori suksesi, pasi ajo ka përgatitur dhe vazhdon të përgatisë me dhjetëra LIDERË, siç janë dhe 80 studentët e ciklit Bachelor, të cilët diplomohen sot për të ecur përkrah profesorëve të tyre me dinjitet dhe përkushtimi ashtu siç është dhe motoja e tyre "Atdheu, Nderi, Familja".

Në emocionet e kësaj dite të bukur të diplomimit, për gazetën 'Ushtria' ne mundëm t'i marrim një intervistë njërit prej studentëve, i cili na përcolli momente të këtyre tre viteve studimi si dhe mirënjohjen për liderin politik por dhe ata ushtarakë të cilët i kanë dhënë vëmendjen maksimale arsimimit dhe kushteve të jetesës brenda ambienteve të garnizonit.

## Si quheni?

Quhem Pashk Preçi, 23 vjeç, kam lindur në Mirditë, banoj në Lezhë. Shkollën 9-vjeçare e kam përfunduar në Lezhë, ndërsa kam kryer shkollën e mesme profesionale në Shkodër, në degën



Elektroteknikë. Pasi përfundova shkollën e mesme nuk isha i vendosur në lidhje me arsimin e lartë, se ku do ta kryeja, këtu në Shqipëri apo jashtë saj.

## Pse keni zgjedhur pikërisht të studioni pranë Akademisë së Forcave të Armatosura?

Kisha një eksperiencë jashtë Shqipërisë për një periudhë 3-mujore, por nuk u gjenda mirë, ndaj vendosa të kthehesha sërish në Shqipëri.

Përveç shërbimit të detyrueshëm ushtarak, asnjë nga familjarët e mi nuk ka pasur një eksperiencë në Forcat e Armatosura. Kur isha duke kërkuar një orientim për arsimimin e lartë, sapo ishte hapur opsioni i studimit në shkenca ushtarake, ishte brezi i parë. Të jem i sinqertë, në fillim e zgjedha si alternative për të plotësuar dhjetë degët me zgjedhje që duhet të vendosja në formularin e aplikimit për shkollën e lartë. Kur pashë që isha kualifikuar, e pranova menjëherë dhe fillova të hulumtoja në internet për të



marrë informacion rreth Forcave të Armatosura. Ishte më shumë forca e kuriozitetit, sepse ishte diçka krejt e panjohur për mua, e panjohur edhe nga rrethi shoqëror, pasi ishte brezi i parë që hapte këtë akademi, pas shumë vitesh ndërprerje. Së dyti ishte dëshira për të investuar tek e ardhmja ime, në përmirësimin e në forcimin e karakterit, në formimin e përgjithshëm, sepse FA-të kanë impakt të madh në jetën civile, siç thuhet nga anët tona: “ushtria të burrëron”. Pra, mendova se ky ishte investimi më i mirë për veten.

#### **Ishte një zgjedhje e dëshiruar nga ju?**

Po, ishte zgjedhja ime. Dhe nuk jam zhgënjyer. Kur erdha në ambientet e garnizonit ‘Skënderbej’ u përballa me rregullin dhe disiplinën aq të rëndësishme për të gjithë, e cila na bën qytetarë me edukatë europiane, pjesë e së cilës presim dita-ditës të aderojmë.

#### **Çfarë mendoni se do të sjellë për ju ky profesion?**

Të qenit në uniformën ushtarake, është një përvojë e madhe mjaft sfiduese. Aktivitetet e studentëve nuk kanë të ndalur, mundësitë për të zhvilluar veten në sferën që ka përcaktuar një student janë të shumta. E rëndësishme është vetëm sa njeriu të arrijë ta menaxhojë kohën në mënyrë sa më racionale. Një tjetër përparësi që të jep studimi në këtë akademi janë mundësitë për t’u njohur me njerëz profesionistë që të ndihmojnë në çdo hap, krijimi i lidhjeve me njerëz që kanë vizione të mëdha për të ardhmen dhe bashkëpunimi me ta. Ajo që kam mësuar gjatë viteve të studimit është pavarësia, pjekuria dhe formësimi i një karakteri, ku gjërat i sheh me një sy kujdesi të ç’do detaji.

#### **Çfarë e motivon një ushtarak?**

Nuk ka rëndësi sa fuqi, brilancë ose energji kemi, nëse nuk e shfrytëzojmë atë dhe nuk fokusohemi në një objektiv specifik, nuk do arrijmë të përbushim asnjëherë synimet tona.

Prandaj ajo që më motivon mua si oficer janë: Nevoja për të ecur përpara, për të arritur marrëdhënie dhe vendosur standarde apo për të arritur suksese.

Nevoja për t’i bërë të tjerët të sillen në një mënyrë që ata s’do të kishin mundur të silleshin ndryshe.

Dëshira për kontakte miqësore dhe të afërta personale. Dëshira për t’u pëlqyer dhe pranuar nga të tjerët. Preferenca për marrëdhënie bashkëpunuese sesa marrëdhënie konkurruese dhe dëshirë për marrëdhënie të cilat përfshijnë një gradë të lartë mirëkuptimi. Është e rëndësishme të mos të ngatërrojmë këto nevoja të ndryshme. Nevoja për rezultate nuk është domosdoshmërisht një fakt për të krijuar drejtues të mirë, mbase ata mund të jenë më të interesuar në performancën personale sesa në influencimin e të tjerëve.

#### **Pas një cikli trevjeçar, ju patjetër keni dhe përshtypjet tuaja për pedagogët tuaj, marrëdhëniet me ta, si dhe mësimdhënien në auditorët e fakultetit. Me çfarë përshtypjesh largoheni prej tyre?**

Mësimdhënia ka qenë shumë profesionale, për arsye se pedagogët

janë ekspertë që ushtrojnë profesionin e tyre në fushën e tyre, dhe më mirë se eksperiencia e tyre nuk mund të jetë asnjë mësim, asnjë leksion, asnjë doktrinë. Gjithashtu pjesë e programit kanë qenë edhe degë shumë të largëta për ne, si civilë të sapo dalë nga gjimnazi, si për shembull Marrëdhënie Ndërkombëtare, janë degë të cilat janë mjaft të reja e të panjohura dhe të vështira për ne, por që janë tepër interesante dhe të bëjnë për vete, sepse janë gjëra të reja që si kemi hasur më parë.

Të gjithë pedagogët janë të mirë e të vlerësuar njësoj për ne, sepse secili prej tyre ka treguar profesionalizëm dhe vlera njerëzore aq shumë të rëndësishme për ne në këtë rrugëtim të ri.

Por këtu dua të falënderoj gjithë katedrën për përkushtimin dhe përgjegjësinë ndaj nesh.

#### **Cilat janë pritshmëritë tuaja në të ardhmen?**

Si fillim duhet të qetësohemi e të falënderojmë veten, që ia arritëm ta mbyllim me sukses, sepse ka qenë një rrugëtim mjaft i vështirë dhe duhet të vlerësojmë punën e mundimet që kemi kaluar për t’ia arritur kësaj dite. Pas kësaj do ndjekim rrjedhën e procesit, i cili do të vendosë vijimin e rrugëtimit tonë, pasi është pjesë e punës. Ne jemi pyetur se ku preferojmë të shërbejmë, nuk e di sa do merret parasysh, por duke qenë se unë jam ende i paqartë me veten se ku ekzaktësisht dua të jem, ia lë procesit në dorë dhe jam i bindur se kudo që të jetë, unë do të bëj më të mirën dhe me shumë mundësi do ia dal.

#### **Një pjesë e mirë e studentëve zgjedhin të shkojnë jashtë në përfundim të studimeve. Po ju a e keni menduar ndonjëherë të largoheni?**



Logjikisht, kur ke punuar dhe arrin moshën 30-vjeçare në një profesion të caktuar, ke arritur të krijosh edhe një rreth shoqëror, sepse përtej punës me të njëjtët njerëz ke krijuar edhe marrëdhëniet shoqërore, do të ishte pamundur të shkëputesh e të fillosh nga e para. Kështu që unë jam i bindur që, nëse fundi i kësaj kontrate më arrin në profesionin e ushtarakut, jam i sigurt që e do e vazhdoj deri në fund.

Dua që rrobën ushtarake ta mbaj me nder dhe dinjitet si një detyrë ndaj Atdheut të cilit i kemi borxh dhe jetën.

Të gjithë të rinjë dhe të rejave shqiptarë u bëj thirrje ‘të nxënë’ dije pranë Akademisë së Forcave të Armatosura sepse është garanci për të ardhmen e sigurt.

# TË BËSH MË SHUMË ME TRAJNIMIN USHTARAK TË BAZUAR NË SIMULIM

Ushtritë në mbarë botën duhet të vazhdojnë me përparimet e mëdha teknologjike në pajisje dhe të operojnë në mjedise komplekse dhe dinamike, duke përfshirë kërcënimet jo tradicionale dhe rritjen e luftës së informacionit. Ritmi i ndryshimit është aq i shpejtë sa metodat tradicionale të trajnimit nuk janë më në gjendje të pasqyrojnë realitetin e ri operacional.

Në përgjigje të kësaj sfide, teknologjia e sofistikuar e simulimit po zbatohet lehtësisht për të lejuar marinat dhe forcat e tjera të përshtatin ofrimin e trajnimit dhe provave të misionit në mënyrë që të jetë më e rëndësishme për operacionet moderne dhe komplekse.

Disa forca të armatosura gjithashtu duhet të kryejnë operacione të panjohura për to duke përdorur teknologji të re. Si shembull, shumë marina tani po investojnë në një aftësi të re të luftës kundër nëndetëseve (ASW), me përvojë të kufizuar para-prake operacionale në këtë fushë. Kjo krijon një sfidë të rëndësishme: si t'u mësoni me kosto efektive një sasi të re njohurish, aftësish dhe qëndrimesh për ASW komandantëve, operatorëve dhe mirëmbajtësve të pajisjeve.

Megjithëse buxhetet ushtarake globale zakonisht mbeten të shëndetshme, kur bëhet fjalë për stërvitjen, ushtritë shpesh detyrohen të 'bëjnë më shumë me më pak'. Përballë kësaj sfide, aplikimi i trajnimit të bazuar në simulim paraqet një sërë faktorësh që përbëjnë një rast të konsiderueshëm biznesi në krahasim me metodat tradicionale.

## Kufizimet e modelit të klasës

Më parë, kurset e trajnimit mund të jenë kryer brenda një mjedisi klase rreth një pjese të pajisjes fizike. Megjithatë, kohët e fundit, disponueshmëria e këtyre asetëve fizike është zvogëluar dhe kostojat e madhe e dedikimit të pajisjeve vetëm për trajnim do të thotë se kjo mund të mos jetë më një opsion i zbatueshëm.

Në mënyrë të ngjashme, ushtria po kërkon gjithnjë e më shumë të ofrojë trajnime në një kohë dhe vend që mund t'i përshtatet një studenti të caktuar. Ai dëshiron t'i japë përparësi të mësuarit fleksibël, të përqendruar te studenti, i cili mund të ndihmojë në zvogëlimin e zbehjes së aftësive përmes trajnimit rifreskues në kohë dhe gjithashtu të mundësojë ofrimin e trajnimit ndërkohë që personeli i shërbimit është i vendosur në operacione, për shembull në bordin e një anijeje. Sa më shumë që një student të mund të praktikojë dhe të familjarizohet me procedura specifike operacionale, aq më pak ka gjasa që ai të vuajë nga zbehja e aftësive.

Prandaj, trajnimi i bazuar në simulim po fi-

ton vruell sepse është një metodë me kosto efektive, fleksibël dhe i aksesueshëm që mbështet trajnimin e decentralizuar. Për më tepër, ai mund të sigurojë përmbajtje të saktë të përdoruesit për skenarë urgjence ose gabimesh që do të ishin jopraktike ose të pasigurta për t'u krijuar brenda një klase ose në situata të drejtpërdrejta. Ai gjithashtu mund t'i përshtatet një studenti ose aftësie specifike, duke siguruar fokus më të madh në objektivat specifike të trajnimit ku studenti kërkon më shumë mbështetje.

Kur kombinohen, këta faktorë ofrojnë një rast të fortë biznesi për përdorimin e trajnimeve procedurale të bazuara në simulime - si shembull, përdorimi i sistemit DECKsim të SEA-s, ka ulur koston e trajnimit të Oficerëve të Kuvertës së Fluturimit me më shumë se 50% në krahasim me trajnimin, duke përdorur drejtpërdrejt helikopterë.

## Teknologji e aplikuar nga lojërë dhe më gjerë

Teknologjia ka ardhur deri tani vitet e fundit. Zhvilluesit kanë adoptuar teknologjinë e harduerit dhe softuerit tepër të gjallë të lojërave dhe e kanë ripërdorur atë për të ofruar një trajnim intensiv të sigurt, efikas dhe me besnikëri të lartë. Trajnimi i bazuar në simulim synon të jetë fizikisht mjedisor dhe besnik ndaj skenarit dhe funksionalisht i drejtpërdrejtë.

Besnikëria fizike mund të sigurohet nga një kombinim i sinjaleve vizuale, audio dhe lëvizjeje nëpërmjet gjenerimit/grafikës së imazhit 3D, sistemeve të projektimit, kufjeve të realitetit virtual (VR) dhe sistemeve audio. Bazat e lëvizjes elektrike dhe hidraulike, platformat e dridhjeve dhe pajisjet haptike gjithashtu ndihmojnë në rikrijimin e ndjenjës së lëvizjes, duke aplikuar forca, dridhje ose lëvizje të përdoruesit. Simulimet ofrojnë besnikëri mjedisore, duke marrë parasysh efektet e ndriçimit, efektet e motit dhe topografinë.

Sistemet moderne të gjenerimit të imazheve, shpesh të zhvilluara nëpërmjet industrisë së lojërave kompjuterike, janë të afta të prodhojnë paraqitje vizuale me cilësi të lartë të efekteve të motit, si shiu, bora, era dhe mjegulla. Përveç kësaj, efektet fizike që moti mund të ketë mbi një aktivitet, për shembull zvogëlimi i diapazonit të

zbulimit të sensorëve, mund të përsëriten brenda sistemeve moderne të simulimit.

Trajnimi i bazuar në simulim mund të përdorë gjithashtu baza të të dhënave të terrenit me rezolucion të lartë, të cilat përfshijnë lloje të sakta të bimësisë rajonale dhe sezonale për të rritur realizmin. Për aplikimet detare, gjendet fizikisht realiste të detit dhe paraqitjet nëntokësore mund të miratohen gjithashtu për të siguruar që operacionet e anijeve janë të përshtatshme.

## Përshtatja e simulimeve për situata specifike

Sa herë që zhvillohet trajnimi i bazuar në simulime për ushtrinë, duhet të vlerësohen kërkesat fizike, mjedisore dhe funksionale të aplikacionit. Kërkesa e trajnimit do të përcaktojë nëse një pjesë e pajisjes kërkohet të përfaqësohet në mënyrë të saktë hapësinore dhe vizuale ose nëse procedurat kryhen gjatë ditës, natës ose në kushte të ndryshme të motit.

Për më tepër, funksione specifike operacionale mund të kërkohet të përfaqësohen me një shkallë të lartë saktësie - të gjithë këta elementë janë të përfshirë në hartimin e sistemit të trajnimit.

Sistemet e simuluar janë veçanërisht efektive për skenarët e trajnimit që kanë një shkallë të lartë vështirësie (d.m.th., që përfshijnë një numër të madh hapash ose ndërveprimesh procedurale komplekse), kanë një nivel të lartë rëndësie (për shembull, që përfshijnë pajisjet ose operacionet kritike të misionit ose sigurisë), ose kryhen rrallë që do të thotë se ka një rrezik në rritje të zbehjes së aftësive me kalimin e kohës. Kur shihet në këtë këndvështrim, nuk është për t'u habitur që shumë forca po aplikojnë teknologji të sofistikuar simulimi për të përmirësuar ofrimin e tyre të trajnimit. Është një zgjidhje efektive stërvitore që redukton besimin në pajisje fizike dhe ofron një qasje më fleksibël me kosto më të ulët. Ai mund të shpërndahet nëpërmjet teknologjive të internetit dhe mundëson mësimin me në qendër nxënësin.

Për më tepër, fleksibiliteti i sistemeve të trajnimit procedural i lejon studentët të bëhen të aftë në një gamë më të gjerë të skenarëve të emergjencës dhe të rrezikshme që do të ishin jopraktike ose të



rezikshme për t'u trajnuar në kushte reale. Ne besojmë se përdorimi i trajnimit simulues do të bëhet gjithnjë e më qendror për trajnimin e personelit ushtarak dhe ndërsa teknologjia vazhdon të evoluojë, hendeku në besnikëri midis simulimit dhe realitetit do të vazhdojë të mbyllet.

Mjediset e simuluar me besnikëri të lartë dhe softueri i realitetit virtual rrisin kapacitetin për të krijuar trajnime të arritshme dhe më të përbalueshme për personelin ushtarak.

Simulimi ushtarak është në gjendje të rikrijojë skenarë që do të ishin kompleksë dhe të kushtueshëm për t'u vendosur në një kontekst fizik të botës reale, por ai ende përballet me sfida në një peizazh të pabarabartë të trajnimit operacional, ku disa vende investojnë më shumë në simulim se të tjerët.

#### **Çfarë është simulimi ushtarak?**

Simulimi ushtarak si term i përgjithshëm mund të mbulojë një gamë të gjerë qasjesh dhe aktiviteteve të ndryshme. Simulimet mund të jenë thjesht analitike, procese të drejtuara nga të dhënat e përdorura në kërkimin dhe zhvillimin (R&D) dhe testimin dhe vlerësimin (T&E).

Anasjelltas, simulatorët e trajnimit ushtarak mund të përfshijnë aspekte të realitetit virtual dhe të shtuar (VR dhe AR) me modele dhe mjedise të krijuara nga kompjuteri për skenarë zhytës, ndërveprues që përgatisin përdoruesit përfundimtarë për gjënë reale. Lloji i fundit është duke u zhvilluar për të përmbushur të gjitha llojet e kërkesave stërvitore, nga aftësitë luftarake të logjistika dhe disiplina e zjarrit. Duke i konvertuar komponentët thelbësorë të trajnimit në përvoja të simuluar të ndërtuara rreth

të trajnuarve, ku mund të reduktohen në masë të madhe kërkesat e kohës dhe kostos të përfshira në trajnimin tradicional të mbrojtjes.

#### **Pse të përdoren simulimet në stërvitjen e mbrojtjes?**

Në një farë mase, simulimet janë përdorur prej kohësh nga forcat ushtarake gjatë planifikimit dhe strategjisë. Shumë kohë përpara përdorimit të teknologjisë dhe modeleve kompjuterike, betejat ishin 'simuluar' në harta dhe psikologjia e betejës u aplikua për rezultatet dhe manovrat e mundshme.

Lojërat e hershme të tavolinës së luftës gjermane si Königs-Spiel - të ngjashme me shahun, por të luajtura me një sistem lëvizjeje më komplekse pikë për pikë - dhe Kriegsspiel janë padyshim sistemet e para të aksesueshme të disponueshme për forcat ushtarake për planifikimin dhe matjen e rezultateve të mundshme të betejave me skenarë të ndryshëm.

Kriegsspiel i shërbeu veçanërisht kësaj nevojë, duke qenë shumë më i fokusuar te realizmi dhe vendimmarrja e mirë nga ana e lojtarëve. Duke aplikuar matematikën dhe logaritmet e probabilitetit në lojëra si Kriegsspiel, ushtritë që ishin ende shekuj larg modeleve të avancuara kompjuterike ishin në gjendje, në një farë mase, të mendonin përpara kundërshtarëve të tyre dhe të planifikonin lëvizje dhe kundërlëvizje të mundshme.

#### **Simulimi modern i luftës**

Në shumë mënyra, kjo lidhje e hershme midis lojërave dhe luftimeve do të vazhdojë dhe do të thellohet vetëm pasi teknologjia e avancuar na lejoj të bënim për-

shkrime më realiste të hapësirës së betejës për argëtim.

Teknologjitë e zhvilluara në dukje për qëllime argëtimi, si VR, e kanë gjetur veten duke u ushqyer përsëri në simulimin ushtarak. Megjithatë jo të gjithë simulatorët po kërkojnë t'i bëjnë përdoruesit përfundimtarë të gatshëm për luftim, në të vërtetë, njëri synonte të bënte të kundërtën. Vietnami virtual, i zhvilluar në vitet 1990 dhe i vënë në dispozicion në 1997 për përdoruesit e tij të parë, ishte një simulim i krijuar nga një ekip i përbashkët kërkimor nga Georgia Tech dhe Universiteti Emory.

Simulatori ishte një formë terapie ekspozimi për veteranët e Vietnamit që vuanin nga çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD). Angazhimi u tregua i lartë dhe pacienti i parë në veçanti iu përgjigj në mënyrë të brendshme rreziqeve mjedisore brenda botës së simuluar.

Kjo tregon një 'zmadhim' të rëndësishëm të aftësive të simulatorëve të luftës që ka vazhduar edhe sot.

Në vend që të simulojnë një mjedis me pamjen e një perëndie, simuluesit tani synojnë të ofrojnë një përvojë të përbashkët që mund të përdoret dhe banohet nga shumë përdorues të njëkohshëm.

Tani, simulimet nuk mund të përdoren vetëm për planifikim dhe strategji të nivelit të lartë, por mund të përfitojnë drejtpërdrejt individët e përfshirë në fusha të ndryshme luftarake dhe të krijojnë skenarë rreth tyre.

Edhe pse ata janë ndërtuar mbi teknologjinë e përdorur kryesisht në argëtim dhe kanë huazuar disa aspekte të 'gamifikimit', ato janë dukshëm të ndara nga diçka e krijuar për argëtim.

#### **Simulatorët e ardhshëm të trajnimit ushtarak**

Përdorimi i simulatorëve, veçanërisht atyre të lidhur në rrjet ndërmjet kombeve bashkëpunuese dhe sistemeve të tyre përkatëse, do të kërkojë vigjilencë më të madhe ndaj kërcënimeve kibernetike.

Nuk mund të injorohet mundësia që të dhënat e paçmueshme ushtarake të vidhen nga aktorë të jashtëm. Informacioni në lidhje me taktikat, pajisjet dhe efikasitetin e fushave të caktuara të trajnimit janë pasuri që mund të përfitojnë kundërshtarët nëse vidhen. Kohët e fundit, Britania e Madhe ka parë se sa thjesht premtimi i përfitimit financiar mund të tërheqë avantazhe për kombet e tjera, dhe nuk është sekret që kombe si Kina dhe Rusia kanë ekipe shumë të sofistikuar të dedikuara për hakerimin dhe mbledhjen e sekreteve nga të tjerët. Por për sa kohë që informacioni i marrë, dhe i përdorur për të informuar, nga simulimi ushtarak është më të vërtetë i mbrojtur, ato i përgjigjen nevojës për trajnime dhe bashkëpunim të hapur, të aksesueshëm brenda koalicionëve që duhet të fitojnë çdo avantazh që mundën.

# SAMITI HISTORIK I NATO-S NË VILNIUS:

## Së bashku për rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, Aleanca merr vendime të mëdha për t'u përshtatur për të ardhmen

**PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA**

**D**uke përfunduar Samitin dyditor zhvilluar në Vilnius, më 11-12 korrik 2023, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg vlerësoi që udhëheqësit e NATO-s morën vendime të mëdha për të përshtatur Aleancën për të ardhmen. Aleatët ranë dakord për planet më të detajuara dhe më të fuqishme të mbrojtjes të NATO-s që nga Lufta e Ftohtë, forcuan angazhimin e tyre për investimet në mbrojtje, ranë dakord për ta afruar Ukrainën me NATO-n dhe thelluan partneritetet në mbarë botën.

Stoltenberg kryesoi takimin inaugurues të Këshillit NATO-Ukrainë, më 12 korrik 2023, ku aleatëve iu bashkua presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy. Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi se tani e tutje NATO dhe Ukraina do të takohen në Këshill "për të diskutuar dhe vendosur si të barabartë". Ai përsëriti gjithashtu që aleatët kanë rënë dakord për një paketë të re ndihme shumëvjeçare për të ndihmuar kalimin e Ukrainës nga ajo e epokës sovjetike në pajisjet dhe standardet e NATO-s dhe për t'i bërë forcat e tyre plotësisht të ndërveprueshme me NATO-n. Z. Stoltenberg përsëriti më tej njoftimet e reja të mbështetjes nga disa aleatë. Në samit, aleatët ripohuan gjithashtu se Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s dhe ranë dakord të heqin kërkesën për Planin e Veprimit për anëtarësim. "Kjo do të ndryshojë rrugën e anëtarësimit të Ukrainës nga një proces me dy hapa në një proces me një hap", - tha Stoltenberg. "Ne do të lëshojmë një ftesë për Ukrainën për t'u bashkuar me NATO-n kur aleatët të bien dakord që të plotësohen kushtet". Ai shtoi se Ukraina tani është më afër NATO-s se kurrë më parë. Stoltenberg theksoi se aleatët duhet të sigurojnë që kur të përfundojë kjo luftë, të ketë marrëveshje të besueshme për sigurinë e Ukrainës. Ai përsëriti që shumë aleatë janë angazhuar tani për të ofruar ndihmë afatgjatë të sigurisë për Ukrainën.

Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm kryesoi një takim të aleatëve me liderët e Australisë, Japonisë, Zelandës së Re, Republikës së Koresë dhe Bashkimit Evropian. Ai tha se "NATO është një Aleancë rajonale, por ne përballemi me sfida globale".

Ai tha se vendosmëria globale e Pekinit dhe lufta e Moskës kundër Ukrainës kërkojnë një koordinim edhe më të ngushtë midis NATO-s, BE-së dhe partnerëve Indo-Paqësor, dhe se ata do të punojnë edhe më ngushtë së bashku, duke qendruar të fortë për rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla.

Në mbyllje, Jens Stoltenberg tha se "NATO është më e bashkuar se kurrë" dhe falënderoi Presidentin Nauseda, qeverinë lituaneze dhe popullin e Vilniusit për pritjen e këtij Samiti historik. Samiti i ardhshëm i NATO-s do të zhvillohet në Uashington, DC në vitin 2024, duke shënuar shtatëdhjetë e pesë vjet nga themelimi i Aleancës.



### **NATO, paketë të fortë për Ukrainën, rrit parandalimin dhe mbrojtjen**

Samiti i Vilniusit ishte një Samit historik për NATO-n. Gjatë dy ditëve të Samitit aleatët morën vendime të mëdha për të përshtatur Aleancën për të ardhmen. Në sesionin e tyre të parë të punës në Samitin e Vilniusit më 11 korrik 2023, aleatët morën vendime për ta afruar Ukrainën me NATO-n dhe për të përforcuar parandalimin dhe mbrojtjen kolektive të Aleancës. "Ne ramë dakord për planet më të detajuara dhe më të fuqishme të mbrojtjes të NATO-s që nga Lufta e Ftohtë. Ne forcuan angazhimin tonë për investimet në mbrojtje. Ne ramë dakord për ta sjellë Ukrainën më afër Aleancës dhe për të rritur mbështetjen për një kohë të gjatë dhe ne i thelluam edhe më shumë partneritetet në mbarë botën", - tha në konferencën përmblylëse për shtyp Sekretari i Përgjithshëm në fund të Samitit të NATO-s 2023 në Vilnius. "Unë sapo kam kryesuar mbledhjen inauguruese të Këshillit NATO-Ukrainë. Tani e tutje, NATO dhe Ukraina do të takohen në Këshill për të diskutuar dhe vendosur si të barabartë. Ky është një hap i rëndësishëm për ta afruar Ukrainën me NATO-n". Stoltenberg tha se mirëpret gjithashtu njoftimet e reja të mëdha të mbështetjes ushtarake të bëra nga Aleatët e NATO-s në këtë Samit. "Aleatët kanë ofruar tashmë dhjetëra miliarda dollarë ndihmë ushtarake për të ndihmuar në mposhtjen e pushtimit të Rosisë, ndërkohë që dhjetëra mijëra trupa ukrainase janë trajnuar dhe pajisur nga aleatët e NATO-s. Dhe ndërsa Ukraina vazhdon të çlirojë territorin, ne do të qëndrojmë pranë tyre, për aq kohë sa duhet".

Aleatët ranë dakord për një paketë të re ndihme shumëvjeçare për Ukrainën për të ndihmuar kalimin e Ukrainës nga epokës sovjetike në pajisjet dhe standardet e NATO-s dhe për t'i bërë forcat e tyre

plotësisht të ndërveprueshme me NATO-n dhe për të ndihmuar në rindërtimin e sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes së Ukrainës, duke mbuluar nevojat kritike si karburanti, pajisjet e çminimit dhe furnizimet mjekësore. Ukraina tani është më afër NATO-s se kurrë më parë.

Aleatët ripohuan se Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s dhe ranë dakord të heqin kërkesën për Planin e Veprimit për anëtarësim. Kjo do të përshpejtojë procesin, do të ndryshojë rrugën e anëtarësimit të Ukrainës nga një proces me dy hapa në një proces me një hap. “Ne do të lëshojmë një ftesë për Ukrainën për t’u bashkuar me NATO-n kur Aleatët të bien dakord që të plotësohen kushtet”. Kjo dërgon një mesazh të qartë, të fortë dhe të bashkuar nga Samiti i Vilniusit. “Ne duhet të sigurojmë që kur të përfundojë kjo luftë, të ketë marrëveshje të besueshme për sigurinë e Ukrainës, në mënyrë që historia të mos përsëritet. Unë e mirëpres që shumë aleatë janë angazhuar tani për të ofruar ndihmë afatgjatë të sigurisë për Ukrainën. Kjo do të ndihmojë në parandalimin e çdo agresioni të ardhshëm nga Rusia pas përfundimit të kësaj lufte.

Aleatët ranë dakord gjithashtu të krijojnë Këshillin e ri NATO-Ukrainë, i cili mbajti takimin e tij inaugurues në Vilnius më 12 korrik 2023 me pjesëmarrjen e Presidentit Zelenskyy. Aleatët ripohuan gjithashtu se Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s dhe ranë dakord të heqin kërkesën për një Plan Veprimi Anëtarësimi. “Kjo është një paketë e fortë për Ukrainën dhe një rrugë e qartë drejt anëtarësimit të saj në NATO”, - tha Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg.

Aleatët miratuan planet më gjithëpërfshirëse të mbrojtjes që nga fundi i Luftës së Ftohtë, tha Stoltenberg.

Të projektuar për të kundërshtuar dy kërcënimet kryesore të Aleancës, Rusinë dhe terrorizmin, planet e reja rajonale parashikojnë 300 000 trupa në gatishmëri të lartë, duke përfshirë fuqi të konsiderueshme luftarake ajrore dhe detare. Aleatët miratuan gjithashtu një plan të ri veprimi për prodhimin e mbrojtjes për të përshpejtuar prokurimet e përbashkëta, për të rritur kapacitetin e prodhimit dhe për të përmirësuar ndërveprimin e aleatëve.

Për të përmirësuar nevojat e tyre të mbrojtjes, aleatët morën një angazhim të qëndrueshëm për të investuar një minimum prej 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në mbrojtje. Aleatët evropianë dhe Kanadaja shënuan një rritje reale prej 8.3% në buxhetet e tyre të mbrojtjes në vitin 2023, rritja më e madhe në dekada. Njëmbëdhjetë aleatë plotësojnë ose tejkalojnë standardin këtë vit dhe ky numër pritet të rritet ndjeshëm në vitin 2024.

### **NATO është një Aleancë rajonale, por ajo përballlet me sfida globale**

Në Samit aleatët gjithashtu u takuan me liderët e Australisë, Japonisë, Zelandës së Re, Koresë së Jugut, si dhe me Bashkimin Evropian. Ata diskutuan sfidat që një Kinë “shtrënguese” paraqet për sigurinë dhe vlerat euro-atlantike. “Kina nuk është kundërshtar i ynë dhe ne duhet të vazhdojmë të angazhohemi”, - tha Sekretari i Përgjithshëm, ndërsa theksoi se “vendosmëria në rritje e Pekinit ndikon në sigurinë tonë dhe sfidon rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla”.

Sekretari i Përgjithshëm rezervoi takim dhe pritë partnerët e ngushtë të NATO-s (Australisë, Japonisë, Zelandës së Re, Republikës së Koresë dhe Bashkimin Evropian) në një takim të Këshillit të Atlantikut të Veriut në ditën e dytë të Samitit në Vilnius. Në fillim të takimit, z. Stoltenberg tha se lufta e Rusisë në Ukrainë ka pasojë globale, se kërcënimet terroriste dhe kibernetike nuk njohin kufij dhe se regjimet autoritare po afrohen gjithnjë e më shumë.

“NATO është një Aleancë rajonale midis Evropës dhe Amerikës së Veriut, por sfidat me të cilat përballlemi janë globale dhe siguria jonë është e ndërlidhur. Ajo që ndodh në rajonin Euro-Atlantik ka rëndësi për Indo-Paqësorin, dhe ajo që ndodh në Indo-Paqësorin ka rëndësi për Euro-Atlantikun”, - ishin fjalët hyrëse që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive, me Suedinë, Partnerët Indo-Paqësor dhe BE-në. “Ne duhet të qëndrojmë së bashku

për rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Prandaj, mirëpres praninë e partnerëve këtu me ne sot”, - tha ai. “Vetëbesimi global i Pekinit dhe lufta e Moskës kundër Ukrainës kërkojnë një koordinim edhe më të ngushtë midis NATO-s, BE-së dhe partnerëve tanë Indo-Paqësor. Ne dënojmë programet bërthamore dhe raketore të Koresë së Veriut, duke përfshirë lëshimin e saj të raketës të fundit”. Këto shkelen rezolutat e shumta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe përbëjnë një kërcënim për sigurinë rajonale dhe globale.

NATO po forcon lidhjet me Australinë, Japoninë, Zelandën e Re dhe Korenë e Jugut me programe të përshtatura partneriteti, duke përfshirë punën e përbashkët për çështje si siguria detare, teknologjitë e reja, kibernetike, ndryshimet klimatike dhe qëndrueshmëria. “Ne do të punojmë edhe më ngushtë së bashku, duke qëndruar të fortë për rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Ne përballlemi me situatën më serioze të sigurisë në dekada, por aleatët po përballen me sfidën”.

Duke iu përgjigjur interesit të gazetarëve lidhur me një zyre ndërlidhëse me Japoninë, Stoltenberg tha se në takimin me kryeministrin Kishida, ata shprehën qartë rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të partneritetit, punës që bëjmë Japonia dhe NATO. Kryeministri Kishida ka deklaruar qartë se ajo që ndodh në Evropë ka rëndësi për Azinë dhe ajo që ndodh në Azi ka rëndësi për Evropën, dhe ai gjithashtu shkoi në Ukrainë dhe vizitoi Kievin ku demonstroi angazhimin e tij të qartë për të ofruar mbështetje për Ukrainën.

“Ne gjithashtu ramë dakord sot për një program të ri individual partneriteti midis NATO-s dhe Ukrainës, ku përshkruajmë fushat e ndryshme të punës ku do të thellojmë bashkëpunimin tonë. Bëhet fjalë për kibernetikë. Bëhet fjalë për sigurinë detare. Bëhet fjalë për kundërshtimin e kërcënimeve hibride, duke përfshirë dezinformimin dhe në të gjitha fushat ku ne shohim potencialin që NATO dhe Japonia të punojnë më ngushtë së bashku”. Stoltenberg tha se çështja e një zyre ndërlidhëse është ende në tavolinë dhe se do të shqyrtohet në të ardhmen.

### **NATO dhe G7 i ofrojnë garanci afatgjata sigurie Ukrainës**

Shtatë vendet më të zhvilluara të botës ofruan garanci afatgjata sigurie për Ukrainën pas takimit të Këshillit të ri NATO-Ukrainë, që u mbajt krahas takimit të nivelit të lartë të NATO-s në Lituani. Format i ri u krijua për të forcuar bashkëpunimin midis Kievit dhe aleancës me 31 anëtarë. Presidenti vlerësoi se takimi i NATO-s solli rezultate të mira për vendin që po lufton sulmin ushtarak rus që filloi në shkurtin e vitit të kaluar. Presidenti amerikan Joe Biden mbajti edhe një takim kokë me kokë me presidentin Zelensky pas takimit të Këshillit të ri NATO-Ukrainë. Shtatë vendet më të zhvilluara të botës ofruan komrazhën ndërkombëtare që do të hapë rrugën për garancitë afatgjata të sigurisë për Ukrainën për të rritur mbrojtjen e saj kundër Rusisë dhe për të penguar agresionin e ardhshëm.

Ukraina kërkoi me këmbëngulje anëtarësim të shpejtë në NATO ndërsa lufton kundër agresionit rus që filloi në shkurt të vitit 2022. Kjo luftë deri më tani ka shkaktuar vdekjen e dhjetëra mijëra njerëzve dhe ka zhvendosur miliona të tjerë. Zelenskyy vlerësoi deklaratën e presidentit Joe Biden ku ofroheshin garanci afatgjata për Kievin. “Ne nuk do të presim që të përfundojë procesi i anëtarësimit në NATO për të ofruar përkushtim afatgjatë të sigurisë për Ukrainën. Sot, premtimi për përkushtim afatgjatë përfshin dhënien e garancive për t’u përballur me çfarëdo agresioni ndaj Ukrainës në të ardhmen”, - tha presidenti amerikan ndërsa shtoi se rruga e Ukrainës drejt NATO-s megjithatë do të jetë me një proces të lehtësuar në raport me atë që duhej ta kalonin vendet e tjera. “Delegacioni ukrainas po kthehet në shtëpi me fitore të rëndësishme sigurie për Ukrainën. Kjo na hap mundësi absolutisht të reja sigurie dhe falënderoj të gjithë ata që e bënë të mundur”, - tha presidenti ukrainas, Zelensky.

Presidenti Biden pati më pas edhe një takim të veçantë me presidentin ukrainas Zelensky, të cilit i tha se ia kupton zhgënjimin pse Kievin nuk iu ofrua një afat i qartë për anëtarësim në NATO.

# Gratë luftëtare, dinjiteti dhe vlera e historisë ndër shekuj

**G**ratë kanë shërbyer në ushtri në shumë role të ndryshme, në juridiksione të ndryshme gjatë historisë. Gratë në shumë vende nuk janë më të përjashtuara nga disa lloje të misioneve luftarake si pilotimi, mekanika dhe oficerët e këmbësorisë.

Prej vitit 1914, në ushtritë perëndimore, gratë kanë shërbyer në numër më të madh dhe role më të ndryshme se më parë. Në vitet 1970, shumica e ushtrive perëndimore filluan t'i lejonin gratë të shërbenin në detyrë aktive në të gjitha degët ushtarake.

Në vitin 2006, tetë vende (Kina, Eritrea, Izraeli, Libia, Malajzia, Koreja e Veriut, Peruja dhe Tajvani) rekrutuan gratë në shërbimin ushtarak.

Në vitin 2013, Norvegjia u bë vendi i parë i NATO-s që dërgoi gra, si dhe vendi i parë në botë që rekrutoi gratë me të njëjtat kushte formale si burrat. Në vitin 2017, Suedia fqinje ndoqi shembullin dhe në vitin 2018, Holanda iu bashkua këtij formacioni (megjithëse në Holandë nuk ka rekrutim aktiv në kohë paqeje).

Që nga viti 2022, vetëm tre vende rekrutuan gra dhe burra me të njëjtat kushte formale: Norvegjia, Suedia dhe Holanda. Disa vende të tjera kanë ligje që lejojnë rekrutimin e grave në forcat e tyre të armatosura, megjithatë me disa dallime të tilla si përjashtimet nga shërbimi, kohëzgjatja e shërbimit dhe më shumë.

## **Gratë në Luftën e Parë Botërore**

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shtetet e Bashkuara ishin në përpjekje të përgjithshme luftarake.

Çdo person duhej të kontribuonte në përpjekjet e luftës, megjithatë, kjo nuk do të thoshte domosdoshmërisht se të gjithë duhej të luftonin. Vendi duhej të vazhdonte të financonte trupat e tij dhe të mbështeste luftën financiarisht ndërsa ushtarët po luftonin. Për këtë qëllim, Shtetet e Bashkuara u mbështetën te organizatat për mbështetje.

Gratë iu bashkuan organizatave të tilla si Komiteti për Informim Publik për të edukuar njerëzit për luftën. Ky komitet promovoi edhe nacionalizmin. Përveç punës në komisione që kanë të bëjnë me arsimin, gratë kanë punuar në të gjitha llojet e pozitave. Shumë gra u bënë anëtare të YWCA dhe shkuan jashtë shtetit për të ndihmuar ushtarët. Kjo ishte hera e parë në histori që gratë e të gjitha klasave po punonin së bashku për të ndihmuar përpjekjet e luftës. Gratë e shtresës së lartë themeluan shumë organizata vullnetare të luftës, ndërsa gratë e klasës së mesme dhe të ulët punonin në këto organizata, duke punuar si infermiere ose duke plotësuar punët e burrave.

I vetmi komb që vendosi trupa luftarake femra në një numër të konsiderueshëm ishte Rusia.



Që nga fillimi, rekrutet femra ose iu bashkuan ushtrisë të maskuar ose pranoheshin në heshtje nga njësitë e tyre.

Më e shquara ishte në një kontingjent të kalorësisë së lehtë të vijës së parë në një regjiment kozak të komanduar nga një koloneli femër, Alexandra Kudasheva.

Zonja koloneli, Alexandra Kudasheva (1873–1921?) ishte komandantja e një regjimenti të kalorësisë së lehtë ruse nga 1915 - 1917 gjatë Luftës së Parë Botërore dhe gjithashtu gjatë Revolucionit Rus.

Ky regjiment kalorësie mund të ketë qenë regjimenti i parë i integruar gjinor në historinë ruse, ajo u shqua gjithashtu për bëmat e saj të kalërimit të qëndrueshmërisë.

Të tjerë përfshinin Maria Bochkareva, e cila u dekorua tre herë dhe u gradua në gradën e nënoficerit të lartë.

Në Serbi, disa gra individuale luajtën role kryesore ushtarake. Mjekja skoceze Elsie Ingles koordinoi një tërheqje prej rreth 8 000 trupash serbe përmes Rumanisë dhe Ruisë revolucionare, deri në Skandinavi dhe më në fund në anije transporti për në Angli.

Një grua tjetër, Milunka Saviq, u regjistrua në ushtrinë serbe në vend të vëllait të saj. Ajo luftoi gjatë gjithë luftës, duke u bërë ndoshta gruaja më e dekoruar në historinë ushtarake.

Një ligj i vitit 1948 i bëri gratë pjesë të përhershme të shërbimeve ushtarake. Në vitin 1976, grupi i parë i grave u pranuan në një akademi ushtarake të SHBA-së.



Përafërsisht 16% e klasës së 'West Point 2013' përbëhej nga gra. Në Luftën Civile Finlandeze të vitit 1918, më shumë se 2000 gra luftuan në Gardën e Kuqe të Grave.

Gjatë Luftës Civile Spanjolle, mijëra gra luftuan në njësitë luftarake dhe praparoje me gjini të përziera, ose si pjesë e milicive.

Disa vende lejojnë ushtarët femra të shërbejnë në pozicione të caktuara të armëve luftarake.

Të tjerët i përjashtojnë ato për arsye të ndryshme, duke përfshirë kërkesat fizike dhe politikat e privatësisë.

Vendet jo-rekrutimi, veçanërisht Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadaja janë vendet ku u arrit niveli më i lartë i pranisë ushtarake të femrave.

Kanadaja është vlerësuar progresive në zbatimin e hershëm të praktikave të barazisë gjinore.

Një rritje e thirrjes për mundësi të barabarta, e shoqëruar me rënie e burrave të aftë për punë, të gatshëm për të hyrë në shërbimin ushtarak, nxiti vendet të reformojnë politikat drejt përfshirjes së grave.



Me hapjen e shërbimit të nëndetëseve në vitin 2000, gratë tani kishin lirinë për t'u regjistruar në çdo lloj shërbimi ushtarak.

#### **Gra me gjurmë të arta në histori**

**Mbretëresha e Massagetit**, u bë e famshme për fitoren dhe vrasjen e perandorit pers Kiri i Madh (530 p.e.s.), kur ai sulmoi vendin e saj për ta pushtuar. Shpirti i saj i copëtuar u bë legjendar, për t'u hakmarrë për vdekjen e të birit, i cili u vra nga Kiri i Madh në dyluftim, pasi e vrau perandorin pers, ia zhyti kokën në një lëkurë dhie të mbushur me gjak dhe më pas ia këputi. Sipas disa gojëdhënave e mbajti kafkën e perandorit gjithë jetën e saj, duke e përdorur si kupë për të pirë verë.

**Mbretëresha e Palmirës**, Ksenia-Ksenobia (Shek. III e.r.) (qyteti antik që u shkatërrua nga ISIS) ishte një mbretëreshë krenare anti-romake. Mbretëria e saj në momentin e zgjerimit më të madh shkonte nga Siria deri në Persi u zu rob, por Aureliano i falë jetën dhe e dërgoi në Romë, duke i bërë dhe shëtitjen si trofe lufte.

**Çupëlina e ORLÉANS**, Zhan D'Ark (1412-31) jetoi përgjatë periudhës së luftës njëqindvjeçare (1337-1453), ku në konflikt ishin dy kombe që po lindnin Franca dhe Anglia. Me origjinë jo fisnike, në moshën 17-vjeçare, kishte bindjen në vetvete se ishte përzgjedhur nga Zoti për të shpëtuar Francën dhe pasi përshkoi 2000 km dhe mbërriti në oborrin e Karlit të Shtatë dhe kërkoi të kalëronte në krye të ushtrisë që shkonte në ndihmë të Orléans, e rrethuar nga ushtria e

Enrikut VI. Pasi mori konsensusin e mbretit Çupëlina dhe ushtria e saj ia dolën të çlirojnë Orléans. Por karriera e saj u ndërpre shumë shpejt, pasi e kapën një vit më pas në një kurth, iu dorëzua Mbretit të Lukesmburgut, i cili ia dhuroi si trofe lufte anglezëve. Në vitin 1431, në moshën 19-vjeçare, u akuzua për heretizëm dhe u dogj e gjallë. Zhan D'Ark është shenjtëruar dhe është patrone e Francës.

**Mbretëresha e Forli-së**, Caterina Sforza (1463-1509), vajza e Galeazzo Maria Sforza dhe nëna e Giovanni dalle Bande Nere, qeverisi mbi provincën e Imola dhe Forli. E mbiquajtur 'Tigreshë' për kurajën dhe vendosmërinë e saj, u mor vetë në mënyrë direkte për mbrojtjen e shtetit të saj, planifikonte manovrat ushtarake, për nevojat e ushtrisë, armët dhe kuajt si dhe stërvitjen ushtarake. Por kjo nuk mjaftoi që të arrinte të ruante territoret e saj nga pushtimet e famëkeqit Cesare Borgia, i mbiquajtur il Valentino. U burgos në Romë, pasi rifitoi lirinë, jetoi vitet e fundit të jetës së saj në Firence.

**Nakano Takeko** (1847-68) ishte onna-bugeisha, pra një grua luftëtare e cila i përkiste aristokracisë japoneze. Këto gra mund të merrnin pjesë në beteja, së bashku me meshkujt samurai dhe ishin të stërvitura në përdorimin e armëve për të mbrojtur shtëpinë e tyre, familjen dhe nderin në kohë lufte. Nakano Takeko u vendos në krye të një trupe speciale të përbërë nga gra luftëtare, një lloj ushtrie femërore, e cila lufton me një shpatë japoneze naginata. Vdiq në fushën e betejës së Aizu (1868) në kulmin e Luftës civile japoneze.

#### **Asia Ramazan**

(1996-2014), një luftëtare kurdë, e cila kërkoi të ndalonte avancimin e ISIS në territoret e Kurdistanit sirian. Në vitin 2014, vetëm 18 vjeç u bë vullnetare e radhëve të Ypj- milicisë femërore kurde, pjesë e milicisë së Kurdistanit sirian. U bë e famshme në mediat perëndimore si simbol i heroinës rezistuese, dhe vdiq në vitin 2016 në një betejë në Minbic, Siria e Veriut.

Më 11 maj 1771, në një burg të Stambollit lindi **Dhaskarina**

#### **Pinoçi (Bubulina)**, luftëtarja

më e njohur arvanitase. Bubulina ishte e bija e Stavro dhe Skevo Pinoçit. I ati Stavro, ishte një kapedan deti shqiptar (arvanitas) i burgosur në Stamboll. Pas vdekjes së tij e ëma dhe Bubulina kthehen në Hidra. Emri Bubulina i mbeti pas vdekjes së burrit të dytë, Dhimitër Bubulit. Fama e saj si detare dhe luftëtare, mbushi Europën e Perandorinë Osmane. Pikturat e saj u publikuan në qendrat kryesore të Evropës, si Parisi, Londra, etj. Dhaskarina u vra në Specë nga dora e një shqiptari (arvanitasi) tjetër, Kristo Kuçi, vajza e të cilit u rrembye nga i biri i Bubulinës.



# PELLAZGËT,

## gjeneza e civilizimit evropian

**P**ellazgët ishin një popull i lashtë, paraardhësit e të gjithë popujve indoevropianë. Për këtë popull antik që përhapi kulturën në gjithë Evropën dihet shumë pak, thuajse asgjë.

Gjuha e këtij populli quhej Pellazgjisht. Këtë e përmend në shkrimet e tij historiani antik Diodor Siçiliani, i cili jetoi midis viteve 90 – 30 para erës sonë. Diodor Siçiliani shkruan se poetët parahomerikë janë shprehur me këtë gjuhë, pra Pellazgjishten, dhe me alfabetin që përdorej për ta shkruar atë.

Nga i njëjti burim mësojmë se kjo gjuhë është përdorur për të paktën 10 shekuj para erës së re. Më tej, Diodor Siçiliani raporton se ishin pellazgët ata që e sollën të parët alfabetin në gadishullin Italik, si dhe në pjesën tjetër të Evropës, duke bërë sigurisht përshtatjet dhe përmirësimet e nevojshme.

Këto të dhëna i konfirmon edhe shkrimtari romak Plini – i vjetri, i cili jetoi midis viteve 24 dhe 79 të erës sonë. Ndërsa Virgjili në veprën e tij Eneida (Eneida, VIII, V. 62-63) shkruan: “Thuhet se banorët e parë të Italisë sonë kanë qenë pellazgët”.

Nga autorët e lashtësisë mësojmë se, para vendosjes së grekëve në gadishullin Italik, territori në të cilin ata u vendosën quhej Pellazgjia. Burimet e ndryshme nga autorë antikë bëjnë gjithashtu të ditur se grekët mësuuan nga pellazgët jo vetëm artin e përpunimit të metaleve, të ndërtimit të mureve, por mësuuan nga ata edhe mënyrën e të shkruarit, duke përvetësuar edhe hyjnitë e tyre.

Homeri i përmend pellazgët si aleatët e Trojanëve.

“Zeusit Pellazg të Dodonës” Homer i përmend pellazgët edhe si “Popujt e Kretës”. Mund të vazhdojmë pafund me citime për pellazgët nga autorë të antikitetit, si Pindari, Pausania, Ephorus of Cyme, Hesiodi etj., por pyetja kryesore që lind në këtë pikë është: A ekzistojnë ende pellazgët?

Nëse po, cilët janë ata?

Studiuesja dhe antropologia Nermin Vlora Falaski, në librin e saj “Trashëgimia gjuhësore dhe gjenetike”, arriti të deshifronte mbishkrimet antike etruske dhe pellazge. Këto mbishkrime nuk ishin mundur të deshifroreshin me asnjë prej gjuhëve të përdorura në antikitet nga popujt që banojnë në zonat ku ato janë zbuluar, as me greqishten e lashtë, as me latinishten, etj. Studiuesja Nermin Vlora Falaski arriti të deshifronte mbishkrimet antike pellazge dhe etruske, duke përdorur gjuhën e sotme shqipe, ose me saktë dialektin gegë të saj. Ky zbulim do të vërtetonte se shqiptarët, pasardhës të ilirëve, janë pasardhësit e sotëm të pellazgëve, njëri prej popujve më të lashtë që jetuan në Evropë.

Më poshtë do të sjellim disa prej mbishkrimeve antike të zbuluara në pjesë të ndryshme të Mesdheut, si në gadishullin Italik, në ishujt e detit Egje etj., të cilat mund të lexohen qartë, edhe sot, duke përdorur gjuhën shqipe.



Chiara, ndodhet një kështjellë e shndërruar në një muze arkeologjik. Në këtë muze gjendet edhe një mbishkrim veçanërisht i bukur dhe interesant, në një sarkofag me dekorime floreale.

Mbi sarkofag shkruhet: “O ANIJA A NAIE IRË LIRI”. Edhe pse gjuha e përdorur është disa arkaike, sepse mbishkrimi është bërë disa shekuj para lindjes së Krishtit, aty vihen re fare qartë fjalët shqip dhe kuptimi i gjithë mbishkrimit është i qartë edhe për lexuesin e thjeshtë që njeh gjuhën shqipe: “Anija është krenari, guxim dhe liri për ne”.

Shkrimi në këtë rast fillon nga e djathta në të majtë. Duhet të kemi parasysh se në periudhën arkaike dhe më herët nuk kishte rregulla të përcaktuara të të shkruarit. Fjalët nuk ndaheshin nga njëra-tjetra me hapësirë dhe mund të shkruhej si nga e majta në të djathtë, ashtu edhe nga e djathta në të majtë.

Por ajo çka vëmë re në këtë mbishkrim është se fjalët janë qartësisht fjalë të përdorura edhe sot në gjuhën shqipe. Zëri foljor a ose është përdoret ende në të folurën e Shqipërisë së veriut dhe në Kosovë, pra në zonat shqipfolëse ku flitet dialekti gegë.

Nga kjo shprehje vëmë re edhe rëndësinë që kishte anija, pra mjeti i lundrimit, për këtë popull të lashtë. Pellazgët, të cilët quheshin edhe “Popull i detit”, sepse ishin lundëtarë të zotë dhe të lirë, e quanin atdheun e tyre ILIRIA: LIRI (LIR = i lirë), që do të thoshte: “Vendi i njerëzve të lirë”, një vend ky që shtrihet nga Mesdheu deri në Danub.

Fjalët me rrënjën LIR mund të gjenden me të njëjtin kuptim në gjuhët: Pellazgo-ilire (liri), etruske (liri), shqipja sot (liri), italisht (libertà), frëngjisht (libertè), latinisht (libertas), anglisht (liberty), spanjisht (libertad), rumanisht (libertade), portugalisht (liberdade).

Në Itali, në rajonin e Lazio-s, ndodhet edhe lumi Liri. Pra ky emër është ruajtur gjatë shekujve në vendet e ndryshme të Mesdheut dhe Evropës, me shumë gjasa nëpërmjet

QANI ANIA NE DONX A IPE

PELASGO-ETRUSCO

ALBANESE

ITALIANO

QANI = OANIA  
A = A  
NAIE = NAIE  
IRE = IRE  
LIRI = LIRI

Ania  
à  
naje  
irë  
Liri

La nave  
è  
per noi  
coraggio, ferozza  
(e) liberta.

Mbishkrimi në foton më sipër shfaqet në një sarkofag të zbuluar në rajonin e Toskanës në Itali, zonë e njohur për vendbanimet e lashta etruske dhe pellazge. Pranë qytetit Cortona, në Val di

zgjatimeve të fiseve të ndryshme ilire, sikurse ishin edhe Etruskët e Mesapët të vendosur në gadishullin Italik.

GAI E KAIE IE  
ANK LENEITH  
XPI E TE XAIE

ILLIRICO	ALBANESE	ITALIANO
GAI	Gajret	Sopporta
E	e	e
KAIE	kraje (qaje)	piangito
IE	ie	sei
ANK	ankth	angosciato
LENE	lene	Lasciato, affidato
ITH		ith alla terra calda
HRI	hiri	alla Grazia Celeste
E		e e
TE		te al
HAIRE	Hajri	Supremo Bene

Në foton sipër paraqitet një mbishkrim ilir, i datuar midis shekujve III-II p.e.s., i cili aktualisht gjendet në muzeun arkeologjik të Durrësit.

Në të shkruhet: "GAI E KAIE IE ANK LENE ITH HRI E TE HAIRE", pra "Gajret e kraje je ankth lene ith e hiri e te hajri". Është e rëndësishme të theksohet se gjuha e këtij mbishkrimi është aq e ngjashme me shqipen e sotme, sa që bën përshtypje kur mendon se ai daton më shumë se dy mijë vjet më parë.

Në përgjithësi, mbishkrimet më të vjetra janë formuluar nga e djathta në të majtë, dhe nganjëherë vazhdojnë nga e majta në të djathtë, pra në formë boustrofedike, shpesh pa ndërprerje ndërmjet një fjale dhe tjetrës. Megjithatë, ky mbishkrim i Durrësit është i gdhendur nga e majta në të djathtë, gjë që tregon origjinën e tij më të re, kur alfabeti latin, shumë më praktik, ishte përhapur gjerësisht, dhe tani shkruhej gjithmonë nga e majta në të djathtë. Duke shkuar në kërkim të mbishkrimeve të reja, nga Egjeu në Atlantik dhe më tej në Egjipt e më gjerë, jo vetëm në përpjekje për të zbuluar përbajtjen e tyre, por edhe për të verifikuar monogjenezën e gjuhëve që mbështetet nga studiues të shquar, në Muzeun Arkeologjik të Athinës është gjendur një gur varri shumë i lashtë, i cili përmban një mbishkrim bustrofedik të shkruar me alfabetin pellazg, i cili ka përbajtje funerale.

Ky gur varri u zbulua në ishullin Lemnos. Në përgjithësi, çdo përpjekje e bërë për të kuptuar përbajtjen e këtij shkrimi ka qenë e pasukseshme dhe jo bindëse. Është kjo arsyeja që deri më tani pak studiues janë angazhuar seriozisht për zgjidhjen e kësaj enigme. Ky gur varri i atribuohet shekullit të 6-të para Krishtit, por disa studiues e mbështesin tezën se është edhe më i vjetër.



Ky mbishkrim tërësisht boustrofedik, ku shkronjat "TH" dhe "H" përsëriten vazhdimisht, për të përfaqësuar psherëtimat dhe të qarar, siç do të bënim ne sot me pasthirmat "AH" dhe "OH", përmban një vajtim funeral të ndërë, padyshim për vdekjen e një afërmi, i cili kishte qenë edhe një hero i madh, siç dëshmohet edhe nga krenaria e përsëritur e të gjithë të afërmeve të tij në fjalët e mbishkrimit.

Mbishkrimi në këtë gur varri fillon, duke u lexuar nga e majta në

të djathtë, me fjalët: "ZI A ZI MARAZ MATH". Këto fjalë mund të dallohen qartë në krye të mbishkrimit, në pjesën e sipërme të këtij guri.

Përbajtja e gjithë mbishkrimit, e përkthyer me gjuhën shqipe (përshtatur për t'u bërë më e kuptueshme):

SIGNALE

ETRUSCO	ALBANESE	ITALIANO
SI = SI	Zi	Lutto
P = P	pa	senza
MALE = Nale	nalje	sosta.

Fjalën "ZI" e gjejmë, ndër të tjera, edhe në këtë mbishkrim të shkurtër, në një guri varri që ndodhet në Muzeun Arkeologjik të Feltre, në Itali, në të dallohet mbishkrimi "ZI PA NALE", pra "Zi pa u ndaluar" ose "Zi pa fund".

Duhet të kemi gjithmonë parasysh se pasuria gjuhësore e popujve është i vetmi arkiv dokumentar i padiskutueshëm, sidomos kur mungojnë prova të tjera, por mbi të gjitha është edhe dëshmia kryesore e krijimitarisë njerëzore. Disa studiues mbështesin tezën e monogjenezës së gjuhëve, veçanërisht gjatë këtyre 2 shekujve të fundit, kur përparimi i komunikimit u ka dhënë njerëzve mundësinë të lëvizin lehtësisht dhe të kenë kontakte edhe me popullsi në zona shumë të largëta.

Përmendim këtu studiuesit italianë Alfredo Trombetti, Elia Lattes dhe Francesco Ribrezzo, të cilët janë mbështetës të kësaj teze, si dhe të origjinës ilire të popujve italik. Përveç autorëve të lartpërmendur, ka edhe studiues të tjerë gjermanë, austriakë, francezë dhe anglezë që pohojnë origjinën ilire të popujve italik.

Një meritë e veçantë i takon Prof. Zacharie Mayani, profesor në Universitetin e Sorbonës në Francë, i cili në vitet 1970 botoi 3 vëllime voluminoze, në të cilat argumenton se gjuha etruske përkthehet vetëm përmes gjuhës shqipe. Për të verifikuar vërtetësinë e zbulimit të tij, ai studioi gjuhën shqipe, fillimisht në Paris, e më pas shkoi në Shqipëri për ta përmirësuar. Tre vëllimet e botuara nga Mayani titullohen: "Les Etrusques Commencent a Parler", "Les Etrusques Parlent" dhe "La Fin Du Mystère Etrousque".

Sidoqoftë, i pari që hodhi dhe përhap idenë e monogjenezës së gjuhëve ishte Sir William Jones (1746-1794), një orientalist i famshëm, i cili në fund të jetës së tij intensive dinte 28 gjuhë.

Në ditët tona, një mbështetës i rëndësishëm i kësaj teze është prof. Colin Renfrew, i Universitetit të Kembrixhit në SHBA, i cili në veprën e tij "Arkeologjia dhe Gjuhësia" botuar në vitin 1989, shkruan: "Arsyeja kryesore e botimit të kësaj vepre time është të theksoj se arkeologët e viteve të fundit nuk e kanë marrë parasysh siç duhet dëshminë e gjuhësisë për të rindërtuar të shkuarën".

Në botën tonë ka gjithmonë një horizont përtej të cilit nuk mund të shihet. Për sa i përket lashtësisë, horizonti ynë janë Pellazgët. Duke qenë shpikësit e parë të shkrimit fonetik, nuk mund të mohojmë se kultura e vërtetë fillon me pellazgët, sikurse kemi mësuar nga autorë të ndryshëm të lashtësisë.

Le të marrim disa dokumente epigrafike të gjetura nga Egjeu deri në Atlantik, në të cilat përmenden fjalët pellazgo-ilire: YJ, ARNO, REZE etj.

Në një tempull të qytet-shtetit antik të Apolonisë gjendet një mbishkrim i shekullit të III para Krishtit që flet për yjet (YJ) dhe për një fëmijë (FIMI)...

# IN MEMORIAM

## *Heroi i Popullit Abdyl Bakiu,* KOMANDANTI I PARË I SHKOLLËS “SKËNDERBEJ”

**A**bdyl Bakiu u lind në Kuç të Vlorës në vitin 1911. Që në moshë të re, i mbrujtur me traditat atdhetare e familjare të zonës nga vinte, formoi një personalitet të qëndrueshëm dhe falë intelektit e zgjuarsisë natyrale, shumë shpejt, ndonëse në moshë shumë të re, u bë pjesë e pleqësisë në fshat.

Në vitin 1942, ashtu si shumë atdhetar të zonës, ai u lidh me çetën partizane “Avni Rustemi”, ku u bë pjesëtar e një nga luftëtarët e drejtuesit aktiv të saj. Më vonë, në zjarrin e luftës për liri, ai u evidencua si një drejtues tepër i aftë e trim, ndaj ngjiti shkallët e karrierës në repartet partizane që luftonin kundër pushtuesve e tradhtarëve të vendit. Kështu, Abdyl emërohet komisar batalioni në Brigadën e 6-të Sulmuese. Në drejtimin e kësaj brigade, veçanërisht në luftën për çlirimin e Shkodrës, Kontributi i Abdylit si luftëtar e drejtues është shënuar dhe në beteja të tjera gjatë kohës së luftës si aksioni për çlirimin e nënprefekturës së krahinës së Kurveleshit, që për nga hartimi i operacionit e deri tek realizimi i tij, mbetet një nga aksionet model të zhvilluar në krahinë e më gjerë.

Gjatë luftës, forcat e organizuara të Kurveleshit të Poshtëm, nën drejtimin e Abdyl Bakiut dhe Ali Lalës, në bashkëpunim me forcat partizane që komandoheshin nga Mustafa Matohiti e Ago Çeli, në mbremjen e 27 nëntorit 1942, u gjendën bashkë në rrethimin e nënprefekturës ku ishin 150 xhandarë, milicë dhe ushtarë. Për të evituar vëllavrasjen, drejtuesit e operacionit i dhanë ultimatum nënprefektit që të dorëzohej. Në orën e caktuar, nënprefekti u detyrua të pranonte ultimatumin e komandës partizane dhe u dorëzuan. Duke ulur tytat e armëve poshtë, e me kokë ulur, ata u lanë të lirë dhe u larguan në drejtimin Nivicë-Salari-Tepelenë. Kështu, populli festoi i lirë 28 Nëntorin, Ditën e Pavarësisë.

Me çlirimin e vendit dhe me hapjen e shkollës ushtarake “Skënderbej”, Abdyl Bakiu, emërohet komandant i saj. Në vitin 1949, Abdyl është ndër kuadrot e parë që dërgohet për studime në Bashkimin Sovjetik. Studimet i mbaron në vitin 1952 dhe kthehet në atdhe. Pas kthimit, emërohet si titullar në një drejtori të rëndësishme të Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitin 1966 Abdyl del në



pension dhe shkon vullnetarisht në fshatin e lindjes për të dhënë kontributin e tij. Në fillim ai emërohet kryetar i lokalitetit, ku spikasin aftësitë e tij drejtuese e organizuese, përballë problemeve të shumta që kishte populli në ato vite të vështira.

Përveç kryerjes me përgjegjësi të të gjitha detyrave të ngarkuara, Abdyl ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm dhe në aspekte të tjera si në ngritjen e muzeut të fshatit, ndërtimin e mirëmbajtjen e varrezave të fshatit, në ndërtimin e shtëpisë së kulturës e mbarëvajtjes së aktiviteteve, etj....

Gjatë kohës që ishte në ushtri, ashtu dhe gjatë viteve kur ishte funksionar në pushtetin lokal, Abdyl është zgjedhur deputet dhe ka përfaqësuar zonën në disa legjislatura në Kuvendin e Shqipërisë.

# IN MEMORIAM

## **Bajram Tresova,**

## KOMANDUESI MODEL I SKËNDERBEGASVE TË ARDHUR NGA LUFTA

**B**ajram Tresova u lind në mars të vitit 1922 në Gorë të Oparit dhe është një nga kuadrot e parë (komandant batalioni) në hapjen e Shkollës Ushtarake “Skënderbej”. Si pinjoll i familjes së njohur të Krojve, Bajrami u mbrujt me traditat patriotike e atdhedashëse, duke i pasuruar ato më tej në karrierën e tij të gjatë si ushtarak madhor në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Bajram Tresova, është një nga të rinjtë që rrëmbeu armët dhe u rreshtua në radhët partizane, duke dhënë në këtë luftë shembull heroizmi e trimërie. Gjatë luftës, Bajrami u bë dhe komandant, duke drejtuar formacione partizane në luftën për çlirim. Pas përfundimit të luftës, ditën e hapjes së Shkollës “Skënderbej”, Bajram Tresova emërohet komandant i batalionit të djemve e vajzave skënderbegase që erdhën nga lufta në bankat e shkollës.

Familja e tij ishte e lidhur me luftën, ndërsa Bajrami, angazhohet fillimisht në prapavija (guerile e në terren), ku në gusht të vitit 1942, përfundon dhe në burg...

Në fund të shtatorit 1942, në një pritë të bërë kundër lëvizjes nga 300 milicë, Bajrami plagoset... Nga këtu, pas qëndrimit disa dit në shtëpinë e shërimit, ai ikën në mal, përkatësisht në njësinë që vepronte në Gorë-Opar e që drejtohej nga Teki Kolaneci.

Bajrami mori pjesë në shumë përpjekje me pushtuesit, si në atë të 16 janarit 1943 në Voskopojë, në Snosëm, në aksionin në Maliq, në periferi të Korçës në dhjetor 1943, në Pogradec, etj... Me krijimin e Brigadës së 9-të Sulmuese si pasojë e shkrirjes së 5 batalioneve, (16 tetor 1944), Bajram Tresova, emërohet zëvendëskomandant i Batalionit të katërt.

Me hapjen e shkollës ushtarake në Tiranë, më 28 mars 1945, Bajram Tresova emërohet komandant batalioni. Një oficer i luftës, kishte se çfarë t’iu mësonte skënderbegasve të rinj.

Si komandant batalioni, në atë kohë, Bajram Tresova përballonte edukimin, stërvitjen, rregullin e brendshëm, përgjigje për gjendjen shëndetësore etj... Ai ishte pothuaj moshatar me skënderbegasit e vegjël, por kjo nuk e pengonte të ishte i drejtë, i papërtuar për edukimin dhe stërvitjen e tyre. Gjatë qëndrimit në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”, Bajram Tresova mbahet mend ndër të tjera dhe për talentin e komunikimit, fjalën e mençur dhe këmbënguljen për zgjidhjen e problemeve deri në fund. Ishin aftësitë e treguara në



shkollën “Skënderbej”, që e bindën emërtesën t’i besonin në vazhdim Bajram Tresovës detyra akoma më të rëndësishme.

Në vitin 1952, dërgohet në Bashkimin Sovjetik për të studiuar për përgatitjen e drejtuesve të rinj të policisë së shtetit.

Pas përfundimit të këtyre studimeve, Bajrami emërohet në detyra të rëndësishme si Kryetar Dege në Policinë e Shtetit, Drejtor i Stërvitjes, etj... Bajram Tresovës, atë kohë, nga Kadri Hazbiu, iu besua siguria e personaliteteve të huaja që vinin për vizitë në Shqipëri, përfshi dhe atë të Nikita Hrushovit. Ai ishte model i korrektesës e përpjekjeve për rezultate sa më të mira dhe në këto aspekte.

Bajram Tresova është dhe autor i shumë shkrimeve profesionale, autor i librit “Gora dhe Opari në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare”, drejtues i shoqatës “Gora”, etj... Bajram Tresova është dekoruar me shumë medalje e urdhra pune.



# Mos harroni Srebrenicën

**B**osnje-Hercegovina shënon 28-vjetorin e masakrës së Srebrenicës, e cila është më e rënda në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Në korrik të vitit 1995, forcat serbe të Bosnjës vranë mbi 8 mijë burra dhe djem myslimanë në enklavën e Srebrenicës, që ishte caktuar si “vend i sigurt” nga Kombet e Bashkuara. Më 9 korrik 1995, udhëheqësi i atëhershëm i serbëve, Radovan Karadžić lëshoi një urdhër të ri për të pushtuar Srebrenicën.

Trupat rrethuan enklavën dhe sulmuan paqeruajtësit holandezë, duke marrë peng 30 prej tyre.

Një ditë më pas, më 10 korrik, ushtarët serbë të Bosnjës filluan të bombardojnë Srebrenicën. Forcat holandeze kërcënuan serbët se do të kishte goditje ajrore të NATO-s, nëse nuk tërhiqeshin deri në mëngjes.

Dhe të nesërmen, avionët e NATO-s bombarduan tanket serbe jashtë Srebrenicës.

Forcat serbe kërcënuan të rifillonin bombardimin dhe të

vrisnin ushtarët e kapur holandezë. Goditjet ajrore u ndalën dhe në mbrëmjen e 11 korrikut, komandanti i serbëve të Bosnjës, gjenerali Ratko Mlladiç hyri në Srebrenicë.

Rreth 30 mijë refugjatë myslimanë u grumbulluan rreth bazës së paqeruajtësve holandezë në Potoçari, në veri të qytetit të Srebrenicës, pasi forcat serbe të Bosnjës morën nën kontroll zonën e sigurt.

Mlladiç u përpoq t'i qetësonte, duke u thënë se nuk kishin pse të kishin frikë. Forcat serbe të Bosnjës i futën refugjatët e frikësuar nëpër autobusë, për t'u larguar.

Shumë nga refugjatët u evakuuan në Kladanj, 50 kilometra larg dhe prej andej filluan të ecnin për të gjetur një strehë të sigurt. Kombet e Bashkuara vunë re se shumica e refugjatëve që mbërrinin nga Srebrenica ishin gra, fëmijë dhe të moshuar dhe filluan të shqetësohen për fatin e burrave.

Rreth 15 mijë ushtarë dhe civilë myslimanë të Bosnjës u larguan natën nga Srebrenica, duke u përpjekur të arrinin në territor të kontrolluar nga myslimanët. Shumë vdiqën nga bombardimet dhe goditjet e snajperëve.

Gjatë javës pasoi rënia e Srebrenicës, rreth 8 mijë burra dhe djem mendohet se u vranë nga serbët e Bosnjës dhe u varrosën në varre masive. Edhe pas më shumë se dy dekada pas vrasjeve, ende vazhdojnë të gjenden varre masive. Identifikimi i viktimave është i vështirë, pasi trupat ishin copëtuar nga ekskavatorët që i hidhnin në varre. Çdo vit, më 11 korrik, eshtrat e atyre që identifi-

kohen gjatë vitit të fundit varrosen në Qendrën përkujtimore të Potoçarit.

### **Një trup i larguar nga shpirti i tij**

Një vajzë boshnjake gjashtëvjeçare, e cila ishte dëshmitare e tmerrit ndaj nënës së saj, gjyshes dhe anëtarëve të tjerë femra të familjes nga ushtarët serbë, do sillte vite më vonë historinë e asaj nate në shtëpinë e saj:

“U fsheha nga familja në një fuçi kur trupat serbë hynë në shtëpinë tonë. Babai, gjyshi dhe anëtarët e tjerë meshkuj të familjes u nxorën nga shtëpia dhe nuk u panë më. Shpëtova dhe më çuan në një kamp refugjatësh turq”. Kjo vajzë e vogël përfundimisht u shërua nga trauma e shkaktuar nga shtazëria serbe dhe filloi të fliste rrjedhshëm shtatë gjuhë në moshën 16-vjeçare.

Kur urrejtja çon në krime të këtij lloji, është e vështirë të gjesh fjalë për të shprehur sa e thellë është mungesa e humanizmit, ose sa e thellë vuajtja që shkakton ajo. Megjithatë, duhet t'i mbajmë ngjarje të tilla të rrënjosura fort në ndërgjegje. Kur e dimë se ç' janë në gjendje t'i bëjnë njëri-tjetrit qeniet njerëzore, kujtohem se kemi përgjegjësi të madhe në parandalimin e paragjytimeve, të diskriminimeve dhe të dhunës, që kanë shënuar historinë e kontinentit tonë.

Në një kohë kur nacionalizmi i skajshëm po përpiqet të riafirmohet në disa pjesë të Evropës, duhet ta kujtojmë rëndësinë e jashtëzakonshme të dinjitetit njerëzor dhe të të drejtave themelore. Ta kujtojmë Srebrenicën dhe të mësojmë prej saj.



# 24 vite nën qiellin e lirë të Kosovës martire

**K**osova shënon 24-vjetorin e çlirimit apo një nga ditët më të rëndësishme të historisë së vendit. 24 vjet më parë në Kosovë u vendosën 50 mijë ushtarë të NATO-s.

Më 12 qershor 1999, pas 78 ditë bombardimesh të Aleancës Ushtarake Perëndimore të udhëhequr nga Amerika, kundër caqëve ushtarake serbo-malazeze në Kosovë në Serbi dhe Mal të Zi, trupat e NATO-s hynë në Kosovë me misionin paqeruajtës KFOR, duke i dhënë fund luftës gati dyvjeçare midis popullsisë kryengritëse shqiptare të organizuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave okupuese ushtarake dhe policore serbo-malazeze.

Ushtarët e parë të NATO-s që hynë në Kosovë, më 12 qershor, ishin forcat speciale të Norvegjisë dhe ato të Shërbimit Special Ajror Britanik.

Hyrja e ushtarëve të NATO-s hapi rrugën e kthimit në shtëpitë, tokën dhe vendin e tyre mbi një milionë shqiptarëve të Kosovës të larguar refugjatë në dhjetëra vende dhe tre-katër kontinente të botës.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), dhe lufta çlirimtare e saj ishin shumë të rëndësishme për lirinë e vendit.

## 12 qershori i vitit 1999 është ditë e shenjtë për shqiptarët - Çlirimi i Kosovës

Një ëndërr patriotike, që nga Rilindja Kombëtare e deri në vitin 1999.

Shqiptarët kishin një ditë të shenjtë, 28 Nëntorin e vitit 1912, Pavarësinë e Shqipërisë. Por tani kanë dy ditë çlirimi, dy shtete dhe një popull.

Një histori e dhimbshme kjo, por heroike. Por edhe një flamur, ky është flamuri i Gjergj Kastriotit me shqipen dykrerëshe.

Flamur i shenjtë për shqiptarët që, pasi kishte dridhur turqit, u futi dridhmat edhe serbëve edhe grekëve, sepse edhe shqiptarët e Kosovës luftërat e tyre heroike për bashkim kombëtar dhe pavarësi, me flamurin e Gjergj Kastriotit i kanë bërë.

Kjo datë e rëndësishme për popullin Kosovar, agimin e saj e nisi para të rënëve të atdheut dhe varrezat e Jasharëve, një fis i tërë i shuar për të gëzuar ditën e lirisë. E para e vendit, presidentja e Republikës së Kosovës znj. Vjosa Osmani është shprehur përherë mirënjohëse për gjithë vizionarët e shtetit, aktivistët, ushtarët e UÇK-së dhe për aleatët që ndihmuan në çlirimin dhe pavarësinë e vendit.



“Sot shënojmë përvjetorin e një prej ditëve më të rëndësishme në historinë e kombit tonë, në historinë e Republikës së Kosovës, ditën kur shteti ynë u çlirua pas një lufte, e cila rezultoi me gjenocid ndaj një populli të pafajshëm. Tani po nderojmë ushtarët e NATO-s, ata që nga 10 qershori e tutje hynë në Republikën e Kosovës për t’ia dhënë vulën e çlirimit të vendit tonë”. Kush përjeton një luftë, atij i ndryshon përgjithmonë jeta. 24 vjet kanë kaluar nga lufta e Kosovës, por pasojat ende janë prezente. Në jetët e njerëzve, dhimbjen që la ajo për familjarët, por edhe shkatërrimin e kudogjendur. Ende ka shumë pyetje të hapura për kohën e luftës në Kosovë. Rreth 13 500 njerëz u vranë gjatë luftës së fundit në Kosovë (1999). Këto të dhëna jepen nga institucione të ndryshme në Kosovë, por, më së miri janë të evidentuara nga organizata Fondi për







të Drejtën Humanitare, të prezantuar në Librin e Kujtimit të Kosovës (LKK) mbi të gjitha viktimat e luftës në Kosovë nga të gjitha etnitë. Sipas kësaj organizate gjatë luftës në Kosovë janë vrarë ose janë zhdukur gjithsej 13 535 njerëz. Kjo shifër është nxjerrë në bazë të analizës së 31 600 dokumenteve nga burime të ndryshme, në mesin e tyre edhe nga një numër i madh i deklaratave të viktimave dhe të dëshmitarëve të krimeve të luftës. Në numrin e të vrarëve, shqiptarët e Kosovës përbëjnë numrin më të madh të viktimave, me 10 812, serbët 2 197, kurse romët, boshnjakët, malazezët dhe joshqiptarët e tjerë përbëjnë 526 viktime gjithsej. Në hulumtimin e FDH-së, nxirren statistika edhe në bazë të komunave më të mëdha, ku del se territori i Gjakovës në perëndim të Kosovës, ka pasur humbjet më të mëdha. Në Gjakovë kanë mbetur të vrarë 1 022 civilë shqiptarë. Pas Gjakovës renditet Skënderaj me 984 të vrarë, Glllogovci me 804 vetë, Rahoveci me 724, Peja me 561, Prishtina me 466, Prizreni me 464, Vushtrria me 451, Suhareka me 434, Mitrovica me 417 vetë.

Për sa i përket vrasjes së civilëve serbë në krye ndodhet Komuna e Prishtinës, ku të vrarë kanë mbetur 130 civilë serbë, më pas vjen Gjilani me 98 serbë të vrarë, Prizreni me 80, Peja me 79, Rahoveci me 71, Gjakova me 61, Klina me 56, Lipjani me 43, Suhareka me 40 dhe Istogu me 39 civilë serbë të vrarë. Me gjithë këtë numër të evidentuar të personave të vrarë nga forcat serbe të sigurisë, edhe sot 24 vjet nga përfundimi i luftës së Kosovës, 1 647 persona konsiderohen si të pagjetur dhe për ta ende nuk dihet asgjë.

#### **Dëbimi i shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe gjatë luftës**

Gjatë periudhës së luftës së Kosovës, mbi 800 mijë shqiptarë të Kosovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe të sigurisë. Këto të dhëna gjenden në një raport të organizatës së OKB-së për refugjatët, (UNHCR), e cila njofton se 862 979 refugjatë u larguan nga Kosova nga 23 marsi deri më 9 qershor 1999. Një shifër e ngjashme përmendet edhe në një raport të OSBE-së, ku thuhet se 863 000 civilë u dëbuan nga Kosova mes marsit dhe qershorit të vitit 1999. Ndërkohë, "Amnesty

International" thekson se "deri në fund të luftës në Kosovë në qershor të vitit 1999, më shumë se gjysma e popullatës civile të Kosovës jetonin në kampe refugjatësh në Shqipëri dhe Maqedoni".

#### **Të pagjeturit pas luftës**

Prej përfundimit të luftës e deri më sot, në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Komisionin Keveritar të Kosovës për Persona të Zhdukur, sipas kërkesave të familjarëve, janë evidentuar 6 057 raste të personave të zhdukur, si pasojë e luftës në Kosovë. Fati i shumicës prej tyre tashmë është zbardhur, por për 1 647 persona ende nuk dihet asgjë. Autoritetet e Kosovës, por dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare bëjnë të ditur se rreth 80% e personave të zhdukur gjatë luftës kanë qenë meshkuj të moshës prej 18 deri në 40 vjeç. Pjesa tjetër janë e moshës 41 deri në 60 vjeç, por ka pasur raste të rrëmbimeve dhe zhdukjeve të personave mbi moshën 60-vjeçare.

#### **Varrezat masive pas luftës**

Në Kosovë e në Serbi pas përfundimit të luftës u zbuluan një sërë varrezash masive. Në dokumentet e Tribunalit të Hagës, në aktakuzat e prezantuar për shumë të akuzuar për krime lufte nga pala serbe, prej marsit të vitit 2000 janë identifikuar 529 varreza masive, shumica dërmuese e tyre në Kosovë. Në këto varreza janë gjetur trupat e pajetë të 4 300 personave të vrarë.

Pas kaq shumë vitesh është shumë e vështirë të gjenden burimet primare, për shkak të vdekjes ndërkohë të shumë dëshmitarëve dhe mungesës së dokumentacionit. Mirëpo në këtë proces mund të ndihmojë bashkëpunimi i institucioneve të Kosovës dhe Serbisë, si edhe burimet e Tribunalit të Hagës, të cilat kanë evidentuar dhe krijuar një arkiv për shumë krime.

Historia nuk duhet harruar, për të kuptuar që e tashmja jonë për të gëzuar hisen e diellit që na takon ka ardhur mes dhimbjesh të jetëve të humbura të njerëzve të pafajshëm, të atyre që dolën për të mbrojtur atdheun e tyre prej shqjaut serb. Gëzuar pra festën e Çlirimit të Shtetit Shqiptar të Kosovës!

# LUFTA E PARË BOTËRORE, masakra më e përgjakshme në histori

**P**ara mesditës së 28 qershorit të vitit 1914, princi i kurorës së Habsburgëve, Franz Ferdinandi dhe gruaja e tij Sofija, dukeshja e Hohenbergut, u ekzekutuan në Sarajevë, Bosnje - Hercegovinë.

Ata kishin ardhur për vizitë në Sarajevë për të ndjekur nga afër stërvitjet ushtarake të organizuara nga Austro-Hungaria.

Nacionalistët serbë, të "trimëruar" nga luftërat ballkanike të viteve 1912/13, të cilët e shihnin veten si fuqi rajonale e kthyen vëmendjen te ideja e "çlirimit" të sllavëve të jugut nga Perandoria Austro-Hungareze.

Duke besuar se kauzës së serbëve do t'i shërbente vrasja e Franz Ferdinandit, trashëgimtarit të perandorit austriak Franz Joseph, dhe duke ditur se ai do të vizitonte Sarajevën, kreu i ushtrisë së Serbisë Dragutin Dimitrijeviç, komplotoi vrasjen e tij.

Sulmi i studentit boshnjako-serb, Gavrilo Principit, shkaktoi një krizë midis fuqive të mëdha evropiane që edhe ashtu vetëm një shkëndijë u nevojitej për të ndezur luftën. Ajo shkëndijë u ndez në Ballkan, që njihet edhe sot si "fuçi baruti" në Evropë.

Pas rreth një muaji, pas një sërë ultimatumesh, më 28 korrik 1914, Austro-Hungaria i shpalli luftë Serbisë dhe në ditët në vijim, bombardoi Beogradin. Një nga një vendet iu bashkuan luftës. Në vetëm

pak ditë, gjysma e Evropës ishte në luftë që do të ndryshonte përgjithmonë historinë botërore. Gjatë konfliktit, Britania e Madhe, Franca, Rusia, Italia, Rumania, Kanadaja, Japonia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që u njohën si "Fuqitë Aleate", luftuan kundër Gjermanisë, Austro-Hungarisë, Bullgarisë dhe Perandorisë Osmane "Fuqitë e Boshtit".

Lufta e Madhe përfundoi me fitoren e "Fuqive Aleate". Austro-Hungaria u shpërbë në vorbullën e luftës, e po ashtu edhe Perandoria Ruse. Në Rusi më pas do të vijin në pushtet komunistët.

Gjermania, si palë që pësoi humbje në luftë, duhej të paguante dëmshpërblime të larta, të cilat shkaktuan varfëri dhe krizë.

Si pasojë e kësaj pakënaqësie do të ngrihet së

shpejti Adolf Hitleri, i cili pas vetëm njëzet vjetësh nga përfundimi i Luftës së Parë Botërore, do ta çojë botën në një Luftë të Dytë Botërore edhe më të përgjakshme.

Pra, kjo ishte shkëndija që shkaktoi Luftën e Parë Botërore, e cila zgjati nga viti 1914 deri në vitin 1918. Me mbi 37 milionë të vdekur ishte një nga luftërat më të përgjakshme të të gjitha kohërave.

Pesë vjet më vonë po në këtë ditë, 28 qershor 1919, Traktati i Versajës i dha fund zyrtarisht luftës.

## **Sfondi**

Shkas për shpërthimin e Luftës së Parë Botërore ishte vrasja e trashëgimtarit të fronit të Perandorisë Austro-Hungareze. Sidoqoftë, kjo ishte vetëm ngjarja e fundit që çoi në konflikt.

Paraardhësit duhet të vendosen në një kontekst të fërkimit të përhershëm midis fuqive të mëdha të kohës, të shkaktuara nga imperializmi i tyre dhe dëshirës së tyre për të marrë fuqinë më të madhe të mundshme.

## **Lufta Franko-Prusiane**

Lufta Franko-Prusiane përfundoi me humbjen franceze në 1870. Kjo shkaktoi një zhvendosje në ekuilibrat evropianë të fuqisë. Gjermania përfundoi unitetin e saj dhe Uilliam u njoh si Perandor. Nga ana tjetër, Franca humbi disa territore nga armiku i saj. Posh-



tërimi i pësuar, dëshira për të rikuperuar Alsin dhe Lorenën dhe synimi i saj për të qenë edhe një herë një fuqi e madhe bëri që marrëdhëniet e saj me Gjermaninë të ishin shumë të tensionuara dhe ishin gjithmonë në prag të konfliktit.

### **Sistemi i Aleancës**

Pasi Napoleoni u mund, fuqitë evropiane filluan një lojë aleancash dhe strategjish që zgjatën gjatë gjithë shekullit të 19-të dhe viteve të para të 20-të. Fillimi i tij mund të shënohet në formimin e Aleancës së Shenjtë midis Prusisë, Austrisë dhe Rusisë në 1815, por ishte më vonë kur arriti kulmin.

Figura themelore për të kuptuar atë kohë ishte kancelari gjerman Otto von Bismarck. Në 1873 ai promovoi një aleancë midis Austro-Hungarisë, Rusisë dhe Gjermanisë, tre monarkitë më të rëndësishme të momentit. Rusia shpejt u tërhoq nga marrëveshja për shkak të dallimeve të saj me Austro-Hungarinë për Ballkanin, disa konstante deri në Luftën e Madhe.

Gjermania dhe Perandoria Austro-Hungareze vazhduan në aleancë, e cila u bashkua me Italinë në 1882 (Aleanca Triple). Me tërheqjen e Bismarck dhe mbërritjen në fronin e Guillermo II, sistemi i tij i marrëveshjeve filloi të dobësohej, megjithëse u mbajtën marrëveshje të caktuara.

Fuqitë e tjera gjithashtu bënë lëvizje strategjike. Franca, ende duke vuajtur pasojat e luftës së saj të humbur me Prusinë, nënshkroi një marrëveshje me Rusinë për t'iu kundërvënë Aleancës së Treshe.

Nga ana e saj, Mbretëria e Bashkuar gjithashtu nënshkroi traktate me Francën, duke formuar të ashtuquajturën Kardiale të Antantës. Më vonë, ajo bëri të njëjtën gjë me Rusinë.

### **“La Paz e armatosur”**

Politika e lartpërmendur e aleancave rezultoi në kohën e njohur si “La Paz Armada”. Të gjitha fuqitë filluan një garë armatimesh në mënyrë që të forconin ushtritë e tyre. Ishte një pyetje, së pari, për të dekurajuar rivalët e tij nga fillimi i armiqësive dhe, së dyti, për t'iu përgatitur në rast të shpërthimit të luftës.

Gjermania ndërtoi një Marinë të fuqishme Perandorake, me synimin për t'i dalë ballë fuqisë detare angleze. Këto përsërisnin modernizimin e anijeve të tyre. Diçka e ngjashme do të ndodhte me kombet e tjera dhe me të gjitha llojet e pajisjeve ushtarake. Askush nuk donte të lihej pas.

Sipas historianëve, midis 1870 dhe 1913, Gjermania dhe Anglia dyfishuan buxhetin e tyre ushtarak, Franca e dyfishoi atë, dhe Rusia dhe Italia e zgjeruan atë në mënyrë të konsiderueshme.

### **Imperializmi kolonial**

Dekadat e fundit të shekullit të 19-të dhe dekadat e para të shekullit të 20-të ishin koha kur kolonializmi u bë imperializëm. Të gjitha fuqitë, përfshirë Japoninë dhe Shtetet e Bashkuara, kishin koloni në Afrikë dhe Azi. Tregtia, fuqia punëtore e lirë dhe lëndët e para ishin argumentet kryesore për t'iu mbajtur ato.

### **Kriza e korrikut**

Muaji pas atentatit ishte kritik për të filluar luftën. Të gjitha fuqitë filluan të manovronin në mënyrë diplomatike, së pari dhe ushtarakisht

më vonë.

Përgjigja austriake ishte e menjëhershme: ajo prishi marrëdhëniet diplomatike me Serbinë dhe urdhëroi që të mobilizohej ushtria. Më në fund, më 28 Perandoria Austro-Hungareze u shpall luftë serbëve.

### **Mobilizimi i Rusisë**

Si aleate e Serbisë, Rusia mobilizoi ushtrinë e saj kundër Austro-Hungarisë, e cila provokoi një reagim nga Gjermania, aleati i tyre. Kaiseri gjerman, Wilhelm II, u përpoq të ndërmjetësonte me Carin, atëherë kushëririn e tij. Sidoqoftë, ai refuzoi dhe Gjermania lëshoi një ultimatum duke kërkuar çmobilizimin e trupave ruse dhe jo mbështetjen e Serbisë.

Në të njëjtën kohë, gjermanët u dërguan një ultimatum tjetër francezëve për të mos ndihmuar aleatin e tyre Rusinë në rast lufte. Më 1 gusht, Rusia u përgjigj duke refuzuar kërkesat gjermane, të cilat reagueshan duke i shpallur luftë. Më 4 korrik, Austro - Hungaria mobilizoi të gjitha trupat e saj.

Austro-Hungaria akuzoi Serbinë se ishte prapa krimit dhe njoftoi



një ultimatum, më 23 korrik me dhjetë kërkesa që nuk mund të përmbusheshin nga vendi i Ballkanit. Ditën tjetër, Rusia vazhdoi të mobilizojë të gjitha trupat e saj.

Më 25 korrik, Serbia bëri të njëjtën gjë me të tyret dhe iu përgjigj ultimatumit austro-hungarez: ajo pranoi të gjitha kërkesat e tyre përveç asaj që kërkonte që austriakët të merrnin pjesë në hetimin e vrasjes.

Përgjigja austriake ishte e menjëhershme: ajo prishi marrëdhëniet diplomatike me Serbinë dhe urdhëroi që të mobilizohej ushtria. Më në fund, më 28 Perandoria Austro-Hungareze u shpall luftë serbëve.

Masakra që u la pas në fund të Luftës së Parë Botërore ishte tronditëse. Deri në fund të luftës, rreth 10 milionë ushtarë u vranë. Mesatarisht rreth 6 500 vdekje çdo ditë.

Miliona civilë u vranë gjithashtu. Lufta e Parë Botërore është përmendur veçanërisht për masakrën e saj, sepse ishte një nga luftërat më të përgjakshme në histori.

